

**RRITJA E EFIÇENCËS NË MBLEDHJËN E TË
ARDHURAVE PUBLIKE DHE NDIKIMI I TYRE NË
RRITJEN EKONOMIKE TË VENDIT**

TEKI SHALA

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
FAKULTETI I EKONOMIK, me profil FINANCË, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Asoc.Dr.Oltjana ZOTO

Numri i fjalëve: 50,069

Tiranë, Dhjetor 2020

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë deklaroj se kjo tezë me titull “RRITJA E EFIÇENCËS NË MBLEDHJEN E TË ARDHURAVE PUBLIKE DHE NDIKIMI I TYRE NË RRITJEN EKONOMIKE TË VENDIT”, është punë origjinale e imja dhe nuk kam përdorur burime të tjera , përveç atyre që janë shkruar si citime, apo ngjashëm.

Të gjitha të dhënat, tabelat, figurat dhe citimet në tekst, të cilat janë riprodhuar prej ndonjë burimi tjetër , duke përfshirë edhe internetin, janë pranuar në mënyrë eksplicite si të tilla.

Tiranë, Dhjetor 2020

Nënshkrimi

Teki Shala

ABSTRAKTI

Shteti për t'i realizuar funksionet e ndryshme në veprimtarinë politike, sociale dhe ekonomike, ndërmerr disa hapa konkret për të maksimizuar mirëqenien sociale dhe ekonomike. Një ndër aktivitetet që duhet ndërmerru është edhe mbledhja e të ardhurave publike. Duke u nxitur nga hulumtimet paraprake, të cilët kanë gjetur se të ardhurat publike kanë ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike dhe nga konstatimi se mungesa e tyre mund të shkaktojë pengesa në rritjen ekonomike, atëherë, si qëllim kryesor në këtë hulumtim mund të tregoj marrëdhëniet në mes të të ardhurave publike dhe rritjes ekonomike të Kosovës për vitet 2004-2016. Për të treguar këtë ndikim, kam përdorur të dhënat sekondare që janë të dhëna tremujore të marruara nga Ministria e Financave, Banka Qendrore e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, FMN dhe BB. Për ta kompletuar analizën, unë në fillim kam aplikuar analizën statistikore të mbledhjes së të ardhurave publike, duke bërë një përshkrim të mjaftueshëm të llojeve, trendëve dhe efikasitetit të të ardhurave publike në vitet 2014-2016. Më pastaj, kam vazhduar me analizën ekonometrike për të hetuar marrëdhëniet shkakësore ndërmjet PBB-së, të ardhurat tatimore (TAT), të ardhurat jo tatimore (TAJT) dhe të ardhurat nga grandet (TAG) duke përdorur modelin multivariat VAR, dhe nëpërmjet tij, kam ndërtuar modelin VECM. Përpunimi i të dhënave është realizuar me anë të softwere-it Eviews 8. Vrojtimi i trendëve të tre faktorëve përcaktues të nivelit të të ardhurave publike dhe krahasimi i tyre me trendin e të ardhurave gjithsej, tregon se të ardhurat tatimore dhe jo tatimore kanë ndikuar në trendin e të ardhurave gjithsej, derisa të ardhurat nga grandet nuk kanë pasur ndikim të dukshëm në këtë trend. Nga ana tjetër, Testi Johansen gjen se variabëlët kanë një marrëdhënie afatgjatë statistikore dhe ekziston të paktën një ekuacion i ko-integruar, gjë që e përlligj modelin VECM. Testi Wald, për secilën nga variabëlët e pavarura që marrin pjesë në modelin VECM, gjen se nuk ekziston asnjë marrëdhënie shkakësore afatshkurtër e variabëlve të pavarura mbi variabëlin e varur. Ekuacioni ekonometrik që shpreh marrëdhëniet e variabëlve në vektor të gabimit të korrigjuar, ka treguar se të ardhurat tatimore ushtrojnë një ndikim të dukshëm negativ mbi PBB-në, ndërsa të ardhurat jo tatimore dhe grandet ushtrojnë një ndikim pozitiv mbi PBB-në.

Termat kyç: Të ardhurat publike, të ardhurat tatimore, të ardhurat nga grandet, rritje ekonomike, etj.

ABSTRACT

The state to carry out the various functions in political, social and economic activity takes some concrete steps to maximize social and economic well-being. One of the activities to be undertaken is the collection of public revenues. Encouraged by previous researches that have found that public revenues have positively impacted on economic growth and by finding that their absence may cause barriers to economic growth, then, as the main purpose of this research I have to show the relationship between Public Revenue and Economic Growth 2004-2016. To show this impact, we have used secondary data that are quarterly data obtained from the Ministry of Finance, the Central Bank of Kosovo, the Kosovo Agency of Statistics, the IMF and the WB. To complete the analysis, I initially applied the statistical analysis of public revenue collection, making a sufficient description of the types, trends and efficiency of public revenues from 2004-2016. Then we continued with the econometric analysis to investigate causal relations between GDP, tax revenue (TR), non-tax revenue (NTR) and revenue from the grants (GR) using the VAR multivariate model and through it we have built the VECM model. Data processing is realized through software Views 8. The trend survey of three determinants of the level of public revenue and their comparison with the total revenue trend shows that tax and non-tax revenues have influenced the total income trend, while the proceeds from the grants did not have a noticeable impact on this trend. On the other hand, Test Johansen finds that the variables have a long-term statistical relationship and there is at least one co-integrated equation, which justifies the VECM model. The Wald test for each of the independent variables participating in the VECM model finds that there is no short-term causal relationship of independent variables on the dependent variables. The econometric equation expressing the relationship of variables to the corrected error vector has shown that tax revenues exert a noticeable negative impact on GDP, while non-tax revenues and grants exert a positive impact on GDP.

Key terms: public revenues, tax revenues, grants, economic growth, etc.

DEDIKIMI

Këtë punim unë ia dedikoj nënës sime cila gjatë kohës kur unë punoja rreth hulumtimit, ajo u përball me jetën deri në shkuarje në amshim. I paharruar qoftë kujtimi për të.

Biri juaj!

FALËNDERIME

Kur fillova në shkollën doktrale, kisha disa mëdyshje se a thua ndoshta a kam bërë gjënë e duhur?! Mirëpo, duke i'u falënderuar disa personave të çmueshëm për mua, unë vazhdova këto studime me mjaft sukses.

Një falënderim i veçantë shkon për udhëheqësen shkencore: Prof. Asoc. Dr. Oltjana Zoto, për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që ajo më ofroi gjatë gjithë studimeve dhe për përfundimin e punimit tim të diplomës. Faleminderit profesoreshë!

Gjithashtu falënderojë miqtë, kolegët dhe gjithë ata që më mbështetën në çdo kohë në këtë udhëtim për dije.

Dhe në fund dëshiroj t'i shpreh mirënjohje të thellë familjes sime, të cilës i detyrohem për sakrificën që më kanë bërë për të më mundësuar që të vazhdojë rrugëtimin për dije. Faleminderit të gjithëve!

Tiranë, Dhjetor 2020

Tabela e përmbajtjes

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	ii
ABSTRAKTI.....	iii
ABSTRACT	iv
DEDIKIMI.....	v
FALËNDERIME.....	vi
Tabela e përmbajtjes	vii
LISTA E ILUSTRIMEVE	xii
LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE.....	xiii
LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT	xv
KAPITULLI I: HYRJE.....	1
1.1. Përkufizimi i problemit/temës që hulumtohet	1
1.2. Qëllimet e hulumtimit	3
1.3. Objektivat e hulumtimit	5
1.4. Pyetjet studimore dhe hipotezat statistikore të studimit	5
1.5. Mundësitë dhe kufizimet në studim.....	6
1.6. Rëndësia e studimit	7
1.7. Përmbajtja e shkurtër e punimit të diplomës	8
KAPITULLI II: METODAT DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	10
2.1. Hyrje.....	10
2.2. Burimet e të dhënave.....	10

2.3.	Teknikat e vlerësimit.....	11
2.4.	Saktësimi i modelit (Specifikimi i modelit)	11
2.4.1.	Testi i palëvizshmërisë (Test of Stationarity)	14
2.4.2.	Testi i rrënjës së njësisë (Unit Root Test)	15
2.4.3.	Testi i bashkë-integrimit (Co-Integration Test)	17
2.4.4.	Modeli i Përmirësimit të Gabimit të Vektorit (Vector Error Correction Model)	18
2.4.5.	Testi i Shkakësisë-Granger (Granger- Causality Test)	20
2.4.6.	Funksioni i Përgjigjes së Impulsit (Impulse, Response Funcsions)	21
2.4.7.	Zbërthimi i mospërputhjes (Variance Decomposition)	21
KAPITULLI III: KORNIZA TEORIKE		23
3.1.	Një vështrim teorik.....	23
3.2.	Përkufizimi i sistemit ekonomiko-fiskal.....	25
3.2.1.	Politika fiskale	25
3.2.2.	Instrumentet dhe efektet e politikës fiskale	27
3.2.3.	<i>Sistemi Fiskal</i>	28
3.2.4.	Sistemi ekonomiko- fiskal në Kosovë	28
3.2.4.1.	<i>Sistemi fiskal i KSA të Kosovës</i>	29
3.2.4.2.	<i>Politika dhe sistemi fiskal në Kosovë</i>	29
3.2.4.3.	<i>Sistemi tatimor dhe normat tatimore në Kosovë</i>	32
3.3.	Të ardhurat publike	37

3.3.1.	Përkufizimi i të ardhurave publike	37
3.3.2.	Burimet e të ardhurave publike.....	39
3.3.3.	Klasifikimi i përgjithshëm i të ardhurave publike.....	41
3.3.4.	Efiçenca dhe administrimi i mbledhjes së të ardhurave publike	43
3.4.	Të ardhurave publike në Kosovë	44
3.4.1.	Burimet e të ardhurave publike në Kosovë	46
3.4.1.1.	<i>Të ardhurat tatimore në Kosovë</i>	46
3.4.1.2.	<i>Të ardhurat jo tatimore në Kosovë</i>	47
3.4.1.3.	<i>Të ardhurat nga grandet</i>	48
3.4.2.	Efiçenca dhe administrimi i mbledhjes së të ardhurave publike	48
3.4.2.1.	Administrata Tatimore e Kosovës	49
3.4.2.2.	Doganat e Kosovës	50
3.4.2.3.	Evazioni fiskal në Kosovë.....	51
3.5.	Rritja ekonomike.....	53
3.5.1.	Një vështrim i përgjithshëm i rritjes ekonomike në Kosovë.....	55
3.6.	Teoritë kryesore.....	61
3.6.1.	Teoritë e të ardhurave publike	61
3.6.2.	Teoritë Tatimore	61
3.6.3.	Teoritë e rritjes ekonomike	63
3.6.	Rezultatet e kërkimeve empirike	66

KAPITULLI IV: ANALIZA EMPIRIKE E TË ARDHURAVE PUBLIKE ME RRITJEN EKONOMIKE	88
4.1. Analiza përshkruese e të ardhurave publike në Kosovë.....	88
4.1.1. Një vështrim i përgjithshëm rreth sistemit dhe politikës fiskale në Kosovë	88
4.1.2. Struktura e të ardhurave në Kosovë	92
4.1.3. Trendët e të ardhurave publike në Kosovë 2004-2016	100
4.2. Analiza ekonometrike	113
4.2.1. Specifikimi i modelit dhe të dhënat e përdorura.....	113
4.2.2. Testi i rrënjës njësi (unit root test)	114
4.2.3. Modeli VAR për Ln(PBB), Ln(TAG), Ln(TAT) dhe Ln(TAJT).....	118
4.2.4. Përcaktimi i numrit optimal të lags për modelin VECM.....	120
4.2.5. Testi Johansen i co-integritimit.....	121
4.2.6. Modeli VECM me variabël të varur Ln(PBB)	124
4.2.7. Funkcioni i Përgjigjes së Impulsit në modelin VAR/VECM.....	132
4.2.8. Kontrolli i cilësisë së modelit (Diagnostic checking).....	136
KAPITULLI V: PERFUNDIME DHE KONKLUSIONE	140
5.1. Përfundime të studimit empirik të të dhënave	140
5.1.1. Përfundime të studimit deskriptive të të dhënave.....	140
5.1.2. Përfundime te studimit ekonometrik të të dhënave.....	142
5.2 Rekomandimet.....	144

Shtojca	146
Referencat	189

LISTA E ILUSTRIMEVE

(aty ku ka)

LISTA E TABELAVE OSE DIAGRAMEVE

Tabela 3.1	Normat e tatimit në të ardhura personale në Kosovë	34
Tabela 3.2	Normat e tatimit në të ardhura të korporatave në Kosovë	35
Tabela 3.3	Norma e tatimit në vlerën e shtuar në Kosovë	36
Tabela 3.4	Rritja ekonomike e Kosovës (1948-2004)	57
Tabela 3.5	Rritja ekonomike e EJT dhe vendet tjera (%).....	57
Tabela 3.6	PBB-ja e Kosovës dhe norma e rritjes (2004-2016)	60
Tabela 4.1	Të ardhurat publike në Kosovë (2004-2016)	94
Tabela 4.2	Të ardhurat tatimore direkte dhe indirekte në Kosovë (2004-2016)	96
Figura 4.1	Struktura e të ardhurave publike (2004-2016)	97
Figura 4.2	Të ardhurat publike në Kosovë sipas burimit të mjeteve (2004-2016)....	98
Tabela 4.3	Struktura e të ardhurave publike (2004-2016)	99
Tabela 4.4	Të ardhurat vjetore (2004-2016) për TAT, TAJT, TAG dhe TGJ (norma e rritjes)	103
Figura 4.3	Trendi vjetor i të ardhurave publike në Kosovë (2004-2016)	105
Figura 4.4	Krahasimi i trendëve sipas zërave të ardhurave vjetore	106
Tabela 4.5	Të ardhurat vjetore në raport me popullsinë për vendet e rajonit (2005-2015)	107
Figura 4.5	Krahasimi i të ardhurave në raport me popullsinë për vendet e rajonit (2005-2015).....	108
Figura 4.6	Krahasimi i të ardhurave në raport me PBB-në e vendeve të rajonit (2005-2015)	109
Tabela 4.6	Të ardhurat tremujore (2005-2015) për TAT, TAJT, TAG, TAGJ dhe PBB (në milionë euro).....	109

Figura 4.7	Trendi tremujor i të ardhurave tatimore në Kosovë (2004-2016)	111
Figura 4.8	Trendi tremujor i të ardhurave jo tatimore në Kosovë (2004-2016)	113
Figura 4.9	Trendi tremujor i të ardhurave nga grandet në Kosovë (2004-2016)	113
Figura 4.10	Trendi tremujor i të ardhurave gjithsej në Kosovë (2004-2016)	114
Tabela 4.7	Testi i rrënjës njësi për Ln(PBB)	118
Tabela 4.8	Testi i rrënjës njësi për Ln(TAG)	119
Tabela 4.9	Testi i rrënjës njësi për Ln(TAT)	120
Tabela 4.10	Testi i rrënjës njësi për Ln(TAJT)	120
Tabela 4.11	Vlerësimi i koeficienteve të modelit VAR	122
Tabela 4.12	Përcaktimi i numrit optimal të lags në modelin VECM	123
Tabela 4.13	Testi Johansen sipas kriterit Trace	125
Tabela 4.14	Testi Johansen sipas kriterit Maximum Eigen value	126
Tabela 4.15	Modeli i regresionit linear me variabël të varur Ln(PBB)	127
Tabela 4.16	Koeficientet e modelit VECM për variabël të parë	128
Tabela 4.17	Tabela e koeficienteve të korigjimit të gabimit	129
Tabela 4.18	Testi Wald për variabël të parë Ln(TAG)	130
Tabela 4.19	Testi Wald për variabël të parë Ln(TAJT)	131
Tabela 4.20	Testi Wald për variabël të parë Ln(TAT)	132
Figura 4.11	Krahasimi i koeficienteve në modelin e VECM	133
Figura 4.12	Funksioni i përgjigjes së Impulsit për 12 periudha (3 mujore)	136
Figura 4.13	Funksioni i përgjigjes së Impulsit për 4 periudha (3 mujore)	138
Tabela 4.21	Elemente statistikore të modelit VECM	140
Tabela 4.22	Q-Statistic dhe LM-test	141
Tabela 4.23	Testi i Heteroskedasticitetit	142

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
TAT	Të Ardhurat Tatimore
TATJ	Të Ardhurat jo Tatimore
TAG	Të Ardhurat nga Grandet
TAGJ	Të Ardhurat Gjithsej
TAP	Të Ardhurat Publike
TAQ	Të Ardhurat Qeveritare
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
MF	Ministria e Financave
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AQF	Autoriteti Qendror Fiskal
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
TA	Tatimi në të ardhura (fitim)
TVSH	Tatimi i Vlerës së Shtuar
DD	Detyrimi Doganor
AA	Të Ardhurat nga Akciza
TTJ	Tatimet Tjera
ATJQQ	Të Ardhurat Jo Tatimore nga Qeveria Qendrore
ATJQL	Të Ardhurat Jo Tatimore nga Qeveria Lokale

ATJTJ	Të Ardhurat Jo Tatimore të Tjera
TD	Tatimet Direkte
TID	Tatimet Indirekte
VAR	Vectorial Autoregresion
VECM	Vector Error Correction Model
OLS	Ordinary Least Squares
ADF	Augmented Dickey Fuller
SIC	Schwarz Information Criterion
AIC	Akaike Information Criterion
HQ	Hannan- Quinn information criterion
FPE	Final Prediction Error
LR	Sequential modified LR test Statistic
TS	Trace Statisfic
VC	Vlera Kritike
M-ES	Max - Eigen Statistic
EJL	Evropa Jug-lindore

KAPITULLI I: HYRJE

1.1. Përkufizimi i problemit/temës që hulumtohet

Shteti për realizimin e funksioneve të tija të bazuara në ligje dhe kushtetutë, duhet të sigurojë të ardhura publike. Të ardhurat publike janë të rëndësishme për shtetin për realizimin e qëllimeve të tij në ushtrimin e sovranitetit të tij politik dhe shtetëror. Shteti bashkëkohor nuk mund të ushtrojë veprimtari politike pa sistemin dhe politikën e formimit të të ardhurave publike me qëllim të financimit të shpenzimeve të përgjithshme dhe të përbashkëta (Kadriu, 2012). Çështja e të ardhurave publike dhe e rritjes ekonomike është shumë e rëndësishme ,me ç ‘rast sot çdo qeveri i ka si objektiv kryesor këto dy variabla makroekonomike. Janë zhvilluar shumë hulumtime për të parë lidhjen në mes të efekteve të të ardhurave publike në ecurinë e rritjes ekonomike (Anastassiou and Dritsaki, 2005), (Reed R. , 2008), (Janes, E. Ihendinihu, J.U. dhe Nwaiwu, J.N., 2015), (Jegede, 2014), të cilët janë fokusuar në efektin e sistemit tatimor në performancën e rritjes ekonomike. Te ardhurat publike shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve publike të cilat mund të ndikojnë në rritjen ekonomike të vendit. Ky hulumtim është i rëndësishëm për shkak se ndikimi i të ardhurave publike në rritjen ekonomike në Kosovë ka qenë jo i kënaqshëm në drejtim të performancës së përgjithshme e cila e mat mirëqenien ekonomike të popullsisë. Hulumtimi im gjithashtu ka rëndësi të madhe sepse të ardhurat publike ndikojnë në individin dhe qeverinë e vendit në rritjen e performancës së shëndoshë makroekonomike duke përshpejtuar rritjen e qëndrueshme ekonomike, që do të thotë se të ardhurat publike ndikojnë drejtpërdrejtë në xhepin e qytetarëve dhe të bizneseve të vendit.

Politika dhe sistemi fiskal në Kosovë e ka zanafillën e vet të mirëfilltë menjëherë pas përfundimit të luftës në vitin 1999. Menjëherë pas çlirimit të Kosovës u instalua misioni

i Kombeve të Bashkuara, i ashtuquajtur si UNMIK. Ky mision kishte përgjegjësi për qeverisjen e vendit. Në këtë periudhë nuk kishte sistem fiskal, dhe ai që duhej të ndërmerre masa për themelimin e tij ishte UNMIK-u, kështu që më 25 qershor të vitit 1999, kryeadministratori i parë i Kosovës ka aprovuar Rregulloren nr. 1999/1. Dokumenti i dytë me rëndësi për sistemin fiskal në Kosovë është nxjerrja nga PSSP-ja, rregullorja nr. 1999/16, mbi themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal. Pra, politikat fiskale të përdorura nga qeveria e Kosovës nga viti 1999 si objektiv kryesor kanë pasur mbushjen e arkës së shtetit dhe më pak rritjen ekonomike e vendit. Në periudhën e pasluftës ngarkesa më të mëdha tatimore dhe doganore kishin bizneset (mbi 95% e të ardhurave buxhetore), ku gradualisht kjo barrë për bizneset u zvogëlua duke rritur bazën tatimore në përgjithësi. Sipas Riinvest (2003), aktivitetet të cilat në Kosovë janë ndërmarrë në vitet e fundit në ndërtimin e politikës fiskale, kanë dhënë efekte të rëndësishme në kuptimin e ngushtë fiskal, sepse janë arritur nivele mjaft të larta të ardhurave vetanake buxhetore, ndërsa këto politika, si një parakusht për sistem stabil, nuk kanë treguar efekte në performancën e rritjes ekonomike, që në këtë moment po bëhet çështje qenësore. Sistemi tatimor në Kosovë ka evoluar nga rregulloret e UNMIK-ut, sistemit të ligjeve tatimore të nxjerra nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me çka u bë e mundur nga fillimi i zbatimit të reformave të cilat plotësojnë standardet ndërkombëtare dhe parimet e BE-së (Administrata Tatimore e Kosovës, 2011). Në fillim ishte sfidë për institucionet e reje sepse qëllimi kryesor ishte mbushja e arkës së shtetit dhe në këtë mënyrë niveli i ulët i të ardhurave publike ishte një pengesë e madhe për rritjen ekonomike të Kosovës. Duke u nisur nga ky fakt, qeveria ndërmori disa hapa konkret në reformimin e sistemit fiskal me qëllim që ta mbajë trendin pozitiv të rritjes së të ardhurave. Për këtë arsye, ky studim ka një rëndësi praktike në formulimin e politikave më efektive në Kosovë në rritjen e

efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave publike dhe të ardhurat e grumbulluara publike të përdoren në mënyrë eficientë, dhe në këtë mënyrë që rritja ekonomike të stimulohet më fuqishëm. Edhe pse trendi i rritjes së të ardhurave publike nga viti në vit ka qenë mjaft i lartë, trend i cili është përcjellë edhe në rritjen investimeve publike, por që ndikimi i tyre në fillim nuk ka qenë i kënaqshëm në rritjen ekonomike të vendit.

Duke u nisur nga fakti se mbledhja e të ardhurave buxhetore dhe rritja ekonomike është një ndër sfidat më të mëdha që përballet bota globale në përgjithësi, atëherë të gjitha të gjeturat nga ky hulumtim janë krahasuar me literaturën shkencore dhe përvojat e vendeve të rajonit duke nxjerrë konkluzione dhe rekomandime për zgjedhjen e politikave më të mira fiskale të cilat ndikojnë në efikasitetin e të ardhurave publike dhe në rritjen e investimeve publike, ku më pas japin efekt pozitiv në rritjen ekonomike të vendit. Pra, qëndrueshmëria fiskale dhe posaçërisht qëndrueshmëria e mbledhjes së të ardhurave buxhetore në Kosovë do të varen kryekëput nga përpilimi i këtyre politikave.

1.2. Qëllimet e hulumtimit

Deri me tani për të ardhurat publike, efikasitetin e mbledhjes së tyre dhe rritjen ekonomike është diskutuar shumë nga teoricienë dhe ekonomistë të mirënjohur në vend dhe jashtë saj. Këto diskutime akademike kanë përcjellë qasje të ndryshme të të hyrave dhe rritjes ekonomike në vendet e tyre. Sot, në botë shumë ekonomistë, financierë dhe hulumtues të tjerë kanë bërë hulumtime të shumta rreth efikasitetit të mbledhjes së të ardhurave publike dhe efektit të tyre në rritjen ekonomike. Ka pasur mendime të ndryshme rreth këtyre të gjeturave, pro dhe kundër ndikimit të tyre në rritjen ekonomike. Edhe në Kosovë të ardhurat publike janë trajtuar nga studiues të shumtë, janë trajtuar më shumë në aspektin teorik, pa u thelluar në hulumtimin empirik. Deri më tani kanë munguar këto hulumtime

rreth marrëdhënieve apo efektit të të ardhurave publike në rritjen ekonomike të Kosovës. Duke u nisur nga ky argument, unë jam nxitur të kryej këtë studim empirik mbi efikasitetin e mbledhjes së të ardhurave publike dhe me ndikimin e tyre në rritjen ekonomike të Kosovës. Ky punim do të kontribuojë sado pak në literaturën moderne të Kosovës dhe sigurisht do të kontribuojë edhe në literaturën botërore duke e plotësuar atë me të gjeturat e këtij hulumtimi.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të tregoj marrëdhëniet e efikasitetit të të ardhurave publike dhe rritjes ekonomike të Kosovës nga viti 2004 deri në vitin 2016. Menaxhimi dhe administrimi i të ardhurave publike është një sfidë për institucionet e vendit dhe për këtë qëllim ky studim synon që rezultatet dhe konkluzionet e nxjerra të përdoren nga institucionet e vendit për rritjen e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave buxhetore dhe në këtë mënyrë efekti i rritjes ekonomike të jetë sa më i madh.

Studimi im synon:

1. Të bëj shqyrtim teorik të literaturës për të ardhurat publike, efikasitetin e mbledhjes, politikën fiskale dhe rritjes ekonomike;
2. Të bëj një analizë statistikore të mbledhjes së të ardhurave publike, duke bërë një përshkrim të mjaftueshëm të llojeve, trendeve dhe efikasitetit të të ardhurave publike nga viti 2014 deri në vitin 2016;
3. Të paraqes nivelin e të ardhurave publike dhe nivelin e rritjes ekonomike të vendit duke bërë analizën ekonometrike të ndikimit të të ardhurave në rritjen ekonomike të Kosovës;
4. Të bëj një krahasim të faktorëve nxitës në rritjen e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave publike dhe të rritjes ekonomike;
5. Të evidentoj problemet kryesore të sistemit ekonomik fiskal të vendit;

6. Rekomandimet për politikat që duhet të ndërmerren nga politik-bërësit në reformimin e sistemit ekonomik të Kosovës.

1.3. Objektivat e hulumtimit

Për realizimin e qëllimit kryesor ky studim do të synojë disa objektiva:

- a. Së pari, të jep një analizë teorike për të ardhurat publike dhe rritjen ekonomike.
- b. Së dyti, ky punim shkencor synon të shpjegoj lidhjen në mes të të ardhurave publike dhe rritjes ekonomike. Si indikator matës për rritjen ekonomike të vendit do të përdorë: Produkti i Brendshëm Bruto (PBB). Kjo analizë do të fokusohet në periudhën 2004-2016.
- c. Së treti, ky studim synon të japë një informacion rreth të ardhurave publike në Kosovë në periudhën 2004-2016, duke fokusuar me theks të veçantë në përmirësimin efiçencës në mbledhjen dhe ndikimin e tyre në rritjen ekonomike të vendit.

1.4. Pyetjet studimore dhe hipotezat statistikore të studimit

Për të realizuar objektivat e studimit, gjatë këtij hulumtimi është synuar t'i jepet përgjigje tri pyetjeve studimore:

P1- Cilat janë trendët dhe struktura e të ardhurave publike në Kosovë?

P2 - Cili është ndikimi i efiçencës të të ardhurave publike në rritjen ekonomike në Kosovë?

Për të realizuar përgjigjen e pyetjes studimore P1, është përdorur metoda e statistikës deskriptive, interpretimi i rezultateve të të cilës është shoqëruar me fakte dhe të dhëna zyrtare të institucioneve përgjegjëse në Kosovë. Paraqitja grafike është përdorur gjerësisht për ilustrimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve.

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes studimore P2 janë përdorur metodat ekonometrike nëpërmjet testimit të hipotezave statistikore:

H1: Efiçenca e të ardhurave publike ndikon në rritjen ekonomike të Kosovës.

Për testimin e hipotezave është përdorur modeli ekonometrik VAR dhe VECM, i shoqëruar me verifikimin e nevojshëm të signifkancës dhe vlefshmërisë statistikore të rezultateve të nxjerra me anë të këtyre modeleve.

1.5. Mundësitë dhe kufizimet në studim

Ky hulumtim përfshin të dhënat për periudhën 2004-2016 të marra nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare . Arsyeja se pse kemi filluar pikërisht nga viti 2004 ka qenë se nga ky vit institucionet vendore kanë filluar të përgatisin raporte të rregullta mbi mbledhjen e të ardhurave publike dhe nxjerrjen e të dhënave për Produktin e Brendshëm Bruto.

Gjatë mbledhjes së të dhënave, ne kemi hasur në vështirësi në sigurimin e të dhënave burimore për këtë hulumtim, për arsye se Kosova kishte dalë nga lufta me një sistem ekonomik të shkatërruar gati tërësisht. Periudha 1999-2004 karakterizohet me një udhëheqje absolute të Kosovës nga Misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Gjatë kësaj periudhe janë ndërtuar institucionet e reja të vendit si dhe është bërë ngritja e sistemit të ri ekonomik dhe fiskal të vendit. Meqenëse kjo periudhë karakterizohet me ngritjen e sistemit ekonomik nga ky mision, atëherë ka qenë e vështirë të krijohen raporte të rregullta periodike financiare (tremujore) dhe fatkeqësisht për këtë periudhat mungojnë të dhënat statistikore për Kosovën. Prandaj, duke u nisur nga fakti se raportet periodike (tremujore) mbi të ardhurat publike kanë filluar të përgatiten nga viti 2004, ne kemi qenë të detyruar që hulumtimin tonë ta fillojmë nga kjo periudhë. Në vështirësi kemi hasur

edhe në sigurimin e të dhënave periodike (tremujore) për Produktin e Brendshëm. Institucionet e vendit me përgatitjen e raporteve periodike për PBB-në kanë filluar nga viti 2010, ndërsa para viti 2010 është raportuar vetëm mbi bazën vjetore. Duke u gjendur para një sfide në sigurimin e informatave tremujore mbi PBB-në për periudhën 2004-2009, unë jam detyruar që të dhënat vjetore të zërthej në të dhëna tremujore duke u bazuar në trendet e rritjes së PBB-së, si dhe informatave të tjera relevante të marruara nga raportet e institucioneve të ndryshme, siç janë Banka Qendrore e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Financave, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

1.6. Rëndësia e studimit

Ky studim do të ketë rëndësi shkencore dhe praktike në formulimin e politikave më efektive në reformimin e sistemit ekonomik dhe ndikimin e këtij sistemi në rritjen e mbledhjes së të hyrave për të arritur qëndrueshmërinë fiskale dhe buxhetore duke zvogëluar ekonominë joformale dhe evazionin fiskal.

Së pari, ky studim do të ofrojë një analizë të sistemit ekonomik dhe fiskal të vendit dhe ndikimin e tyre në performancën e institucioneve kryesore, siç janë ATK, doganat, ministritë dhe komunat në mbledhjen e të hyrave publike. Meqenëse politikat e përdorura nga institucionet e Kosovës deri me tani nuk kanë qenë efektive në këtë sektor, atëherë ky studim do të ofrojë një analizë të thukët. Së dyti, ky punim do të ofrojë argumente mbi atë se cilat politika janë përdorur dhe si do të duheshin të qeverisin institucionet e Kosovës në ngritjen e performancës në arritjen e qëndrueshmërisë fiskale.

Gjatë përgatitjes për fillimin e hulumtimit, kam vërejtur se sfida tjetër shumë e rëndë për institucionet e Kosovës është niveli shumë i lartë i ekonomisë joformale dhe evazionit

fiskal, sidomos ai në kufi ku shpesh nuk arrihet objektivi i qeverisë në grumbullimin të hyrave. Nga kjo që u tha më lartë, rreziku është i madh që stabiliteti buxhetor të rrezikohet, me ç'rast kjo do të reflektohet me një rritje jo të mirë ekonomike. Gjithashtu, gjatë analizës sonë sfidë tjetër për institucionet tjera ka qenë se mbledhja tek të hyrat buxhetore në raport me BPV, në vitet e fundit nuk ka shënuar ndonjë progres. Këtë e vërtetojnë më së miri të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Të dhënat e ofruara nga ky studim do të mund të aplikohen nga Qeveria e Kosovës në përmirësimin e politikave fiskale të cilat do të ndikonin në rritjen e nivelit në mbledhjen e të hyrave buxhetore dhe në këtë mënyrë të rriten edhe investimet publike të cilat do të ndikonin në rritjen ekonomike të vendit.

1.7. Përmbajtja e shkurtër e punimit të diplomës

Ky hulumtim është i organizuar në pesë kapituj. Kapitulli i parë, hyrja, përbëhet nga përkufizimi i problemit, qëllimi dhe objektivat e studimit, hipoteza, pyetja kërkimore si dhe mundësitë dhe kufizimet në hulumtim. Kapitulli i dytë ka të bëjë me metodologjinë e hulumtimit i cili përbëhet nga hyrje në hulumtim, burimin e të dhënave, teknikat e vlerësimit, saktësimin e modelit të hulumtimit, zgjedhjen e variabëlve dhe përshkrimi i tyre. Kapitulli i tretë, Korniza Teorike përbëhet nga një vështrim teorik për politikën fiskale, instrumentet dhe sistemin ekonomik, mbi të ardhurat, efikasitetin e mbledhjes së të ardhurave publike dhe rritjen ekonomike, klasifikimin, strukturën, efikasitetin dhe shpjegimin e të ardhurave publike dhe rritjen ekonomike në Kosovë, teorinë kryesore mbi të ardhurat dhe rritjen ekonomike në botë. Dhe në fund të këtij kapitulli kemi përmbledhur rezultatet e kërkimeve empirike nga ekonomistët dhe teoricienët më eminent të cilët kanë bërë hulumtimet në këtë fushë. Kapitulli i katërt ka të bëjë me analizën empirike duke

bërë një analizë përshkruese të ardhurave publike në Kosovë mbi strukturën dhe trendët në mbledhjen e të ardhurave dhe një analizë ekonometrike mbi efektin e të ardhurave publike në rritjen e ekonomike duke interpretuar rezultat e gjetjeve. Kapitulli i pestë, konkluzione dhe përfundimi mbi hulumtimin si dhe rekomandimet. Më pastaj, para referencave (bibliografisë) është shtojca. Fare në fund të hulumtimit janë prezantuar edhe burimet e të dhënave (referencat).

KAPITULLI II: METODAT DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

2.1. Hyrje

Ky kapitull paraqet metodologjinë e përdorur për të analizuar ndikimin e të ardhurave publike në rritjen ekonomike të Kosovës përmes indikatorit kryesor të PBB-së nga viti 2004 deri me 2016, të ndara në periudha tremujore.

Ky studim do të fillojë me një shqyrtim teorik të literaturës për të ardhurat buxhetore (publike) duke vazhduar me një analizë empirike me metodën kuantitative (sasiore) e cila kërkon të kuptojë sjelljen e saj duke përdorur të dhënat e nxjerra nga publikimet e Ministrisë së Financave, Bankës Qendrore të Kosovës, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Në fillim të këtij studimi do të ketë një analizë përshkuese të trendëve, strukturës së të ardhurave publike dhe efikasitetin në mbledhjen e të ardhurave publike, duke përdorur teknikat e ndryshme të mundshme për t'i shqyrtuar prirjet dhe strukturën e të dhënave tona ndër vite. Ne kemi supozuar se ndryshimet në variabla janë pa gabime dhe nëse ato janë pa gabime, atëherë ato mund të paraqiten në tabela dhe diagrame.

Në vazhdim të studimit ne do të aplikojmë analizën me metodat ekonometrike, (që ndryshon nga analiza përshkuese) e cila përdoret (zbatohet) për të analizuar ndikimin e të ardhurave publike në rritjen ekonomike të Kosovës. Dizajni i këtij hulumtimi është studim shpjegues që ka për qëllim për të verifikuar hipotezat në ndikimin e variabëlve të pavarura në variabil të varur.

2.2. Burimet e të dhënave

Seria e të dhënave e përdorur në studim për analiza përfshin: Produkti i Brendshëm

Bruto (PBB) që është PBB me çmime nominale, të Ardhurat Tatimore (TAT), të Ardhurat Jo Tatimore (TAJT) dhe të Ardhurat nga Grandet (TAG).

Të dhënat e përdorura në studim janë marrë nga burimet dytësore. Për testimin e modeleve janë mbledhur të dhëna tremujore nga Ministria e Financave, Banka Qendrore e Kosovës, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës për periudhën 2004-2016.

2.3. Teknikat e vlerësimit

Ky kapitull shpjegon teknikat e vlerësimit që përdoren për të analizuar efektin e të ardhurave publike në rritjen ekonomike.

Në këtë studim ne kemi ndërtuar modelin VAR të shoqëruar me modelin e përmirësimit (korrigjimit) të gabimit (VECM), strategji kjo e ngjashme me strategjitë e ndjekura nga shumë hulumtues të tjerë, si (Anastassiou and Dritsaki, 2005), (Ogunleye, 2008). Gjithashtu këtë model të hulumtimit e ka aplikuar (Jegede, 2014) dhe (OTUBALA, 2014). Ndërtimi i modeleve VAR dhe VECM është shoqëruar me vlerësimet dhe konkluzionet statistikore të cilat sigurojnë saktësinë e modeleve të ndërtuara si dhe cilësinë e tyre.

2.4. Saktësimi i modelit (Specifikimi i modelit)

Modelet e autoregresionit vektorial (VAR) u prezantuan nga makroekonometristi (Sims, 1980) për të modeluar dinamikën e përbashkëta dhe marrëdhëniet shkakësore midis një vargu të variabëlve makroekonomike. Modelet VAR janë të dobishme për parashikimin statistikor dhe probabilitar të sjelljes (zhvillimit) të një variabëli makroekonomik, kur ky variabël ndikohet nga një bashkësi të variabëlve të tjerë makroekonomik. Modelet e këtij

lloji mund të jenë univariat (vetëm me një regresor) ose multivariat (me shumë regresorë). Për shembull, në modelin auto regresiv univariat: $Y_t = \alpha + \beta Y_{t-1} + \varepsilon_t$, i cili përshkruan dinamikën e vetëm një ndryshore të rastit Y_t (p.sh. të ardhurat kombëtare) si një funksion linear i së kaluarës së vet. Bazuar në këtë model, parashikimi i të ardhurave kombëtare varet vetëm nga historia e tij e kaluar. Megjithatë, variabëlët ekonomikë siç janë të ardhurat kombëtare, të ardhurat nga tatimet, të ardhurat jo tatimore, të ardhurat nga grandet e ndryshme dhe kështu me radhë, ndër veprojnë me njëri-tjetrin. Në këtë mjedis multivariat, parashikimi i të ardhurave kombëtare do të jetë një funksion i një grupi të gjerë informacioni që kombinon jo vetëm historinë e të ardhurave kombëtare, por edhe historitë e shumë ndryshoreve të tjera. Një VAR është përgjithësimi i modelit auto regresiv univariat për një vektor të variabëlve ekonomikë.

Përkufizimi formal i modelit VAR është: Një autoregression vektorial i n-variabëlve i rendit k, VAR (k), është një sistem i n- ekuacioneve lineare, ku secili ekuacion përshkruan dinamikën e një variabëli si një funksion linear i vonesave të mëparshme k, të çdo variabëli në sistem, duke përfshirë edhe vonesat e veta.

Në këtë përkufizim, n shpreh numrin e variabëlve në model, i cili është i barabartë me numrin e ekuacioneve në sistem, ndërsa k shpreh numrin identik të vonesave (lag) për secilin nga n variabëlët në anën e djathtë të secilit ekuacion.

Specifikimi linear autoregresiv i secilit ekuacion ka trajtën matematikore:

$$Y_t = c + \sum_{i=1}^k a_i^{(1)} X_{1,t-i} + \dots + \sum_{i=1}^k a_i^{(n)} X_{n,t-i} + \sum_{i=1}^k b_i Y_{t-i} + \varepsilon_t \quad (\text{Barazimi 2.1})$$

Ku:

Y_t është variabëli që studiohet (variabëli i varur) në kohë reale t;

c është konstantja e modelit;

k është numri i vonesave (lags);

$a_i^{(1)}, \dots, a_i^{(n)}$ janë koeficientet e regresorëve (vektori i variabëlve të pavarur);

$X_{1,t-i}, \dots, X_{n,t-i}$ janë regresorë (variabëlët e pavarur);

Y_{t-i} dhe b_i janë variabëli i varur me t-i kohë vonesë dhe koeficientet përkatës;

ε_t është termi i gabimit.

Të dhënat që përdoren në studime të këtij lloji, janë në përgjithësi seri kohore. Për këtë arsye, rekomandohet që të dhënat të shprehen me anë të logaritmit natyror të vlerave reale të tyre me qëllim përfshirjen e efekteve riprodhuese të serive kohore që krijohen me të dhënat e marra në studim. Në këtë mënyrë, ekuacioni matematik i shprehur me anë të Barazimit 2.1 merr trajtën:

$$\ln(Y_t) = c + \sum_{i=1}^k a_i^{(1)} \ln(X_{1,t-i}) + \dots + \sum_{i=1}^k a_i^{(n)} \ln(X_{n,t-i}) + \sum_{i=1}^k b_i \ln(Y_{t-i}) + \varepsilon_t$$

(Barazimi 2.2)

Barazimi 2.2 është një paraqitje ekonometrike e modelit VAR i cili shpreh marrëdhënien lineare ndërmjet variabëlët të varur dhe variabëlve të pavarur, por kjo lidhje funksionale është e pakufizuar (unrestricted model) për faktin se përmban një vektor të pakorrigjuar me marginale gabimet në vlerësimin e koeficienteve të modelit, të cilat shpesh bëjnë që modele të tilla të jenë jashtë kufijve të lejueshëm të përshtatshmërisë statistikore të modelit. Për të minimizuar riskun e anomalive parashikuese që vijnë si rezultat i pakufizueshmërisë së modelit, mbi modelin VAR, ndërtohet modeli i kufizuar VAR i cili quhet VECM (Vector Error Correction Model). Për ndërtimin e modelit VECM është e nevojshme përmbushja e disa kriterëve të caktuara të cilat janë marrë në konsideratë në ndërtimin e modelit tonë, ku ndër ta më i rëndësishmi është kriteri i co-integritit. Në qoftë se variabëlët janë të co-integruara, ose ndryshe variabëlët kanë një marrëdhënie afatgjatë statistikore dhe ekziston të paktën një ekuacion i ko-integruar, atëherë mund të

ndërtojmë mbi modelin e pakufizuar VAR, një model me vektor të gabimit të korigjuar, VECM.

Për të ndërtuar modelin VECM të një modeli VAR është e domosdoshme të realizohen tre etapa: (i) përcaktimi i numrit të time-lags (vonesave në kohë ose ndryshe, intervaleve kohore) të cilat përfaqësojnë diferencën në kohë nga njëri vërtetim në tjetrin në një seri kohore vërtimesh; (ii) testi i co-integritit; dhe (iii) vlerësimi i koeficienteve të VECM dhe testimi i hipotezave për këta koeficient.

Përparësitë e modelit VAR dhe VECM qëndrojnë në lehtësinë e zbatimit të tyre. Duke qenë se çdo ekuacion në VAR/VECM ka të njëjtin numër të variabëlve në anën e djathtë, koeficientet e modelit vlerësohen lehtë duke aplikuar metodën e zakonshme të katrorëve më të vegjël [ordinary least squares (OLS)] në secilën ekuacion individualisht. Vlerësuesi OLS ka vetitë standarde asimptotike dhe në mostra me vëllim të madh, vlerësuesi OLS, është i qëndrueshëm dhe ka shpërndarje asimptotikisht normale.

2.4.1. Testi i palëvizshmërisë (Test of Stationarity)

Pasi që të dhënat e serive kohore janë krijuar nga një proces rastësor, të dhënat e tilla mund të jenë stacionare (të palëvizshme) ose jostacionare (jo të palëvizshme). Para se ta përdorim për analizë do të hetohen (studiohen) vetitë e tij. Kjo është për të treguar nëse ndryshoret (variablet) janë të palëvizshme apo jo. Sipas përkufizimit, procesi i palëvizshëm është ai proces i shpërndarjes së përbashkët ose të kushtëzuar (e kondicionuar) e të cilit është e pandryshueshme përsa i përket zhvendosjes në kohë, (Pinduck, R. S. dhe Rubinfeld, D. L., 1998). Palëvizshmëria është e rëndësishme për arsye se nëse të dhënat e serisë kohore janë të palëvizshme (stacionare), testet klasike t- dhe F- janë jo të përshtatshme (joadekuate). Problemi i rënies (prapashkuarjes) së rreme (shtirë)

do të lindë kur përdoren të dhënat e palëvizshme (pandryshueshme), (Granger, C.W.J dhe Newbold, P, 1974). Testet e ndryshme të palëvizshmërisë përfshijnë, analizën grafike, testin e korrelogramit dhe testin e rrënjës së njësisë.

2.4.2. Testi i rrënjës së njësisë (Unit Root Test)

Testi i rrënjës së njësisë përfshin testimin e rendit të integritit të serive ndivduale nën konsiderim (shqyrtim). Sipas (Iyoha, M. and Ekanem, O.T., 2004), Testimi për rrënjën e njësisë është një koncept kyç në studimin e modelit të serive kohore dhe bashkë-integrimit. Sipas përkufizimit procesi rastësor Y_t , njihet si rrënjë e njësisë, nëse ndryshimi i (diferenca e) tij $Y_t - Y_{t-1}$ është i palëvizshëm (pandryshueshëm) 1 (1). Kjo domethënë se testimi për njësinë e rrënjës është i barabartë me testimin, qoftë ai proces rastësor apo jo. Për të testuar për rrënjën e njësisë janë zhvilluar disa procedura për testin e integritit.

Dy më të popullarizuarat janë testi i rrënjës së njësisë Augmented Dickey dhe Fuller (ADF) sipas (Dickey, D.A. and Fuller, W.A., 1981) dhe testi i rrënjës së njësisë Philips dhe Fuller nga (Philips, P.C.B and Fuller, P., 1988).

Në këtë studim qasja ADF për testin e rrënjës së njësisë është adoptuar sepse ai kontrollon rendin më të lartë të ndërlidhjes (bashkëlidhjes) serike duke shtuar termat e vonuara të ndryshimit në anën e djathtë të regresionit (prapavajtjes) dhe përdoret po ashtu gjerësisht. Hipoteza nule e këtij testi është se ekziston të paktën një rrënjë e njësisë (domethënë se të dhënat e serisë kohore janë jo të përhershme. Në kryerjen e testit ADF, ne jemi marrur me dy çështje të rëndësishme. Së pari, ne kemi caktuar nëse t'i përfshijmë termat deterministe në regresion (prapavajtje. Ne e kemi zgjedhjen e përfshirjes së një konstanteje, një trendi constant dhe linear ose të asnjërit prej tyre në regresion

(prapavajtje). Çështja e dytë është të zgjedhim gjatësinë e vonesës, e cila duhet të caktojë numrin e termave të ndryshimit të vonuar që duhet t'i shtohen testit të regresionit (prapavajtjes). Këshilla e zakonshme është të përfshihet numri i mjaftueshëm i vonesave për ta hequr ndërlidhjen (korrelacionin) serial në mbetje.

Forma e përgjithshme e ADF për testin e rrënjës së njësisë është dhënë si:

$$\Delta y_t = \alpha + \gamma y_{t-1} + \delta_1 \Delta y_{t-1} + \delta_2 \Delta y_{t-2} + \dots + \delta_{p-1} \Delta y_{t-p} + \varepsilon_t$$

(Barazimi 2.3)

ku; Y_t është seri kohore, α është një konstante, t është trend kohor linear, Δ është operatori i parë i ndryshimit, ε_t është termi i shqetësimit të zhurmës së bardhë.

Pasi që rezultatet dihen se janë të ndijshme ndaj gjatësisë së vonesës, atëherë zgjedhja e gjatësisë më të madhe të vonesës do të bazohet në dy kritere të ndryshme: kriterin e informimit të Schwarzit (SIC) dhe kriterin e informimit të Akaiikes (AIC). SIC kërkon dënim (gjobë) më të lartë për koeficientin shtesë. AIC kërkon më pak dënime (gjoba) ndaj koeficientëve shtesë.

Përcaktimi Augmented Dickey Fuller i testit të rrënjës së njësisë shpesh kryhet nën hipotezën zero $\gamma = 0$ ndaj hipotezës alternative të $\gamma < 0$.

Hipoteza zero testohet ndaj hipotezës alternative

$$H_0: \gamma = 0, H_1: \gamma < 0$$

Vëzhgimi testohet së pari në nivelet për ta ditur nëse vlerat ADF janë më të mëdha se vlerat kritike të Mackinnonit në zgjedhjen e nivelit të rëndësisë, pastaj ne do ta refuzojmë hipotezën zero të palëvizshmërisë (pandryshueshmërisë) dhe do të vendosim se të dhënat janë të pandryshueshme.

2.4.3. Testi i bashkë-integrimit (Co-Integration Test)

Një pjesë e rëndësishme e teorisë ekonomike merret në përgjithësi me marrëdhënien e baraspeshës afatgjate të krijuar nga forcat e tregut dhe rregullat e sjelljes. Në përputhje me këtë, shumica e studimeve ekonometrike të cilat shkaktojnë (nxjerrin) seritë kohore mund të shpjegohen si tentativë (përpyetje) për të vlerësuar një marrëdhënie të tillë në një kuadër dinamik. Qëllimi i analizës bashkë integruese është të ndërtojë marrëdhënien e baraspeshës afatgjatë ndërmjet ndryshoreve ekonomike.

Sipas (Granger C. , 1988), testi i bashkë integrimit mund të mendohet si para test për të shmangur prapavajtjen (regresionin) e rremë, duke pasur parasysh një grup të serive (vargjeve) të pandryshueshme. Ndryshoret duhet të jenë të bashkë integruara nëse e kanë të njëjtën gjatësi valore ose nëse janë të integruara me të njëjtën renditje sipas periudhës shembull. Bashkë integrimi gjithashtu nënkupton që lëvizjet afatgjata në ndryshore ndërlidhen me njëra tjetrën në një marrëdhënie baraspeshe afatgjatë.

Disa metoda për testin e bashkë integrimit janë zhvilluar, por çështja më e rëndësishme është zgjedhja e metodës. Metodatat e ndryshme janë: Metoda e Engel dhe granger dy hapeshe, gjasat më të mëdha të Johansen (MLD), Dickey Fuller (DF) ose rrënja e njësisë së Augmented Dickey Fuller, testi mbi mbetjen e vlerësuar nga prapavajtja e bashkë integruar, procedura e prapavajtjes së integruar Durbin Watson, testi Johansen dhe Juselius.

Për testin e bashkë integrimit përdorim gjasën më të madhe të themeluar nga (Johansen, S. and Juselius, K., 1990) dhe (Johansen, 1991) për të ekzaminuar ekzistimin e marrëdhënies afatgjatë ndërmjet PBB-ës dhe të ardhurave të ndryshme publike të përdorura në studim në nivelin 5% dhe 1% të rëndësisë për secilin.

Metodologjia Johansen dhe Juselius e bashkë-integrimit e merr pikën e vet fillestare (fillestare) në vektorin auto regresion (VAR) të rendit p të dhënë me:

$$Y_t = A_1 Y_{t-1} + \dots + A_p Y_{t-p} + \beta x + v_t$$

(Barazimi 2.4)

Ku:

Y_t është k vektor i ndryshoreve të palëvizshme 1 (1)

X_t është d vektor i ndryshoreve përcaktuese

β vektori bashkë-integrues

v_t është vektor i termit shqetësues (pengues) të zhurmës së bardhë.

Për ta përcaktuar numrin e vektorit bashkë-integrues, (Johansen, S. and Juselius, K., 1990), dhe (Johansen, 1991) kanë sugjeruar dy teste statistike: i pari është testi i gjurmës (trace test) (λ gjurma). Ai e teston hipotezën zero sepse numri i vektorit dallues bashkë integrues është më i vogël se ose i barabartë me q ndaj një alternativave të përgjithshme $q=r$. Testi i dytë statistikor është testi i vlerës më të madhe eigen (λ max). Testi ka të bëjë me testin e hipotezës zero sepse ekziston një numër i vektorit bashkë integrues ndaj alternativës se $r+1$ vektori bashkë-integrues.

2.4.4. Modeli i Përmirësimit të Gabimit të Vektorit (Vector Error Correction Model)

VECM është një VAR i kufizuar që ka një kufizim ko-integrimi të ndërtuar në specifikim për përdorim me seritë jo të lëvizshme (stacionare) të cilat dihen se janë të bashkë-integruara.

Specifikacionet VECM e ndalojnë sjelljen afatgjatë të ndryshoreve burimore për të kaluar në marrëdhënien e tyre afatgjatë duke lejuar në gamë të gjerë të dinamikës afatshkurtër. Termi i bashkëintegritimit njihet si termi i Përmirësimit të Gabimit. Pasi që devijimi (shmangia) nga baraspesha afatgjatë është e ndërlidhur gradualisht me anën e një varg përshtatjeve afatshkurtëra. Ne e riformulojmë VAR-in/Vektorin e prapavajtjes (regresionit) në VECM- Model të Përmirësimit të Gabimit të Vektorit në të cilin përfshihet termi i përmirësimit të gabimit.

Duke i përdorur katër ndryshoret me interes, të cilët janë Produkti i Brendshëm Bruto (PBB), të ardhurat tatimore (TAT), të ardhurat jo tatimore (TAJT), dhe të ardhurat nga grandet (TAG), VAR (Vektori i auto regresionit) i riformuluar në VECM (Model të Përmirësimit të Gabimit të Vektorit) jepet si:

$$\Delta Y_t = \alpha \beta_t Y_{t-1} + \Gamma + \varepsilon_{1t}$$

(Barazimi 2.5)

Ku: Y_t është vektor i ndryshoreve të brendshme (PBB, TAT,TAJT,TAG)

α është parametri i cili e mat shpejtësinë me të cilën ndryshoret në sistem i përshtaten vlerave të tyre afatgjata.

β_t vektorët vlerësohen për marrëdhënien afatgjatë të bashkë integritimit ndërmjet ndryshoreve në model.

Γ është parametri i shoqëruar me ndryshoret e jashtme.

ε_t është gabimi stokastik (i rastit) i termit,

Γ është parametër i lëvizshëm

2.4.5. Testi i Shkakësisë-Granger (Granger- Causality Test)

Testi i Shkakësisë - Granger kryhet për të përcaktuar nëse vlerat aktuale dhe të vonuara të një ndryshore ndikojnë në tjetrën (nëse të ardhurat publike e shkaktojnë rritjen ekonomike ose e kthejnë shkakësinë nga rritja ekonomike në të ardhura publike mund të ekzistojnë po ashtu.) Sepse është problem i zakonshëm në ekonomi nëse ndryshimi në një ndryshore është shkak i ndryshimeve në tjetrën.

Testit Granger i shkakësisë supozon se informacioni (informata) për parashikimin e ndryshoreve X_t dh Y_t është e përfshirë vetëm në të dhënat e serive kohore të këtyre ndryshoreve. Korniza Granger e shkakësisë e paraqitur nga (Granger C. W., 1969) dhe (Sims, 1980) ishte përdorur për këtë qëllim.

Testi përfshin vlerësimin në regresionet e mëparshme.

$$X_t = \sum_{i=1}^k \alpha_i y_{t-1} + \sum_{j=1}^k \beta_j X_{t-j} - 1 + u_t$$

(Barazimi 2.6)

$$Y_t = \sum_{j=1}^m \gamma_j y_{t-1} + \sum_{j=1}^m \delta_j X_{t-j} + u_{2t}$$

(Barazimi 2.7)

Barazimi 2.6 supozon se X aktual është i ndërlidhur (ndërlidhet) me vlerat e kaluara të vetë X , si dhe të Y , ndërsa barazimi 2.7 supozon një sjellje të ngjashme të Y . Përgjithësisht, nëse Y Granger shkakton X , atëherë ndryshimet në Y do të duhej t'iu paraprinin ndryshimeve në X . Prandaj, për një prapavajtje/ regresion të X në një ndryshore tjetër (duke përfshirë vlerat e veta të kaluara), nëse i përfshijmë vlerat e kaluara ose të vonuara të Y dhe ai dukshëm përmirëson parashikimin e X , atëherë mund të themi se Y Granger e shkakton X . Një përkufizim i ngjashëm nëse X Granger shkakton Y . Një

karakteristikë e rëndësishme e Testit Granger të shkakësisë është se ata supozojnë përdorimin e të dhënave të pandryshueshme (palëvizshme).

Në këtë studim, Y përdoret për të dhuruar Produktin e Brendshëm Bruto të Rritur. $X =$ Të ardhurat e rritura publike të zbërthyera në të Ardhura Tatimore, të Ardhura Jo Tatimore dhe të Ardhura nga Grandet.

Ho: X_t Granger nuk e shkakton Y_t

Hi: X_t Granger e shkakton Y_t

Rregulla e vendimit kërkon që F - statistika që shpesh përdoret për të testuar nëse koeficienti është statistikisht ndryshe nga zero, atëherë, ne mund ta refuzojmë hipotezën zero se “ X_t nuk e shkakton Y_t ”.

2.4.6. Funksioni i Përgjigjes së Impulsit (Impulse, Response Functions)

Ne e kemi përdorur analizën e funksionit të përgjigjes së impulsit duke e përdorur përfaqësimin mesatar lëvizës të barazimit VAR për të studiuar marrëdhënien dinamike të ndryshoreve nën hetim (hulumtim).

Funksioni i përgjigjes së impulsit e ndjek efektin neto e goditjeve të devijimit të një standardi (norme) në njërën prej risive mbi vlerat aktuale dhe të ardhshme të ndryshoreve të brendshme.

2.4.7. Zbërthimi i mospërputhjes (Variance Decomposition)

Metoda e zbërthimit të mospërputhjes (ndryshimit) është përdorur për ta vlerësuar kontributin dhe rëndësinë relative të secilës prej ndryshoreve në sistem. Zbërthimi i mospërputhjes e zbërthen ndryshimin në një ndryshore të brendshme në goditje përbërëse

në VAR; ajo gjithashtu e mat propozimin e gabimit të parashikimit në vlerat aktuale dhe të ardhshme të inovacionit (risimit) ndaj çdo ndryshore të brendshme në VAR. Përqindja e mospërputhjes (ndryshimit) për shkak të çdo inovacioni me radhë shtohet në 100%.

KAPITULLI III: KORNIZA TEORIKE

3.1. Një vështrim teorik

Sot në botë ka literaturë mjaft të gjerë të cilat merren me vështrimin teorik dhe empirik të politikës fiskale, të te ardhurave publike, efikasitetin së mbledhjes së të ardhurave publike dhe ndikimin e tyre në rritjen ekonomike të vendit. Kjo literaturë është e llojllojshme dhe e vendeve të ndryshme të cilat merren me këtë problematikë. Këto tema janë trajtuar që nga kohët më të lashta, që nga kohërat kur e ka zanafillën krijimi i shtetit. Pra, me krijimin e shtetit kanë filluar edhe shkrimet rreth të ardhurave publike, politikës fiskale dhe çështjeve tjera që lidhen me financën publike, ndër mendimtarët që janë marrë në mënyrë më të detajuar me çështjet e të ardhurave publike dhe rritjes ekonomike janë edhe (Smith, 1776); (Solow, 1956); (Swan, 1956); (Rommer, 1986), dhe hulumtuesit më të rinj si: (Manciw, 2003); (Anastassiou and Dritsaki, 2005); (Rosen, 2010); (OTUBALA, 2014); (Reed R. W., 2007) (Jegade, 2014), etj. Gjithashtu me këtë problematikë janë marrë edhe shumë hulumtues vendor, siç janë : (Badivuku- Pantina, M dhe Maloku, E., 2012); (Kadriu, 2012); (Kryeziu, 2012); (Berisha, 2015); (Sylqa, D. dhe Kastrati, F., 2016); (RIINVEST, 2001); (Shala, 2016); etj.

Me qenë se kjo literaturë është mjaft e gjerë dhe e shtirë në kohë të ndryshme, në këtë punim është paraqitur një përmbledhje e kësaj literature e cila do i kishte dhënë përgjigje dhe zë të duhur në pyetjet kërkimore të ngritura në këtë punim . Ky punim do të trajtojë të ndara të ardhura publike, duke u fokusuar në rend të parë në përkufizimet shkencore, teoritë e ngritura ndër vite, dhe më pastaj duke u marrë me të gjeturat e nga hulumtimet më të fundit. Për të gjitha këto ekziston një literaturë bashkëkohore dhe mjaft e gjerë në botën akademike dhe shkencore. Më çështjen e të ardhurat publike janë marrë shumë teoricienë, ekonomistë, juristë dhe hulumtues të tjerë të financave publike, siç janë:

(Smith, 1776), (Seligman, 1895), (Dalton, 1949), (Taylor, 1959), (Jelçiç, 1985), (Kadriu, 2012), (Kryeziu, 2012) , (Berisha, 2015), etj.

Gjithashtu, edhe për rritjen ekonomike kanë hulumtuar dhe shkruar shumë teoricienë dhe hulumtues, siç janë: (Solow, 1956); (Rommer, 1986); (Odedokun, 2001); (Lucas, 1988); (Barro, 1999); (Badivuku- Pantina, M dhe Maloku, E., 2012); (Carboni, 2013); etj. Për eficientë në mbledhjen e të ardhurave publike është diskutuar mjaft deri më tani. Shumë hulumtues janë marrë me këtë çështje, duke filluar nga Aedin dhe Biggs (1998), (Kiazme, 20...), (Rosen, 2010), Qwitta, 2010), (Gradstein, 1999), (Shala, 2017), etj.

Që nga periudhat e hershme të njerëzimit dhe deri me sot janë zhvilluar shumë hulumtime të ndryshme për të parë marrëdhëniet dhe efektin në mes të të ardhurave publike në rritjen ekonomike. Ndër autoret më të mirënjohur që janë marrë me këto hulumtime kanë qenë edhe: (Anastassiou and Dritsaki, 2005); (Reed R. , 2008); ((Janes, E. Ihendinihu, J.U. dhe Nwaiwu, J.N., 2015); (Jegade, 2014); (Shala, 2017) dhe shumë hulumtues të tjerë.

Politika fiskale dhe sistemi tatimor është trajtuar mjaft gjerë nga hulumtues dhe dijetarë gjithashtu. Me këtë çështje janë marrë hulumtues dhe mendimtarë si: (Hansen, 1949); (Blinde, A.S and Solow, R. M, 1974); (Manciw, 2003); (Weil, 2008); (Andrés, J. , Boscá, J.E. and Ferri, J., 2015); (Kadriu, 2012); etj.

Duke u bazuar në këtë literaturë mjaftë të gjerë dhe të shumëllojshme nga një numër mjaft i madh hulumtuesish dhe mendimtarësh, unë në vazhdim të këtij punimi kam paraqitur një vështrim të përgjithshëm teorik mbi të ardhurat publike, eficientë e mbledhjes së tyre, sistemin ekonomik - fiskal dhe rritjen ekonomike.

3.2. Përkufizimi i sistemit ekonomiko-fiskal

3.2.1. Politika fiskale

Në shkencën bashkëkohore mbi financat publike dhe të drejtën financiare, në të drejtën kushtetuese, sistemi dhe politika fiskale-financiare trajtohen dhe paraqesin shprehjen më të lartë të sovranitetit të një populli (Kadriu, 2012). Politika fiskale është një disiplinë e re shkencore financiare. Pas krizës së madhe të viteve 1928-33 dhe pas krizave të tjera të mëvonshme, roli i intervenimit të shtetit në jetën politike ekonomike është rritur dukshëm dhe për këtë qëllim ka filluar të zhvillohet kjo shkencë e re.

Në literaturën amerikane dhe anglosaksone fjala “fiskal policy” nënkupton politikën që ka të bëjë me arkën e shtetit që përfshinë të hyrat dhe shpenzimet publike. Gjithashtu, edhe në literaturën evropiane, posaçërisht në atë franceze, me politikë dhe sistem fiskal nënkupton politika dhe sistemi i të hyrave publike shtetërore. Termi "politike fiskale" zakonisht përdoret për të përshkruar efektin në ekonominë agregate të niveleve të shpenzimeve të përgjithshme dhe të taksave, dhe më veçanërisht, hendekun midis tyre, (Weil, 2008). Në përkufizimin e politikës fiskale shumë autorë e trajtojnë si stabilizues të sistemit fiskal. Autorët (Blinde, A.S and Solow, R. M, 1974). Politika fiskale në aspektin teorik është përpunuar në kontest të teorisë së politikës ekonomike në planin makroekonomik si instrument i rregullimit anticiklik të kërkesës efektive e cila mund të ndikojë në madhësinë dhe strukturën e ofertës (Hansen, 1949). Me fjalë të tjera, politika fiskale ka qëllim kryesor sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare nëpërmes instrumenteve të sistemit fiskal për financimin e shpenzimeve publike (Kadriu, 2012). Politika fiskale ndikon drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë në ekonominë e vendit (Sylqa, D. dhe Kastrati, F., 2016). Me politikë ekonomike kuptojmë tërësinë e masave ekonomike që ndërmerr shteti ose bashkësitë shoqërore politike për realizimin e

qëllimeve të shtetit në ekonomi. Në këtë kontekst të politikës ekonomike duhet shikuar edhe politikën fiskale. Në përcaktimin dhe realizimin e politikës ekonomike si dhe të politikës fiskale si pjesë e një tërësie është me rëndësi (Kadriu, 2012):

- roli i subjekteve-organeve si bartës të politikës ekonomike dhe politikës fiskale,
- përcaktimi i qëllimeve të politikës ekonomike dhe të politikës fiskale,
- përcaktimi i instrumenteve në realizimin e qëllimeve dhe politikës ekonomike dhe nëpërmes politikës fiskale.

Politika ekonomike në brendinë e saj përfshinë financat publike në këtë kontest edhe politikën fiskale, financat monetare, politikën e çmimeve, tregtinë e jashtme, politikën e të ardhurave, auditivin etj.

Në kohën e tanishme, shkenca mbi financat publike, politika fiskale dhe sistemi fiskal trajtohen dhe paraqesin shprehjen më të lartë të sovranitetit të një shteti. Vendimet lidhur me politikat fiskale në masë të madhe varen nga konsideratat politike si: besueshmëria dhe roli që luan qeveria në ekonomi por edhe nga reagimet publike lidhur me drejtimin dhe veprimet e qeverisë. Vendimet e tilla mund të ndikohen edhe nga faktorët e jashtëm që do të thotë se qeveria duhet të merr parasysh trendët global ekonomik dhe politikat fiskale të vendeve tjera, të cilat mund të kenë efekt në ri-alokim të kompanive vendore përmes përparësive fiskale. Zhvillimi ekonomik i një shteti nuk mund të imagjinohet dhe të bëhet realitet pa një politikë fiskale dhe sistem të mirëfilltë tatimor (Asllani, 2016) . Në fillimin e krizës financiare të vitit 2007, qeveritë anembanë botës reagueshan duke nisur një sërë paketash stimuluese fiskale që përfshijnë një sërë instrumentesh fiskale (Andrés, J. , Boscá, J.E. and Ferri, J., 2015). Sot shumë nga këto qeveri po përpiqen të ndërrojnë procesin e akumulimit masiv të borxhit që ka ndodhur gjatë viteve të fundit, duke zvogëluar shpenzimet, ose duke u rritur taksat. Është e rëndësishme të themi se efektet

e politikës fiskale ndryshojnë nga vendi në vend varësisht nga sistemi ekonomik. Pra efektet e politikave fiskale në një ekonomi të mbyllur ndryshojnë nga ekonomitë e hapura (Manciw, 2003). P.sh. në vendet me ekonomi të mbyllur politikat fiskale sjellin të ardhura më të mëdha se sa një vend me ekonomi të mbyllur.

3.2.2. Instrumentet dhe efektet e politikës fiskale

Përmes politikës fiskale, shteti mund të ndikojë drejtpërdrejtë në ekonomi. Kur ai vendos për taksat që i grumbullon, transferon të mirat dhe shërbimet që i blen, financimin deficitar, në fakt angazhohen në politikën fiskale. Për realizimin e qëllimeve të politikës fiskale duhen mjete financiare të nevojshme të cilët sigurohen përmes instrumenteve të sistemit fiskal (Kadriu, 2012). Çfarëdo ndryshimi në nivelin e këtyre instrumenteve ka efekt të drejtpërdrejtë në rrjedhat e përgjithshme ekonomike. Përmes instrumenteve të politikës fiskale ndikohet në punësim dhe nivel të çmimeve, në rishpërndarjen më të mirë të të ardhurës dhe pasurisë, në shtimin ekonomik, në rritjen e kursimit, në nivelin e investimeve, në çështjet e edukimit, të arsimit, në kulturë dhe shëndetësi. Ndërhyrja e shtetit për të korrigjuar pabarazinë e padrejtë të të ardhurave nëpërmjet futjes së sistemit tatimor, midis programeve të tjera, i cili është projektuar për të marrë më shumë nga të pasurit dhe më pak nga të varfrit (Oluwayiwa, O., Medunoye, P. and Oluwatosin, O., 2012). Zhvillimi ekonomik i një shteti nuk mund të imagjinohet dhe të bëhet realitet pa një politikë fiskale dhe sistem tatimor të mirëfilltë. Sistemi tatimor paraqet element të rëndësishëm të sistemit makroekonomik i cili duhet të siguroj një baze elementare fiskale që ka për qëllim të mbledhë të ardhura me të cilat mbulohen shpenzimet publike dhe shpenzimet tjera të parapara me ligj (Asllani, 2016).

3.2.3. Sistemi Fiskal

Sistemi fiskal është i lidhur ngushtë me ekzistimin e shtetit dhe funksionimin e tij. Në periudha të ndryshme kohore roli i shtetit është rritur , krahas kësaj edhe rëndësia e sistemit fiskal është rritur. Gjatë përcaktimit të sistemit fiskal, duhet pasur parasysh karakterin dhe qëllimet e zhvillimit afatshkurtër apo afatgjatë të shtetit. Roli i politikës fiskale në rritjen ekonomike, ka nxitur shumë studime, si në aspektin teorik dhe në atë empirik. (Shijaku, G. dhe Gjokuta, A., 2013). Literatura bashkëkohore makroekonomike vë në dukje si objektivat afatshkurtër, ashtu dhe ato afatgjatë të politikave fiskale (Romer, 2006). Shteti, që të mund të funksionojë dhe të plotësojë nevojat e përgjithshme dhe të përbashkëta të qytetarëve të tij i nevojiten mjete materiale. Të gjitha këto nevoja kanë karakter publik, prandaj çdo shtet insiston që në një nivel sa më të lartë t'i plotësoj ato. Për këtë arsye, shteti nëpërmjet masave dhe instrumenteve të sistemit fiskal siguron mjete të caktuara materiale, të cilat i shërbejnë t'i plotësojnë këto nevoja me karakter publik siç janë: arsimi, shkenca, kultura, shëndetësia, mbrojtja, rrugët etj. (Limani, 2002). Për realizimin e qëllimeve të politikës fiskale nevojiten mjete të nevojshme të cilat realizohen përmes instrumenteve të sistemit fiskal. Në të hyrat publike hyjnë instrumentet e sistemit fiskal siç janë : tatimet, doganat dhe taksat doganore, taksat, kontributet dhe transfero, etj.

3.2.4. Sistemi ekonomiko- fiskal në Kosovë

Për të arritur mirëqenie dhe stabilitet politik, qeveritë kombëtare synojnë arritjen e ekuilibrit ekonomik. Qeveria përdor instrumente të ndryshme për të stimuluar rritjen e ekonomisë, për të ulur papunësinë dhe për të arritur objektivat makroekonomike (Sylqa, D. dhe Kastrati, F., 2016). Në kontekst të rritjes së ngadalshme ekonomike të viteve të

fundit dhe të presioneve fiskale, Kosova ballafaqohet me sfidën komplekse të zhvillimit ekonomik. Zhvillimi i sistemit dhe politikës fiskale në Kosovë është i ndarë në dy periudha kohore të ndara, periudhën e ish-Jugosllavisë si njësi federale dhe periudha pas luftës çlirimtare të vitit 1999. Në vazhdim do të trajtohen dy periudhat e zhvillimit të sistemit dhe politikës fiskale në Kosovë.

3.2.4.1. Sistemi fiskal i KSA të Kosovës

Me Kushtetutën e vitit 1974, Kuvendi i Kosovës me ligjet e veta e përcaktonte në mënyrë të pavarur politikën tatimore, fiskale dhe buxhetore. Kompetenca të konsiderueshme në sigurimin e të hyrave vetanake kishin edhe komunat, si bashkësi shoqërore politike. Me ligjet e Kosovës rregullohej sigurimi i të hyrave fiskale sipas bazës së tatimeve, kurse me vendimin e kuvendeve komunale siguroheshin të hyrat fiskale për plotësimin e nevojave buxhetore të komunave sipas bazës së tatimeve komunale, taksave dhe vetë kontributit të qytetarëve.

Sistemi fiskal i Kosovës, përkundër pavarësisë së tij institucionale të pakontestueshme, sipas hierarkisë politike dhe kushtetuese, i nënshtrohej kornizave të përcaktuara me Kushtetutën e Jugosllavisë dhe ligjeve sistemore federative. Prandaj, bazat e sistemit tatimor fiskal të Kosovës, sikurse edhe në vendet tjera socialiste, ishin të ndërtuara sipas konceptit socialist të ekonomisë së planifikuar, pronësisë shoqërore mbi pronën dhe mjetet e prodhimit.

3.2.4.2. Politika dhe sistemi fiskal në Kosovë

E ka zanafillën e vet të mirëfilltë menjëherë pas përfundimit të luftës në vitin 1999.

Sistemi fiskal në Kosovë ndonëse i ri dhe ende i paqëndrueshëm ballafaqohet me ide e sfida nga më të ndryshme (Abdixhiku, 2009). Menjëherë pas çlirimit të Kosovës u instalua misioni i Kombeve të Bashkuara i ashtuquajtur si UNMIK. Ky mision kishte përgjegjësi për qeverisjen e vendit. Kosova pas lufte doli e shkatërruar ekonomikisht. Në këtë periudhë nuk kishte sistem fiskal, dhe ai që duhej të ndërmernte masa për themelimin e tij ishte UNMIK-u, kështu që më 25 qershor të vitit 1999, kryeadministratori i parë i Kosovës ka aprovuar Rregulloren nr. 1999/1. Kjo rregullore është akti më i lartë legjislativ në Kosovën e pas luftës me të cilën rregullohen çështjet e pasurive shtetërore, financave, bankave etj. Me anë të kësaj rregullore janë përcaktuar edhe kompetencat e përfaqësuesit special të Sekretarit të Kombeve të Bashkuara në këto fusha . (UNMIK, 1999). Dokumenti i dytë me rëndësi për sistemin fiskal në Kosovë është nxjerrja nga PSSP-ja, rregullorja nr. 1999/16 mbi themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal (AQF). Ky institucion i themeluar nga PSSP-ja, ishte përgjegjësi për financim publik në Kosovë. Përmes kësaj rregulloreje, PSSP-ja emëron drejtorin e AQF-së i cili është përgjegjës të zbatoj funksionet e parapara me këtë rregullore dhe të punësoj njerëz në këtë institucion me të cilën do të jenë përgjegjës për buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Ndër rregulloret e para të nxjerra nga Përfaqësuesi Special i OKB-së për Kosovën është edhe ajo mbi themelimin e doganave dhe shërbimeve tjera gjegjëse në Kosovë. Me aprovimin e Rregullores mbi akcizën dhe Rregulloren mbi taksen e shitjes fillon të funksionojë shërbimi doganor dhe pagesa e taksës dhe të akcizës në importimin e mallrave si një ndër segmentet më të rëndësishme të a) ndërtimit të sistemit fiskal të Kosovës dhe të b) institucionalizimit dhe konsolidimit të buxhetit të Kosovës.

Sistemi tatimor paraqet element të rëndësishëm të sistemit makroekonomik i cili duhet të siguroj një bazë elementare fiskale që ka për qëllim të mbledh të ardhura me të cilët

mbulohen shpenzimet publike. Kosova pas përfundimit të luftës filloi të ndërtoj politika tatimore të orientuara në ekonominë e tregut, të cilat politika përfshijnë ndërtimin dhe implementimin e koncepteve moderne të taksimit (Asllani, 2016). Në këtë periudhë, ngarkesa e më të mëdha tatimore dhe doganore kishin bizneset (mbi 96% e të hyrave buxhetore) ku gradualisht kjo barrë për bizneset u zvogëlua duke rritur bazën tatimore në përgjithësi (RIINVEST, 2002) . Pas kësaj kanë pasuar edhe një numër rregulloresh që janë aprovuar nga PSSP-ja siç është rregullorja nr. 1999/7 e datës 6 nëntor 1999 dhe nr. 2000/2 e datës 18 shkurt 2000, të cilat kanë rregulluar kompetencat dhe përgjegjësit AQF-së dhe institucioneve të përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës në lëmin financave publike dhe instrumentet e politikës fiskale.

Politika fiskale njihet si proces i formulimit të tatimeve dhe të shpenzimeve publike në funksion të gjenerimit të cikleve rritëse ekonomike dhe të disperzionit ekonomik të cilësuar me shkallë të lartë punësimi dhe të mbrojtur nga ciklet inflatore . Në përgjithësi qëllimet e politikës fiskale gjatë ndërtimit gradual të saj tek ne do të përqendroheshin në përcaktimin e nivelit të doganave dhe taksave, respektivisht të shpenzimeve publike, për të siguruar ngritje të shpejtë ekonomike me punësim të lartë dhe çmime stabile (RIINVEST, 2001).

Definimi dhe formulimi i një politike konzistente afatgjate fiskale në Kosovë është i përkufizuar me shumë pengesa, nga të cilat më karakteristike janë (RIINVEST, 2001):

- Statusi specifik politik i Kosovës në këtë fazë;
- Gjendja e rëndë ekonomike e pasluftës;
- Mungesa e sistemit statistikor, institucioneve statistikore dhe e indikatorëve makroekonomik për formulimin e politikës fiskale;
- Mos konsolidimi i administratës lokale tatimore.

Politika fiskale e një vendi luan rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike të tij. Kjo politikë, me komponentët kryesore të saj, determinon stabilitetin makroekonomik. Aktivitetet të cilat në Kosovë janë ndërmarrë në vitet e fundit në ndërtimin e politikës fiskale kanë dhënë efekte të rëndësishme në kuptimin e ngushtë fiskal, sepse janë arritur nivele mjaft të larta të hyrave vetanake buxhetore, ndërsa këto politika, si një parakusht për sistem stabil, nuk kanë treguar efekte sa u përket performancës së rritjes ekonomike, që në këtë moment po bëhet çështje qenësore (RIINVEST, 2003).

Në Kosovë aplikimi i instrumenteve të sistemit fiskal dhe politikës fiskale pas vendosjes së protektoratit ndërkombëtar është varur nga misioni i OKB-së dhe për të gjitha vendos ky mision, ndërsa nuk merr përgjegjësi për dështimet. Ndonëse arritjet janë të pëlqyeshme për kohën që ky sistem ka marrë që të ngrihet, dobësitë dhe lëshimet prej më të ndryshmeve vazhdojnë të ndodhin (Abdixhiku, 2009).

3.2.4.3. Sistemi tatimor dhe normat tatimore në Kosovë

Sistemi tatimor në Kosovë përbën një pako ligjesh tatimore dhe udhëzimesh administrative (MF, 2017). Në bazë të instrumenteve fiskale të përcaktuara më lartë Ministria e Financave kanë vendosur aplikimin e këtyre lloje të tatimeve: (ATK, 2011)

- a) Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
- b) Tatimi në të Ardhurat e Korporatave
- c) Tatimi në të Ardhurat Personale
- d) Detyrimin Doganar
- e) Akcizën
- f) Tatimi në Interes, Devidentë, Qira, Lojëra të Fatit
- g) Tatimi në pronë.

Këto lloje të tatimeve janë ndryshuar në funksion të thjeshtësimit dhe ofrimit të lehtësirave tatimore, duke zvogëluar dhe përshtatur normat tatimore me nivelin e vendeve të rajonit. Është bërë harmonizimi i dispozitave ligjore, në mes llojeve të tatimeve në të Ardhura Personale dhe të Korporatave, si dhe harmonizimi i Ligjit të TVSh -së, me Direktivën e Bashkësisë Evropiane për TVSh. Janë hartuar dhe aprovuar akte nënligjore për zbatueshmërinë e ligjeve tatimore: (ATK, 2011).

(a) Tatimi në të ardhura personale, i cili ka hyrë në fuqi më 1 prill të vitit 2002, dhe në fillim janë tatuar vetëm pagat. Që nga 1 janari i vitit 2005, është tatim më gjithëpërfshirës dhe tatimon edhe burime tjera të ardhurave me sa vijon: pagat, të ardhurat nga aktivitetet biznesore, të ardhurat nga qiraja, lojërat e fatit, dividendët, interesin, fitimet kapitale, dhe çdo të ardhur tjetër që rritë pasurinë neto të tatimpaguesit. Që nga viti 2009, normat e tatimit në të ardhura personale nuk ka ndryshuar. Norma është e shkallëzuar në bazë të nivelit të të ardhurave (tabela 3.1). Në vitin 2016 në buxhetin e Kosovës janë mbledhur 123.982 milion euro ose e shprehur në përqindje 7,74% e të ardhurave gjithsej (MF, 2017). Pjesmarrja e të ardhurave nga TAP-it në PBB-në e vendit për vitin 2016 është rreth 2.11% (MF, 2017)

Tabela 3.1 Normat e tatimit në të Ardhura personale në Kosovë

Tatimi në të ardhura Personale dhe normat tatimore në %			
Niveli i të ardhurave në €		Norma tatimore në %	
Mujore	Vjetore	Deri më 2008	Nga 2009 e tutje
Deri në 80€	Deri 960€	0%	0%
80 - 250€	960 - 3000€	5%	4%
250 – 450€	3000 – 5400€	10%	8%
Mbi 450€	Mbi 5400	20%	10%

(b) Që nga 1 Janari 2005, në Kosovë ka filluar të zbatohet Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave, sipas Rregullores Nr. 2004/51. Tatimi në të Ardhurat e Korporatave zëvendëson Tatimin në Fitim, sipas Rregullores Nr.2002/3, i cili tatimin në fitim kishte filluar të aplikohet në Kosovë që nga 01.04.2002. Në tatimin në fitim ishin të regjistruar personat juridik por edhe biznese individuale. Me hyrjen në fuq të Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatave, kusht për tu regjistruar është vendosja e statusit juridik. Siç tregon edhe emri i tatimit, Tatimi në të Ardhura të Korporatave është tatim që zbatohet në të ardhurat reale të korporatave. Sipas sistemit të ri të Tatimit në të Ardhura të Korporatave, të gjitha korporatat e vogla që zgjedhin t'i nënshtrohen tatimit në fitim real, mund të bartin më tej humbjet ndryshe nga tatimi i paragjykuar i cili aplikohet vetëm në shitjet bruto të korporatave. Gjithashtu nga viti 2009 norma e të ardhurave nga Tatimi në Korporata është e pa ndryshuar 10% (tabela 3.2). Në vitin 2016 janë mbledhur nga Tatimi në të Ardhurat e Korporatave (TAK) 80.817 milion euro ose 5.05% e të ardhurave gjithsej (MF, 2017). Pjesmarrja e të ardhurave nga TAK në PBB-në e vendit për vitin 2016 është rreth 1.38% (MF, 2017).

Tabela 3.2. Norma e Tatimit në të ardhurat e Korporatave

Tatimi në të ardhura të korporatave dhe normat tatimore në %	
Deri në 2008	Nga 2009 e tutje
20%	10%

(c) Në Kosovë, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, ka filluar të inkasohet prej 1 Korriku të vitit 2001, përmes Rregullores 2001/11 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, dhe Plotësim ndryshim i rregullores nr. 2002/17 prej 1 Gusht të vitit 2002. Të ardhurat e mbledhura

nga Tatimi i Vlerës së Shtuara përbënë të ardhurën kryesore të qeverisë së Kosovës. Në vitin 2014, Qeveria e Kosovës ka marrë disa vendime të cilat kanë pasur ndikim në rritjen e shpenzimeve buxhetore, përkundër asaj që ato nuk ishin planifikuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (MF, 2013). Duke u përballur me këtë Fondi Monetar Ndërkombëtar ka rekomanduar Qeverinë e Kosovës të ndërmarrë disa ndryshime në rritjen e tatimeve dhe sidomos TVSH-së i cili do të ndikoj në balancimin e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore. Duke u ndodhur para kësaj sfide, Qeveria e Kosovës në vitin 2015 ndërmori një reformë duke ndryshuar ligjet e paketës fiskale duke përfshirë edhe ligjin për TVSH-në. Me anë të këtij ligji ulet pragu i regjistrimit të biznesit në TVSH nga 50 mijë euro sa ishte me ligjin e vjetër në 30 mijë euro si dhe rritet norma e TVSH-së nga 16% sa ishte më parë në 18%. Gjithashtu me ligjin e ri kemi edhe disa risi tjera siç janë, përshkallëzimi i normës së TVSH-së për disa produkte dhe lirime që ndikojnë në rritjen e prodhimit dhe inovacione teknologjike. Qeveria e Kosovës në vitin 2016 ka mbledhur TVSH nga Administrata e Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës 693.754 milion euro, ose 43.30% e mjeteve të mbledhura në këtë vit. (MF, 2017). Pjesmarrja e të ardhurave të grumbulluara nga TVSH-ja në këtë vit në raport me PBB-në është mjaft e lartë me 11.21%. (shtojca tabela A7).

Tabela 3.3 Norma e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në Kosovë

Tatimi në Vlerën e Shtuar dhe normat tatimore në %			
Deri në vitin 2008	Nga 2009 deri 2015	Nga 2015 e tutje	
15%	16%	18%- e rregullt	8% - e reduktuar

Burimi: Ministria e Financave

(d) Ligji mbi tatimin e akcizës, i plotësuar-ndryshuar më 2008 dhe 2009, përmban një listë të mallrave që i nënshtrohen tatimit të akcizës. Mallrat që i nënshtrohen akcizës

përfshijnë: kafënë, verën, cigaret dhe produktet e tjera të duhanit, vajrat, lëngjet e frutave dhe koncentratet e tjera të pijeve, veturat dhe automjetet e tjera motorike. Këto janë të përcaktuara shumat fikse për secilin mall. Gjatë vitit 2011, me vendim të qeverisë së Kosovës nr. 03/13 ka filluar të mblidhet tatimi në akcizë edhe për lojërat e fatit. Akciza është tatimi kryesor që mblidhet nga qeveria e Kosovës pas TVSH-së. Pjesëmarrja e akcizës në të hyrat tatimore në vitin 2012 është relativisht mjaft e lartë, me 31,27% dhe pjesëmarrja në të hyrat e përgjithshme të BRK-së është 19,54%.

(e) Aktualisht në Kosovë, për importimin e mallrave aplikohen tri tarifa doganore në shkallën 10%, 1% dhe 0%. Kodi doganor dhe i akcizës së Kosovës nr. 03/L-109, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në nëntor 2008, rregullon elementet themelore të sistemit të mbrojtjes doganore të ekonomisë së Kosovës, si dhe të drejtat dhe detyrimet e të gjithë operatorëve sa i përket zbatimit të legjislacionit doganor. Roli i taksës doganore vazhdimisht ka tendencë të rënies si rezultat i anëtarësimit të Republikës së Kosovës në institucione dhe mekanizma ndërkombëtare, siç janë CEFTA, në MSA dhe marrëveshja e tregtisë së lirë. Të ardhurat nga dogana nga viti 2004 përafërsisht kanë ngelur në nivel të njëjtë me një luhatje të vogël. Në vitin 2016 qeveria e Kosovës përmes doganave ka realizuar 129.970 milion euro ose rreth 8.11% e të ardhurave gjithsej (MF, 2017). Pjesëmarrja e detyrimit doganor në raport me PBB-në e vendit për vitin 2016 është 2.22% (shtojca tabela A7).

(f) Të gjithë personat fizik dhe juridik në Kosovë që realizojnë të ardhura në Interes, Devidenta, Qira dhe Lojëra të Fatit duhet të paguajnë tatim sipas ligjit mbi të ardhurat personale dhe ligjit mbi të ardhurat e korporatave. Niveli i të ardhurave nga Interes, Devidenta, Qira dhe Lojëra të Fatit është relativisht i ulët.

(g) Që nga viti 2004 në Kosovë ka filluar të aplikohet tatimi në pronë nga autoritet lokale, përkatësisht nga komunat. Mbledhja e këtij tatimi është e rregulluar me ligj të veçantë dhe ka normë të ndryshme, varësisht nga komunat. Norma e tatimit aplikohet mbi vlerën e tregut të pronës së paluajtshme. Komunat e Kosovës në vitin 2016 kanë realizuar të ardhura nga TP 25.128 milion euro dhe pjesëmarrja e kësaj të ardhura në të ardhurat gjithsej dhe në PBB-në e vendit është i ulët (MF, 2017).

3.3. Të ardhurat publike

3.3.1. Përkufizimi i të ardhurave publike

Shteti bashkëkohor nuk mund të ushtrojë veprimtari publike pa sistemin dhe politikën e formimit të të ardhurave publike me qëllim të financimit të shpenzimeve të përgjithshme dhe të përbashkëta. Mjetet financiare, të cilat i kryejnë funksionet e shtetit, në shkencën ekonomike dhe të financave, në përgjithësi quhen të ardhura publike. Ndërsa sipas autorit (Kadriu, 2012), të ardhurat publike quajmë mjetet me të cilat shteti ose bashkësitë shoqërore-politike apo pushtetit qendror dhe lokal plotësojnë nevojat publike të bazuara në ligj.

Zanafillën e të ardhurave publike e gjejmë në fazat e hershme të zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore ekonomike. Në bashkësinë primitive jeta e përbashkët ka kërkuar plotësimin e disa nevojave të përbashkëta dhe për këtë qëllim është dashur të sigurohen të ardhura me karakter publike (Kadriu, 2012). Sipas Daltonit, megjithatë termi “të ardhura publike” ka dy kuptime – kuptim të gjerë dhe të ngushtë të fjalës. Në kuptimin e gjerë të të ardhurat publike kuptojmë të gjitha të ardhurat që mund të sigurojnë ato qeveritare gjatë gjithë periudhës. Ndërsa në kuptimin e ngushtë, megjithatë janë të përfshira vetëm burimet e të ardhurave publike me të cilat autoritetet i njohim si “burime të të ardhurave”. Për të shmangur paqartësinë, kështu është formuar termi të “ardhura e

faturuara” dhe më vonë “ të ardhura publike” (Chand, 2008). (OTUBALA, 2014)ka sqaruar se të ardhurat publike kanë kuptim të ngushtë dhe të gjerë ashtu siç ka shkruar edhe Dalton. Në një shtet modern të mirëqenies, sipas Chand-it, të të ardhurat publike ndahen në dy lloje, të ardhurat tatimore dhe të ardhurat jo tatimore. Të gjitha mjetet e mbledhura nga tatimet i referohen termit të ardhura tatimore. Tatimet janë kontribute të imponuara nga qeveria për qytetaret për të mbuluar shpenzimet e përgjithshme, të bëra për të mirën e përbashkët, pa pasur ndonjë përfitim të drejtpërdrejt nga tatimpaguesi. Ndërsa të të ardhurat jo tatimore janë të të gjitha të ardhurat e pranuar nga qeveria përmes burimeve jo tatimore, siç janë të ardhurat administrative, ndërmarrjet afariste, dhuratat dhe grandet.

Me zhvillimin e shtetit janë rritur edhe funksionet dhe detyrat e tij, andaj janë rritur edhe nevojat për sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve publike si rezultat i aktiviteteve për ushtrimin e funksioneve të shtetit. Sistemi i të ardhurave shtetërore ndryshon nëpër periudhe të ndryshme të zhvillimit të shtetit. Gjithashtu sistemi i të ardhurave publike ndryshon edhe në mes të shteteve të ndryshme, varësisht nga rregullimi i brendshëm. Kështu që sot në botë mund të hasim në sisteme të ndryshme të të ardhurave publike dhe lirisht mund të konstatojmë se vështirë mund të gjinden dy shtete që kanë sistem të njëjtë të ardhurave publike (Komani 2008). Mjetet me të cilat shteti i përcakton nevojat e veta (shtetërore, shoqërore) në kompetencën e vet quhen të ardhura publike apo shtetërore (Jelçiç, 1985). Pra sipas autori Jelçiç të ardhurat publike janë mjete me të cilat shteti mbulon shpenzimet për realizimin e kompetencave të veta dhe është baza kryesore me të cilin shteti i mbledh këto të ardhura. Sipas autorit (Kryeziu, 2012) shteti ka detyra të shumta, si dhe kompetenca dhe obligime në përditshmëri, detyra e obligime këto të bazuara në kushtetutë, sistemin e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve të

ndryshme administrative e dispozita të tjera në përputhje me sistemin juridik e politik të përcaktuar dhe rregulluar. Për të kryer këto detyra dhe obligime për shtetasit e vet, shteti ka nevojë për mjete financiare, ku në shkencën e financës publike këto mjete quhen të ardhura publike. Mbledhja e të ardhurave publike është pjesë integrale e politikës fiskale dhe e administrimit fiskal. Kjo është çështje e çdo qeverie, është instrument kryesor përmes të cilit është siguruar financimi i qeverisë (Gideon, Z. and Alouis, M., 2013). Mbledhja e të ardhurave tatimore duhet të jetë në përputhje me praktikat më të mira të kapitalit, aftësisë për të paguar , efikasitet ekonomike , komoditet dhe siguri (Musgrave, R. A. , Muagrave, P. B. , 1984), (Bailey, 1995) (Erasmus, P. W. and Visser, C. B. , 2005). Me fjalë tjera, të ardhurat publike paraqesin të gjitha të ardhurat, apo mjetet financiare që derdhen në buxhetin e një shteti. Nga të ardhurat publike varet shumë ecuria e ekonomisë dhe zhvillimi i vendit. Ato janë një përmbledhje e tatimeve të ndryshme, taksave, kontributeve, dhe e çdo të ardhur tjetër financiare. Të ardhurat publike janë faktori kryesor i llogaritjes së Bruto Prodhimit Vendor (BPV), dhe sa më shumë të rriten të hyrat publike aq më shumë rritet BPV -ja. (Infocredit, 2017)

3.3.2. Burimet e të ardhurave publike

Qeveria për të kryer funksionet e tyre shtetërore në fushën e aktiviteteve politike, sociale dhe ekonomike, për të rritur mirëqenien sociale dhe ekonomike, kërkojnë burime të mjeteve. Këto burime të të ardhurave ndryshe edhe quhen të ardhura publike. Përcaktimi i burimeve të të ardhurave publike është një ndër problemet më të mëdha që ballafaqohen ekonomistët dhe hulumtuesit e financave publike. Klasifikimi i burimit të financimit është problem edhe në vet shkencën ekonomike e cila kërkon kujdes të veçantë rreth përcaktimit dhe definimit të tyre. Sipas autorit (Kryeziu, 2012) problem kryesor në përcaktimi e llojeve të të ardhurave dhe burimit të tyre, është se paraqiten ngjashmëri në

mes të funksioneve që kanë, sidomos roli, ndikimi dhe mënyra e formimit të tyre në njërën anë, por edhe mendësitë e dhe kushtet të cilat krijohen dhe formohen ato në anën tjetër. Shtetet moderne duhet të kryejnë detyra të shumëllojshme për promovimin e mirëqenies së qytetarëve të tyre. Për kryerjen e këtyre funksioneve nevojiten para. Prandaj, çdo qeveri përpiqet të përmbushë shpenzimet e saj vjetore nga tatimet dhe nga burime të tjera përveç jo tatimore (EconomicConcepts, 2017). Sipas (Dalton, 1949), megjithatë, termi "Të ardhurat publike" ka dy kuptime - të gjerë dhe të ngushtë. Në kuptimin e tij më të gjerë që përfshin të gjitha të ardhurat apo faturat të cilat një autoritet publik mund të sigurojë gjatë çdo periudhe kohore. Në kuptimin e tij të ngushtë, megjithatë, ajo përfshin vetëm ato burimet e të ardhurave të autoritetit publik të cilat janë të njohur zakonisht si "burime të të ardhurave." Të ardhurat publike sipas autorit (Nathan, 1944) rrjedhin nga këto burime: të ardhurat tatimore, të ardhurat administrative, të ardhurat nga pasuria publike dhe rritja e borxhit publik (borxhi që administrohet nga autoritete qeveritare).

Duke u bazuar nga mendimet e ndryshme të mendimtarëve më eminent që ka shkenca ekonomike dhe posaçërisht financat publike dhe duke ia përshtatur këtij hulumtimi, të ardhurat publike i kemi klasifikuar të ardhurat sipas këtyre burimeve: të ardhura nga tatimet, të ardhurat jo tatimore (të ardhurat administrative si gjobat, tarifat, dhuratat) dhe të ardhurat nga grandet, etj.

Në përgjithësi, qeveria tatimet i mbledh nga tatimet e vendosura ndaj publikut. Tatimet nuk janë gjithmonë burimet e vetme të qeverisë për mbulimin e shpenzimeve publike. Ka edhe burime tjera të të ardhurave siç janë tarifat, çmimet, vlerësimet e veçanta, gjobat dhe dënimet, dhuratat nga ndërmarrjet shtetërore dhe huat, etj. Nuk është e drejtë që të gjitha

burimet e të ardhurave të emërtohen me një emër siç është tatimi, sepse të gjitha këto burime kanë ndryshim themelor nga lloji ose nga njëri tjetri.

3.3.3. Klasifikimi i përgjithshëm i të ardhurave publike

Me klasifikimin e të ardhurave publike janë marrë shumë studiues në financat publike.

Në shumicën e rasteve ata janë ndikuar nga lidhja që kanë me funksionet e shtetit. Të ardhurat publike janë të përbërë nga elementë heterogjenë. Prandaj, elementet janë klasifikuar në bazë të karakteristikave të ndryshme në vartësi të llojit të të ardhurave.

Me problematikën e të ardhurave publike dhe llojin e tyre janë marrë shumë ekonomistë dhe teoricienë të financave publike. Nga klasifikimet e ndryshme të të ardhurave publike të disponueshme në literaturën ekonomike, ne do të shqyrtojmë disa të rëndësishme. Ndër hulumtuesit që janë marrë me klasifikimin e të ardhurave, janë ekonomistë të mirënjohur: (Smith, 1776), (Seligman, 1895), (Dalton, 1949), dhe (Taylor, 1959), (Jelçiç, 1985).

(Chand, 2008) në librin e tij shkruan se: “Sipas Smithit të ardhurat nga qeveria në fund të fundit varen nga prona në posedim të banorëve të vendit dhe shkallën në të cilën shteti ka kontroll mbi pasurinë e vendit”. (Smith, 1776) të ardhurat publike i klasifikon në dy kategori: a) Të ardhurat nga publiku, dhe b) Të ardhurat nga prona shtetërore.

(Dalton, 1949) ofron një klasifikim shumë të plotë dhe sistematik të të ardhurave publike. Ai mendon se ka dy burime kryesore të të ardhurave publike. Ato janë tatimet dhe çmimet. Tatimet janë kontribut i detyrueshëm kurse çmimet janë pagesat vullnetare nga individë të cilët hyjnë në kontratë me autoritetin publik.

(Seligman, 1895) është i mendimit se çdo të ardhurat qeveritare vijnë nga klasat e mëposhtme: (1) panevojshëm, (2) kontraktuese, dhe (3) i detyrueshëm.

Format e para të të ardhurave e kanë humbur rëndësinë në botën moderne. Në praktikë, nuk mund të gjeni person dashamirës që do të dorëzonte një shumë të konsiderueshme të të ardhurave të tij si dhuratë për shtetin.

Në lidhje me llojin e kontraktuar të të ardhurave publike është një rast kur një qeveri bie dakord për të bërë ndonjë gjë të veçantë në këmbim të një pagese. Për shembull dhënien me qira të tokës për kthimin e qirasë. Sipas kategorisë detyrim, burimi më i rëndësishëm i të ardhurave të vendosura nga (Seligman, 1895) janë tarifatat, vlerësimi i veçantë dhe tatimet.

Klasifikimi më racional dhe me bazë shkencore e të ardhurave publike është dhënë nga (Taylor, 1959). Ai ndan të ardhurat publike në katër kategori. Ata janë: (1) Tatimet, (2) Të ardhurat Administrative, (3) Të ardhurat komerciale, dhe (4) Grandet dhe dhurata.

Pothuajse të gjithë shkrimtarët modern vendosin analizat e tyre të të ardhurave bazuar në klasifikimin e Taylorit. Nga klasifikimi më sipër, ne mund të kuptojmë se burimet tatimore përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave publike në çdo shoqëri moderne.

(Jelçiç, 1985) në librin e tij ka thënë se duke u nisur nga hulumtimet e bëra deri më tani mbi përcaktimin e llojeve të ndryshme të të ardhurave publike në ekonominë kombëtare kemi lloje të ndryshme, por në përgjithësi dallohen:

1. Të ardhurat origjinare dhe derivate;
2. Të ardhurat juridiko-publike dhe juridiko-private;
3. Të ardhurat e rregullta dhe jo të rregullta;
4. Të ardhurat nga popullsia dhe të ardhurat nga personat juridik;
5. Të ardhurat e kthyeshme dhe të pakthyeshme;
6. Të ardhurat nga njësit territoriale më të gjera dhe më të ngushta;
7. Të ardhurat e destinuara dhe jo të destinuara dhe

8. Të ardhurat në para dhe të ardhurat në natyrë.

3.3.4. Efiçenca dhe administrimi i mbledhjes së të ardhurave publike

Mbledhja dhe menaxhimi i të ardhurave janë funksione të rëndësishme të qeverisë dhe janë me interes të madh për publikun. Një kuadër efikas dhe efektiv i kontrollit të menaxhimit për të ardhurat e qeverisë është thelbësor për të siguruar llojin e kujdestarisë dhe llogaridhënies që pritet nga njerëzit. Efiçenca ka të bëjë me nxjerrjen e një dobie ose kënaqësie maksimale të mundshme nga përdorimi i burimeve ekonomike. Abedian dhe Biggs (1998) përcaktojnë efiçencën si përdorim optimal i burimeve në çdo kohë. Është një masë për qeverinë që të shqyrtojë se sa mirë po e kryen detyrat që duhet të bënin brenda një afati kohor të caktuar, pa marrë parasysh a janë bërë gjerat e duhura (Kiaze, 2014). Termi efiçencë në këtë hulumtim është përdorë si një masë e rëndësishme për të përcaktuar se deri në çfarë mase qeveria ka arritur të mbledh të ardhurat. Pra efiçenca nënkupton rezultatin se sa është arritur objektivi në mbledhjen së të ardhurave. Nga ana tjetër kuptohet se tatimet sjellin kosto për tatimpaguesit. Janë bërë shumë përpjekje për ta parë këtë kosto thjesht si shumë parash, që një person ia dorëzon administratës tatimore (Rosen, 2010). Shpesh ndodh që të grumbullohen të ardhura më shumë se në të kaluarën dhe kjo vjen si rezultat i rritjes së taksave nga ana qeverisë dhe kjo nuk mund të jetë si rezultat i rritjes së efektshmërisë së qeverisë sepse kostoja rritet për tatimpaguesit. Çdo rritje që ndodh si rezultat i rritje së aktivitetit të institucioneve që mbledhin tatime, pa rritur kostot atë mund të konkludoj se kemi një rritje të efiçencës në mbledhjen e të ardhurave. Mbledhja e taksave ka qenë një aktivitet i përbuzur prej kohësh (AWITTA, 2010). Por taksat janë thelbësore sepse pa to nuk do të kishte para për të ndërtuar infrastrukturë publike që i ndihmon bizneset dhe shoqëria të jenë më produktive dhe më

të mira. Megjithatë, hulumtimi në lidhje me tatimet optimale vazhdon të zhvillohet dhe shpesh në drejtimin e duhur duke përfshirë variabla shtesë nga konteksti më i gjerë. Gradstein (1999) shqyrtoi mekanizmat politikë që sigurojnë kufizime për rritjen e efikasitetit në tatim. Në kuptimin e përgjithshëm, efienca mund të arrihet në kushtet e maksimizimit të rezultatit të një veprimi në lidhje me burimet e përdorura dhe llogaritët duke krahasuar efektet e fituara në përpjekjet e tyre (Cindea, D. , Opreana, A. and Cristescu. M, 2010).

3.4. Të ardhurave publike në Kosovë

Në sajë të instrumenteve të politikës fiskale, Kosova krijon të ardhura publike, përkatësisht mjete buxhetore nga burimet vetanake. Falë zhvillimit ekonomik, mjetet buxhetore janë rritur për çdo vit buxhetor, që është shpreh në efikasitetin e qeverisë në kryerjen e obligimeve të përgjithshme dhe të përbashkëta ndaj qytetarëve dhe avancimin në investime kapitale (Badivuku- Pantina, M dhe Maloku, E., 2012). Sipas autorit (Kryeziu, 2012), qeveritë e Kosovës që nga paslufta, përveç në segmentet e tjera shtetërore e shoqërore, edhe në zhvillimin e politikës fiskale kanë bërë reforma rrënjësore, të cilat kanë ndikuar në formimin e të ardhurave, janë angazhuar në ndërtimin e sistemit tatimor e të instrumenteve të tjera të cilat janë në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë makro-fiskale të vendit. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2009, qeveria e Kosovës ka implementuar reformën tatimore, e cila është fokusuar në uljen e normave tatimore që ka rezultuar në ruajtjen dhe ngritjen e qëndrueshmërisë së të ardhurave jo vetëm përmes instrumenteve që funksionojnë, por edhe përmes fuqizimit të dy institucioneve përgjegjëse për mbledhjen, përkatësisht grumbullimin mjeteve të cilat formojnë të ardhurat apo të ardhurat publike: Administrata Tatimore dhe Doganat. Kosova në

periudhën e pasluftës ka ndërtuar një sistem fiskal rishtas, të orientuar kryesisht në drejtim të harmonizimit me standardet evropiane. Tatimet kanë luajtur dhe mbasin të një rëndësie të veçantë, si nga aspekti i mbledhjes së të ardhurave buxhetore, ashtu edhe sa i përket pjesëmarrjes në Bruto Produktin Vendor (BPV-në) (Berisha, 2015). Struktura e të ardhurave publike dhe posaçërisht e të ardhurave tatimore në fillim ishte e pavolitshme. Por më vonë me reformimin e sistemit fiskal dhe tatimor në Kosovë, kjo strukturë e të ardhurave publike u thjeshtësua dhe u përmirësua shumë. Në këtë reformë kanë dhënë një ndihmë shumë të madhe institucionet ndërkombëtare siç janë Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Një ndër parakushtet qenësorë që të kemi një qëndrueshmëri të mbledhjes së të ardhurave publike në Kosovë është stabilizimi i rritjes afatgjatë ekonomike. Rritja ekonomike që nga paslufta ka qenë jo stabile dhe ka kaluar në rifillimin impresiv (RIINVEST, 2003) të aktiviteteve ekonomike, luhatje të normës së rritjes së PBB-së dhe frika nga recesioni në periudhën e krizës financiare të vitit 2007. Prandaj, një ndër çështjet kryesore që duhet pasur kujdes është që të përmirësohen politikat ekonomike.

Varësisht nga kriteret që i marrim në konsideratë, të ardhurat publike në Republikën e Kosovës ndahen në:

- Të ardhurat tatimore dhe jo tatimore,
- Të ardhurat që mblidhen në pikat kufitare (doganat) dhe që mblidhen në brendi (nga ATK),
- Të ardhurat qendrore dhe lokale, etj.

Për qëllime të këtij studimi ne në vazhdim kemi trajtuar të ardhurat sipas burimit.

3.4.1. Burimet e të ardhurave publike në Kosovë

Instrumentet e politikës fiskale në Kosovë janë ndërtuar në atë mënyrë që të jenë të thjeshta dhe lehtë të administroheshe. Përmes këtyre instrumenteve fiskale, Kosova krijon të ardhura publike për mbushjen e buxhetit të saj. Duke marrë parasysh kriterin e burimit të të ardhurave, sot në Kosovë mblidhen këto : (a) të ardhurat nga tatimet, (b) të ardhurat nga jo tatimet dhe të ardhurat që mblidhen nga shërbimet e qeverisë qendrore dhe lokale dhe (c) të ardhurat e tjera që merren nga donatorë dhe huamarrjet etj. (Shala, 2016). Burimi kryesor i të ardhurave buxhetore në Kosovë vazhdojnë të jenë të ardhurat nga tatimet dhe pa ndryshime gjatë gjithë viteve të periudhës së pasluftës (Badivuku- Pantina, M dhe Maloku, E., 2012).

3.4.1.1. Të ardhurat tatimore në Kosovë

Mbledhja e të ardhurave tatimore në Kosovë viteve të fundit ka shënuar sukses të konsiderueshëm falë reformave të njëpasnjëshme që janë bërë në vend. Kosova në fillim të viteve 2000 kishte një sistem total të shkatërruar nga administrimi serb 1989-1999, administrim që e kishte shkatërruar total. Në fillim ishte jashtëzakonisht vështirë që të rimëkëmbet ky sistem sepse edhe ekonomia e vendit ishte e shkatërruar plotësisht. Menjëherë pas çlirimit të Kosovës, përgjegjës për ndërmarrjen e hapave për rimëkëmbjen e vendit ishte Misioni i Kombeve të Bashkuara - UNMIK. Hapat e parë u ndërmorën në vitin 1999 dhe duke vazhduar me reformimin komplet të sistemi ekonomik dhe fiskal të Kosovës. Falë reformave të njëpasnjëshme Kosova ka zhvilluar një sistem fiskal të bazuar në përvojat dhe politikat e institucioneve të ndërtuara për administrimin e tatimeve, siç ishin Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës. Struktura e tatimeve në fillim të viteve 2000 dhe 2001 ishte shumë e pavolitshme. Mbi 96% e të ardhurave buxhetore grumbulloheshin nga burimet të cilat gjeneronin bizneset (RIINVEST, 2002).

Përmes këtyre dy institucioneve, Kosova sot ka të ndërtuar këtë strukturë të tatimeve: tatimi në vlerën e shtuar, akciza, detyrimet doganore, tatimi në të ardhura të korporatave, tatimin në të ardhura personale, tatimi në pronë dhe tatimet tjera.

Në vitin 2016, në Buxhetin e Republikës së Kosovës janë mbledhur të ardhura nga tatimet në vlerë prej 1 miliard e 423 milion e 270 mijë euro (MF, 2017) ose rreth 88.85% e të ardhurave të përgjithshme publike (shtojca tabela A2). Një ndër tatimet më kryesore që mbledh Qeveria e Kosovës është Tatimi i Vlerës së Shtuar - TVSH. Ky tatim ka filluar të mbledhet për herë të parë në korrik të vitit 2001 dhe në vitin 2016 i cili përbën 41.04% të vlerës së mbledhur e të ardhurave të përgjithshme të Buxhetit të Kosovës (shtojca tabela A5) apo 46.20% e vlerës së tatimeve të mbledhura po në këtë vit (MF, 2017). Gjithashtu është me interes të këtij hulumtimi të theksohet se pjesëmarrja e të ardhurave tatimore në Produktin e Brendshëm Bruto për vitin 2016 ishte 24.28% (shtojca tabela A3). Në këtë drejtim Kosova nuk bën ndonjë dallim të madh nga pjesa dërmuese e vendeve të rajonit (Figura 4.5). Pra Kosova gjatë periudhës 2004- 2015 këtë tregues e ka në intervalin 20% - 30% (MF, 2017).

3.4.1.2. *Të ardhurat jo tatimore në Kosovë*

Të ardhurat buxhetore të Kosovës sigurohen nga burimet tatimore dhe jo tatimore. Të ardhurat jo tatimore kanë një rol të madh në mbushjen e arkës së shtetit. Si të ardhura jo tatimore që mbledhen nga institucionet e Kosovës për BRK-në janë: tarifa dhe ngarkesa doganore, gjobat dhe tarifat, dividendi, të ardhurat vetanake të komunave dhe të institucioneve qendrore. Pjesëmarrja e të ardhurave jo tatimore në të ardhurat gjithsej të mbledhura nga qeveria e Kosovës në vitin 2016 ka qenë 10.95% (shtojca tabela A2), që do të thotë se në këtë vit (2016) ka qenë e ardhur mjaft e rëndësishme e Kosovës. Pjesëmarrja e të ardhurave jo tatimore në PBB-në e vendit ka qenë relativisht e madhe

2.99% (shtojca tabela A3). Trendi i mbledhjes i këtyre të ardhurave 2004-2016 në përgjithësi nuk ka qenë i qëndrueshëm (Figura 4.3, grafiku majtas- lartë).

3.4.1.3. Të ardhurat nga grandet

Buxheti i Kosovës vazhdimisht është përkrahur nga donatorë të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtar. Vlera e inkasuar në BRK ka qenë relativisht jo e madhe . Kontribuuesit më të mëdhenj e të drejtpërdrejtë si donatorë në vitin 2012 në BRK (MF, 2013) kanë qenë Banka Botërore, Këshilli i Evropës, qeveritë e shteteve si ajo: britanike, italiane, zvicerane dhe donatorët nga bashkë participimi i qytetarëve për projekte të ndryshme kapitale. Gjithashtu buxheti i Kosovës merr mjete edhe nga huat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si dhe mjete nga participimet e ndryshme nga qytetarët. Në vitin 2016, buxheti i Kosovës ka pranuar të ardhura nga grandet 3.34 milion euro (Tabela 4.1) që paraqet nivelin më të ulët që nga viti 2014. Përkundër vlerës së vogël të mjeteve të pranuar nga grandet në buxhetin e Kosovës, ajo paraqet një të ardhur mjaft me rëndësi për Kosovën sepse përmes këtyre pranimeve Kosova plotëson disa standarde për ruajtjen e qëndrueshmërisë buxhetore. Pjesëmarrja e këtyre të ardhurave në PBB-në vendit është shumë e ulët ose e papërfillshme.

3.4.2. Efiçenca dhe administrimi i mbledhjes së të ardhurave publike

Për të analizuar efiçencën e mbledhjes së të ardhurave publike në Kosovë nuk është e drejtë pa paraqitur edhe dy institucionet më të rëndësishme që bëjnë grumbullimin e të ardhurave publike për buxhetin e Republikës së Kosovës. Efiçenca e mbledhjes së të ardhurave varet kryekëput nga këto dy institucione dhe miradministrimi i tyre do ta rrisë këtë efiçencë. Në vazhdim të këtij punimi do të trajtohen këto institucione . Gjithashtu

një ndër fenomenet që ndikojnë në suksesin apo mosesuksesin e realizimit të të ardhurave publike është edhe evazoni fiskal. Me këtë fenomen ne jemi marrë me një analizë sipërfaqësore por që është mjaft e rëndësishme për të kuptuar pengesat që janë shfaqur në realizimin e synimeve të qeverisë në mbushjen e arkës shtetërore. Me këtë temë janë marrë edhe shumë hulumtues të tjerë, por ne kemi përmendur vetë disa nga këto hulumtime dhe gjetje.

3.4.2.1. Administrata Tatimore e Kosovës

ATK-ja, është themeluar me datën 17 Janar 2000, nën drejtimin dhe administrimin e UNMIK -ut. Nga shkurti i vitit 2003 barten kompetencat e udhëheqjes nga UNMIK- u tek Ministria për Ekonomi dhe Financa , dhe që nga ajo kohë, ATK-ja funksionon si agjenci ekzekutive me autonomi të plotë operationale e menaxhuar krejtësisht nga vendorët me asistencën e organizatave donatore ndërkombëtare, përfshirë atë të USAID-it, BE -së, FMN-së, etj. (ATK, 2011).

Në fillim, ATK-ja ka mbledhur tatimin në hoteleri dhe restorante, i cili është zëvendësuar me tatimin e paragjykuar, ku janë trajtuar të gjitha të ardhurat biznesore. TVSh ka filluar të aplikohet që nga data 01.07.2001. Në prill të vitit 2002 ka filluar të aplikohet tatimi në paga, si dhe tatimi në fitim për personat juridik, të cilët deri në atë kohë janë tatuar me tatim të paragjykuar. Nga janari i vitit 2005 është bërë një reformë tatimore, duke zëvendësuar tatimin e paragjykuar, tatimin në paga dhe tatimin në fitim me dy lloje të reja të tatimeve si: Tatimi në të Ardhura Personale, i cili taton personat fizik, dhe Tatimi në të Ardhura të Korporatave, i cili taton personat juridik. Sistemi tatimor në Kosovë ka evoluar nga sistemi i Rregulloreve të UNMIK -ut në sistemin e ligjeve tatimore të nxjerra nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Administrimi i Administratës Tatimore të

Kosovës është i rregulluar me ligj bazik të veçantë, ligji për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/l-222 (Gazeta Zyrtare, 2010). Gjithashtu për të kompletuar punën e këtij institucioni të rëndësishëm shtetëror në mbledhjen e të ardhurave publike janë nxjerrë edhe shumë rregullore dhe udhëzimesh administrative. Ky institucion në vitin 2016 ka mbledhur rreth 386.199 milion euro për buxhetin e Kosovës ose rreth 24.11% e gjithsej të ardhurave publike të mbledhura. (MF, 2017).

3.4.2.2. Doganat e Kosovës

Dogana e Kosovës është një prej dy organeve kryesore qeveritare në Kosovë që janë përgjegjëse për mbledhjen e tatimeve. Sistemi i tatimeve në Kosovë, i themeluar gjatë dekadës së fundit, është relativisht i ri. Ai është themeluar në gusht të vitit 1999, në kuadër të Shtyllës IV të Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, me përgjegjësinë për të siguruar zbatimin e rregulloreve doganore të drejta dhe të njëjta për të gjithë, si dhe për zbatimin e dispozitave të tjera që vlejnë për mallrat të cilat i nënshtrohen kontrollit doganor. Pas Shpalljes së Pavarësisë dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ish-Shërbimi Doganor i UNMIK-ut, siç njihej deri atëherë, u shndërrua në Doganën e Kosovës, në dhjetor të vitit 2008. Ndryshe nga disa vende të rajonit, sistemi doganor në Kosovë konsiderohet se është kompakt dhe i thjeshtë. Që prej themelimit, ky sistem ka kaluar nëpër një sërë ndryshimesh dhe modifikimesh me qëllim harmonizimin me acquis të BE-së dhe standardet evropiane. Për këtë qëllim, fusha e doganave në Kosovës gjithashtu është mbështetur nga donatorët, në aspektin e zhvillimit të legjislacionit, politikave dhe ngritjes së kapaciteteve, me synim zhvillimin e tërë sistemit të doganor në një administratë moderne për vjeljen e të ardhurave.

Dogana e Kosovës është themeluar në vitin 1999 nën UNMIK-un dhe u bë e njohur si Dogana e Kosovës në dhjetor të vitit 2008. Është zhvilluar mbi bazën e standardeve të BE-së dhe aktualisht ka rreth 600 të punësuar. Përveç mbledhjes së të ardhurave nga detyrimet dhe taksat, Dogana e Kosovës mbron shoqërinë nga kontrabanda e drogës dhe mallrave tjera të ndaluara dhe zbaton ligje që mbrojnë shoqërinë kundër efekteve paragjyquese të krimeve ekonomike dhe evazionit të mbledhjes së të hyrave.

Doganat e Kosovë në vitin 2016 kanë realizuar mjete në vlerë prej 1037.068 milion euro ose 64,74% më shumë së mbledhur të të ardhurave publike në vitin 2016 (MF, 2017).

3.4.2.3. Evazoni fiskal në Kosovë

Evazoni fiskal është mospagim i detyrimeve tatimore që rrjedhin nga ligji. Lidhet me të gjitha ato veprime që kanë për qëllim të zvogëlojnë ose të eliminojnë kontributin fiskal në arkën e shtetit prej qytetarëve ose subjekteve, duke shkelur dispozita dhe norma fiskale specifike. Evazoni fiskal ka një efekt shkatërrues ndaj politikës fiskale të qeverisë duke i shkaktuar shtetit një humbje jo të vogël nga të ardhurat fiskale të tij. (Mustafa, 2014). Fshehja e detyrimeve tatimore, nëpërmjet dorëzimit të dokumenteve false, deklaratave të pavërteta apo informacioneve joreale, vlerësimi i të cilave çon në përlllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion fiskal (Subashi, 2016). Evazoni fiskal është përdorimi i taktikave të paligjshme për të shmangur detyrimet financiare, zakonisht në kuptim të taksave (WiseGEEK, 2017).

Në Kosovë autoritetet deklarojnë se vitet e fundit evazoni fiskal ka shënuar rënie. Ky konstatim nuk përputhet me atë të ekspertëve të çështjeve ekonomike të cilët ngulmojnë në atë se kjo dukuri ka marre përmasa të mëdha e shqetësuese dhe si e tillë ndikon rëndë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës (Mustafa, 2014). Kjo mendohet se vjen si pasojë e

vështirësisë që paraqitet te ndëshkohen të gjithë tatimpaguesit që i shmangen obligimit të tyre, për shkak të pamundësisë së kontrollimit të të gjithë kufijve dhe qarkullimit të lirë në të gjitha territoret, pamundësia për të operuar me zyrtarët tatimor në disa territore etj. Institutit (RIINVEST, 2001) në hulumtimin e tij lidhur me çështje të caktuara të politikës fiskale, ndër faktorët kryesorë që determinojnë evazionin fiskal, midis tjerash, janë theksuar:

- mbulimi akoma jo i plotë i pikave kufitare dhe gjendja asimetrike e zbatimit të ngarkesave tatimore në kufi;
- njohja nga ana e UNMIK-ut e regjimit preferencial tregtar me IRJM dhe keqpërdorimi i certifikatave të origjinës së mallrave;
- niveli i lartë i normave tatimore (dhe doganore), sidomos mos rregullimi i nivelit adekuat të akcizave për mallrat që importohen dhe procedurat e importit të mallrave me akciza.

Evazoni fiskal gjenerohet edhe nga veprimet ilegale, siç janë ryshfeti, reketimet, plaçkitjet, si dhe nga aktivitetet ekonomike të paregjistruara që nuk kryejnë obligimet tatimore. Përmasat dhe format e ekonomisë joformale dallojnë prej një vendi në vendin tjetër dhe kjo varet nga kushtet e afarizmit dhe gjendja aktuale ekonomike dhe politike, si dhe nga niveli i zhvillimit dhe faza e tranzicionit në të cilën gjenden vendet e ndryshme. Disa nga këto janë karakteristike edhe për ekonominë kosovare, siç janë: importi ilegal, qarkullimi i parasë së gatshme jashtë kanaleve të qarkullimit të pagesave, mospagimi i tatimeve dhe detyrimeve të tjera, shfrytëzimi i ndërmarrjeve shoqërore dhe publike për qëllime private, kryerja e veprimtarive tregtare, ndërtimore, shërbyese, bujqësore etj. pa e regjistruar biznesin.

Shkaqet e evazionit fiskal, të cilat janë identifikuar deri më tani, vazhdojnë të dëmtojnë të hyrat fiskale. Është fjala këtu për një mori çështjesh si ligjore, administrative dhe organizative, të lidhura me tejkalimin e asimetrisë doganore ndaj vendeve fqinje, mbulimin më të mirë të kufijve, ngushtimin e ekonomisë joformale me të gjitha karakteristikat dhe pasojat që sjell ajo për efektet fiskale dhe barazinë në treg. E një rëndësie të veçantë është ndërmarrja e masave për kultivimin e kulturës fiskale, e cila do të jetë e orientuar si kah tatimpaguesit, për t'i përmbushur obligimet tatimore, ashtu edhe kah komuniteti i konsumuesve buxhetor, për të qenë më efikas, racional dhe efektiv në shpenzimin e mjeteve buxhetore. Instrumente të rëndësishme në këtë aspekt do të jenë: programet mësimore, mjetet e informacionit publik, publikimet speciale, komunikimi i drejtpërdrejtë me tatimpaguesit, auditimin, kontrolli dhe përgjegjësia para organeve ligjore, botimet e udhëzuesve tatimorë për firmat dhe qytetarët. Një studim i vitit 2011 nga Riinvest dhe UNDP-ja tregon që bizneset kosovare perceptojnë konkurrencën jo-fer të shtyrë nga evazoni fiskal dhe in formaliteti, si barrën më të rëndë në listën e 22 barrierave të tjera. Kjo ishte hera e parë që “konkurrenca jo-fer” doli në majë të listës së barrierave, pas një grupi studimesh të studimeve të kaluara që listuan korrupsionin dhe furnizimin me rrymë si barriera kryesore në biznes ((Riinvest, 2013).

3.5. Rritja ekonomike

Rritja ekonomike është një rritje në kapacitetin e një ekonomie për të prodhuar mallra dhe shërbime, krahasuar nga një periudhë kohore në tjetrën. Kjo mund të matet në terma nominalë ose reale, kjo e fundit e cila është e përshtatur për inflacion. Tradicionalisht, rritja e agregatit ekonomike matet në terma të prodhimit bruto kombëtar (PBK) ose produktit të brendshëm bruto (PBB). Produkti i brendshëm bruto është mënyra më e mirë

për matjen e rritjes ekonomike. Kjo për shkak se merr parasysh të gjithë prodhimin ekonomik të vendit. Ai përfshin të gjitha mallrat dhe shërbimet që bizneset në vend prodhojnë për shitje. Nuk ka rëndësi nëse ato shiten në vend apo jashtë saj (Amadeo, 2017). Pra, rritja ekonomike është rritja e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga një ekonomi, zakonisht një komb, për një periudhë të gjatë kohore. Ai matet si përqindje e rritjes së Bruto Produktit Vendor (BPV), i cili është bruto produkti vendor (BPV) i përshtatur për inflacionin. BPV është vlera e tregut e të gjitha mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në një ekonomi apo komb (Wells, 2017). Me trajtimin e rritjes ekonomike janë marrë shumë teoricienë dhe ekonomistë që nga kohët e lashta e deri me sot. Një ndër mendimtarët më të hershëm është edhe arabi Ibn Khaldun, i cili që nga jo kohë është marrë me trajtimin e çështjes së rritjes ekonomike. Sipas autorit (OTUBALA, 2014), në vitin 1377 mendimtari i njohur arab Ibn Khaldun ka bërë një nga përshkrimet më të hershme për rritjen ekonomike në veprën e tij të njohur “Muqaddimah”, ku kishte hedhur idenë se rritja ekonomike ishte sa rritja e normës së popullsisë ose normës së tatimit që mund të gjenerojë të holla për kurorën e shtetit. Mendimtari tjetër i mirënjohur që ka trajtuar rritjen ekonomike si fenomen i ekonomisë është edhe Smith. (Smith, 1776) shpjegoi se rritjen ekonomike (prodhimi) varet nga sasia e imputeve (Toka, Puna dhe Kapitali) dhe prodhimi përcaktohet nga rritja e popullsisë, rritja e investimeve dhe toka në përgjithësi. Gjithashtu bashkë kohaniku i tij, David Ricardo, rritjen ekonomike e shpjegon përmes rritjes së produktivitetit të punës dhe tregtisë së favorshme në mes vendeve të ndryshme. Me rritjen ekonomike janë marrë edhe shumë ekonomistë të cilët kanë vazhduar dhe kanë zhvilluar mendimet e mendimtarëve të hershëm siç janë: Solow, Rommer, Swam, Domar dhe të tjerë. Solow (1956) në modelin e tij të rritjes ekonomike thekson se akumulimi i kapitalit dhe shkalla

ekzogjene e ndryshimit të popullsisë dhe progresit teknologjik janë burime të rritjes. Rommer (1986) shpjegon se rritja ekonomike afatgjatë përcaktohet nga stimujt ekonomik. Rritja ekonomike nuk ndodh rastësisht, por është një përgjigje, ndër të tjera, për cilësinë e politikave publike, posaçërisht për ato që ndikojnë në investime, produktivitet, inovacion teknologjik dhe në efektin e jashtëm. Përderisa rritja e prodhimit kontribuon në zhvillimin njerëzor, rritja e cilësisë së lartë kërkon qasje të barabartë në mundësitë e ofruara për arsim, shëndetësi dhe gjenerim të të ardhurave për të gjithë qytetarët. Procesi i rritjes shoqërohet me një spektër të gjerë të politikave duke përfshirë këtu zhvillimin financiar, infrastrukturën publike, kornizën rregullatorë, intervenimin qeveritar dhe politikat industriale.

3.5.1. Një vështrim i përgjithshëm i rritjes ekonomike në Kosovë

Historiku i shkurtër i zhvillimit ekonomik në periudha të caktuara ndihmon për të kuptuar burimin e problemeve dhe konflikteve zhvillimore dhe reflektimin e tyre në aspektet ekonomike, si edhe në ato sociale e politike në Kosovë. Pas Luftë II Botërore, në vitin 1947, Kosova kishte 728 mijë banorë, me pjesëmarrje të popullsisë bujqësore 80.9%, shkallë të rritjes natyrore të popullsisë 2.55%, shkallë të analfabetizmit (mbi 10 vjet) 62.5%, dhe shkallë tejet të ulët të punësimit - 16 veta në 1000 banorë. Industria kishte pjesëmarrje vetëm 16.1% në krijimin e produktit shoqëror.

Shënimet e rregullta për ekonomin e Kosovës si duket kanë filluar të përgatiten pas luftës së dytë botërore me stabilizimin e sistemit socialist jugosllav. Si do që të jetë thënë, deri para vendosjes së "masave të dhunshme" nga rrënojat e luftës së dytë botërore janë është ngritur një nivel i ekonomisë së një qarku të mbyllur. Pika të veçuara të këtij qarku kanë qenë korporata, apo siç thuhet sot kompanitë, si "Trepça", "Agro Kosova" etj. Në sektorin

e ndërtimtarisë, ndërmarrjet edhe sipërmarrjet e ndërtimit si duket nuk kanë arritur të krijojnë korporatën e tyre dhe kanë ngelur në nivel më të ultë se ajo e industrisë dhe tregtisë e industrisë ushqimore. (RIINVEST, 2007).

Sipas një hulumtimi të kryer nga Riinvest (2005), Kosova asokohe kishte të drejtë dhe fuqi që të planifikonte dhe të financonte strategjitë ekonomike dhe në të njëjtën kohë të hynte edhe në marrëdhënie kontraktuese me institucionet financiare ndërkombëtare. Në periudhën 1965-1975, Kosova ka realizuar shkallën më të lartë të rritjes ekonomike, kur janë bërë ndryshimet thelbësore dhe cilësore në strukturën e prodhimit, si dhe rritje të moderuar në periudhë 1976-1980 (tabela 3.4).

Tabela 3.4 Rritja ekonomike e Kosovës 1948-2004

Periudha	Rritja vjetore e outputit kombëtar (%)
1948-1965	5.7
1966-1970	6.0
1971-1975	7.5
1976-1980	3.6
1981-1985	1.8
1986-1988	1.1
1989-1999	-5.0
2000-2001	10-16
2002-2005	(-3) – (-4)

Burimi: Marrë nga publikimi i RIINVEST-it në vitin 2005

Në këtë periudhë Kosova realizoi një rritje ekonomike të ngjashme me disa nga vendet, siç janë Armenia, 7,3-12,9%, Azerbajxhani 9,7-10,6%, vendet e EJT 5,3-10,2%, etj. (Riinvest, 2005).

Tabela 3.5 Rritja ekonomike e EJT dhe vendeve tjera (%)

	1998	2001	2002	1998-2003
Armenia	7.3	9.6	12.9	7.7
Azerbajxhani	10.0	9.9	10.6	9.7
Takixhistani	5.3	10.2	9.1	7.1
Vendet EJT	3.3	7.1	6.9	5.4

Vendet e tjera të EJT	-0.2	8.1	5.8	5.1
Vendet e zhvilluara	3.5	4.1	4.6	4.5
Vendet e industrializuara	2.7	1.0	1.8	2.4

Burimi: Marrë nga publikimi i RIINVEST-it në vitin 2005

Me çështjen e rritjes ekonomike të Kosovës është marrë edhe hulumtuesi (Reçica, 2009), i cili ka theksuar se pas luftës, problemet të cilat e kanë përcjellë ekonominë e Kosovës mund të grupohen në:

- Energjia elektrike stabile;
- Privatizimi dhe rindërtimi i ngadalshëm;
- Mungesa e investimeve, posaçërisht e investimeve nga jashtë, si rezultat i pasigurisë politike;
- Mungesa e tregut të kapitalit financiar (kamatat e larta me afat të shkurtër kthimi);
- Tregu tepër liberal. Këtu veçohen mallrat nga Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi, të cilat përbëjnë mbi 50% të mallrave të importuara. Kjo vetëm nga shkak se mallrat që hyjnë në Kosovë nga këto vende nuk i nënshtrohen taksës së rregullt doganore;
- Ngarkesa e lartë e investimeve kapitale dhe re-materialit të importuar me tatim dhe doganë (që në pikat kufitare), e cila destimulon prodhimin vendor, dhe në të kundërtën stimulon importin nga vendet e cekura më lartë;
- Përkrahja e pamjaftueshme e bizneseve fillestare dhe NVM-ve, qoftë përmes stimulimeve dhe konsultimeve të ndryshme profesionale të organizuara në formë të seminareve, qofte nëpërmes trajnimeve nga ana e shtetit apo institucioneve shtetërore dhe shoqatave të biznesit;
- Vështirësitë për qarkullimin e shpejtë dhe efikas të afaristëve jashtë vendit.

Ekonomia e Kosovës së pasluftës po shënon rritje të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) krahasuar me periudhën paraprake. Por ajo që ende është brengosëse ka të bëjë me shkallën e të hyrave e cila është ndër më të ulëtat në Evropë. Kosova po ballafaqohet me varfëri të gjerë, por jo edhe shumë të thellë (Reçica, 2009). Kosova ka përjetuar rritje të njëjlojshme ekonomike që nga fundi i konfliktit në vitin 1999. BPV-ja është rritur me norma dyshifrore në vitet 2000-2001, duke pasqyruar përpjekjet e rindërtimit masiv të financuar nga donatorët në fund të konfliktit. Rritja e më pastajmë ishte mesatare dhe e shtyrë nga financimi i vazhdueshëm nga donatorët, dërgesat e diasporës dhe një rimëkëmbje graduale në aktivitetet ekonomike. Ndërmjet viteve 2005 dhe 2007, rritja vjetore ishte mesatarisht rreth 4 për qind, e mbajtur me konsumin dhe investimet në rritje. Eksportet gjithashtu janë rritur shpejt por nga një bazë fillimi shumë e ulët, ashtu që kontributi i tyre ishte më modest. Zhvillimi arriti kulmin me 5.5 për qind në vitin 2008, me fuqinë e një politike fiskale ekspansioniste (BB, 2010).

Sipas raportit vjetor të (BQK, 2005), rritja reale e ekonomisë së Kosovës në vitin 2004 arriti në shumën 3,2% me çmimet e pandryshueshme të vitit 2002. Në vitin 2004 konsumi llogaritej 139.8% nga 146.2% në vitin 2003, ndërkohë që gjithashtu shfaq ulje në krahasim me konsumin e vitit 2003 me 1.3%. Investimet në Kosovë mbeten në nivele të ultë të cilat në fund të vitit 2004 arrin 27.7% të PBB-s. PBB-ja reale e Kosovës në vitin 2005 u ul me 0.5%, duke arritur në rreth 2.5 miliardë euro. Kërkesa e brendshme (konsumi dhe investimet) kontribuon pozitivisht në rritjen reale në vitin 2005 me 0.2 pikë përqindje, ndërkohë që për vitin 2004 ky kontribut ishte 4.6 pikë përqindje. Kontributi i eksporteve neto në rritjen e PBB-së reale gjatë vitit 2005 ishte -0.7 pikë përqindje. (BQK, 2006). Në vitin 2007 PBB-ja u rrit me 3.5% me gjithë rënien e sektorin e donatorëve, si kontribuues në rritje ishte sektori privat, kryesisht nga investimet (BQK, 2008). Rritja

reale e PBB-së për vitin 2008 vlerësohet të ketë qenë 5.4% , përkundër krizës financiare globale.

Kontribuuesit më të mëdhenj janë konsumi privat me 15.1% dhe investimet publike 141.4% (BQK, 2009). Përkundër zhvillimeve negative në ekonominë botërore, ekonomia e Kosovës në vitin 2009 u karakterizua me rritje pozitive ekonomike, edhe pse me një normë më të ulët se në vitin 2008. Për dallim nga vitet paraprake, sektori publik ishte gjeneruesi kryesor i kësaj rritjeje ekonomike. Kjo ndodhi si rezultat i rritjes së konsumit dhe investimeve të këtij sektori. Edhe rënia e çmimeve prej 2.4 për qind mund të konsiderohet si një ndër faktorët që ka kontribuar pozitivisht në normën reale të rritjes ekonomike gjatë vitit (BQK, 2010). Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2012 shënoi normë pozitive të rritjes. Sidoqoftë, aktiviteti i përgjithshëm ekonomik në vend u sfidua nga zhvillimet në tregjet rajonale dhe evropiane. Gjatë vitit 2012 kishte luhatje të theksuar në disa nga burimet e rëndësishme të financimit në vend, veçanërisht investimet e huaja direkte. Sektori publik gjithashtu vazhdon të ketë rol pozitiv në stabilitetin e ekonomisë së vendit si në kuadër të te ardhurave ashtu edhe në kuadër të shpenzimeve buxhetore. Përveç investimeve kapitale, sektori publik gjatë vitit 2012 nëpërmjet subvencioneve ka ndihmuar që të përshpejtohet ritmi i zhvillimit në sektorin e bujqësisë, pasi që është shënuar rritje e numrit të ndërmarrjeve të reja në këtë sektor (BQK, 2013). Ekonomia e Kosovës në vitin 2015 ndoqi një ritëm të përshpejtuar të rritjes. Sipas vlerësimeve të (BQK, 2016), vlera nominale e PBB-së në vitin 2015 ka qenë 5.73 miliard euro, që paraqet një normë reale të rritjes prej 3.5%. Rritja ekonomike gjatë këtij vit ishte si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, gjegjësisht konsumit privat dhe investimeve.

Tabela 3.6 PBB-ja e Kosovës dhe norma e rritjes (1948-2004)

Viti	PBB me çmime aktuale	Shkalla vjetore e rritjes së PBB	Shkalla e rritjes reale e PBB (%)
2004	2,912.00	16.26	2.1
2005	3,003.00	3.13	-0.5
2006	3,120.00	3.90	3.1
2007	3,461.00	10.93	3.5
2008	3,882.80	12.19	5.4
2009	4,069.60	4.81	3.8
2010	4,401.30	8.15	4
2011	4,814.50	9.39	5
2012	5,058.80	5.07	2.9
2013	5,326.60	5.29	3.1
2014	5,568.00	4.53	2.7
2015	5,771.50	3.65	3.5
2016	6,015.00	4.22	

Burimi: ASK dhe FMN dhe BQK

Monitorimi i kriterëve ekonomike në Kosovë duhet të shihet në kontekstin e rritjes së rolit të qeverisjes ekonomike në procesin e zgjerimit, që është mirëpritur nga Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të 17 dhjetorit 2013 dhe konkluzionet e Këshillit të 18 shkurtit 2008, ku Këshilli i kërkoi Komisionit për të përdorur instrumente të komunitetit për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës (EU, 2014).

Rritja reale i kapërceu 5 për qind të GDP në 2011, e vënë në lëvizje nga investimet e fuqishme dhe konsumi privat (Tabelat 1, 2). Megjithatë, ekonomia u ngadalësua në 2012, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të vitit, me tkurrjen e FDI dhe si pasojë edhe të investimeve private. Ngadalësimi u shoqërua me uljen e rritjes së kredive nga pothuaj 15% në 2011 në 4.5% (Tabela 3). Megjithatë, me pothuaj 2.5%, rritja e vlerësuar reale mbeti më e forta në rajon. Rritja del se ka qenë jo e njëtrajtshme në muajt e parë të 2013: kredit, vjelja e taksave dhe importet, të gjitha tregojnë për kërkesë më të fortë në tremujorin e parë, por aktivitet më të ulët në prill dhe maj. (IMF, 2013).

Nuk mund të mohohet fakti se efektet e krizës financiare janë ndjerë edhe në Republikën e Kosovës, ku gjatë kësaj periudhe mund të vërehen qartë pasojat: ulja e ekonomisë reale, varfëria, zvogëlimi i remitançave, zvogëlimi i investimeve të jashtme, kontraktimi\ kriteret për kreditë bankare dhe efektet e tjera direkte dhe indirekte. Është e rëndësishme të merret në konsideratë fakti që, pavarësisht krizës së fundit, modeli i rritjes ekonomike, bazuar në thellimin e procesit të integritimit në BE, sa i përket financave, tregtisë, tregjeve të punës dhe institucioneve, mbetet modeli më i mirë për vendet në zhvillim dhe vetë Kosovën (Thaçi, 2016).

3.6. Teoritë kryesore

3.6.1. Teoritë e të ardhurave publike

Teoria e të ardhurave publike merret me burimet alternative të të ardhurave shtetërore. Ajo shpjegon dhe analizon përparësitë krahasuese dhe mangësitë e formave të ndryshme të të ardhurave dhe parimin që duhet të udhëheqin gjatë zgjedhjes së tyre. Për të ardhurat publike është diskutuar shumë në mesin e akademikëve dhe teoricienëve, ka pasur shumë mendime dhe janë zhvilluar teori të ndryshme. Një ndër teoritë kryesore që janë zhvilluar në fushën e të ardhurave publike janë edhe teoritë mbi tatimet. Në vazhdim të këtij studimi jam munduar ti paraqes ato më kryesore.

3.6.2. Teoritë Tatimore

Disa teori të tatimit ekzistojnë në ekonominë publike. Qeveritë në të gjitha nivelet (kombëtare, rajonale dhe lokale), kanë nevojë për të rritur të ardhurat nga një shumëllojshmëri e burimeve për të financuar shpenzimet e sektorit publik. Detajet e tatimit të udhëhiqen nga dy parime: të cilët do të përfitojnë dhe që mund të paguajnë.

Në të kaluarën e largët ka pak mendimtarë apo ekonomistë që janë marrë me çështjen e tatimit. Në fillim ata nuk kanë qenë aq dashamirës dhe përveç formave të tatimit ata janë drejtuar përgjithësisht nga pikëpamja e shtetit duke kërkuar që të maksimizojnë të ardhurat e saj duke bërë dëm minimal për ekonominë.

Ka ndryshime midis shkollave të ndryshme, por shtytja e përgjithshme është e njëjtë. Kështu, **cameralistët** interesonin sinqerisht vetëm në maksimizimin e të ardhurave shtetërore, siç ishin absolutistët francezë; Ekonomistët më liberalë e paralajmëruan qeverinë të mbajë normat e tatimeve më të ulëta se sa ishte zakon. (THEORIES, 2017)

Ekonomistët më liberalë janë përpjekur të përcaktojnë rreptësisht funksionet të cilat qeveria duhet dhe nuk duhet të kryejë. Duke përjashtuar llojet e ndryshme të ndërhyrjes së qeverisë, futja, ndërsa gjërat e tjera janë të barabarta, është zvogëlimi i taksave dhe shpenzimeve totale të qeverisë. Sipas autorit Zera (THEORIES, 2017), Diskutimi i Adam Smithit mbi tatimet në Pasurinë e Kombeve, si pjesa tjetër e punës së tij, u bë një ambient klasik që vinte në qendër të mendimit ekonomik që nga ajo pikë. Dhe, si pjesa tjetër e veprës, ishte një përzierje e hutuar e banaleve dhe e gabuar. Kështu, Smith parashtroi katër "kanune" të "drejtësisë" dhe përdorimit të dukshëm' në taksat, të cilat do të bëheshin të famshme që nga atëherë. Nga katër, tre janë të rëndomta: që pagesa tatimore të bëhet sa më e përshtatshme për paguesin: që kostoja e arkëtimit të mbahen në minimum, meqë shteti as nuk përfiton nga taksat e tatimpaguesit; dhe se tatimi të jetë i sigurt, se sa arbitrar. Në literaturën e financave publike, ekzistojnë disa teori: (a) teoria e përfitimit (ErikLindahl, (b) teoria e kostos së shërbimit dhe (c) teoria e aftësisë së pagesës (Pigou, 1947).

(a) Sipas kësaj teorie, shteti duhet të mbledh tatime nga individët në bazë të përfitimit të akorduar në to. Sa më shumë përfitime një person rrjedh nga aktivitetet e shtetit, aq më

shumë ai duhet të paguajë për qeverinë. (b) Disa ekonomistë ishin të mendimit se nëse shteti ngarkon koston aktuale të shërbimit të dhënë nga populli, ai do të plotësojë idenë e barazisë apo të drejtësisë në tatimim. Kostoja e parimit të shërbimit pa dyshim mund të aplikohet në një farë mase, në ato raste kur shërbimet e kryera janë nga të çmimeve dhe janë pak të lehtë për të përcaktuar, për shembull, shërbimet postare, shërbimet hekurudhore, furnizimi me energji elektrike, etj. Por, shumica nga shpenzimet e kryera nga shteti nuk mund të jetë fikse për çdo individ, sepse ajo nuk mund të përcaktohet saktësisht. (c) Parimi më i popullarizuar dhe i pranuar i kapitalit apo drejtësisë në tatimeve është që qytetarët e një vendi duhet të paguajnë tatimet për qeverinë, në përputhje me aftësinë e tyre për të paguar. Ajo duket shumë e arsyeshme dhe vetëm se tatimet duhet të vendosen në bazë të kapacitetit të tatueshëm të një individi. Për shembull, në qoftë se kapaciteti i tatueshme i një personi A është më i madh se personi B, duhet të kërkohej që të paguajnë më shumë taksa se sa kjo e fundit (EconomicConcepts, 2017).

3.6.3. Teoritë e rritjes ekonomike

Pjesa e teorisë ekonomike që kërkon të shpjegojë (dhe shpreson për të parashikuar), shkallën në të cilën ekonomia e një vendi do të rritet me kalimin e kohës. Rritja ekonomike matet zakonisht norma vjetore përqindje të rritjes në një apo një tjetër i agregateve të mëdha të vendit të kontabilitetit të ardhurat kombëtare, të tilla si Bruto Produktit Kombëtar apo të Prodhimit të Brendshëm Bruto (pothuajse gjithmonë me rregullimet e duhura statistikore për zbritje efektet potencialisht mashtruese e inflacionit të çmimeve). Vetëm për ekonominë e çdo vendi do të tregojë vit për vit dhe për tremujorët luhatjet e konsiderueshme në normën e saj të rritjes ekonomike, por teoricienët e rritjes ekonomike kanë tendencë të përqendrojnë përpjekjet e tyre për të analizuar dhe

shpjeguar variacionet më të vogla në trendin afatgjatë ose norma mesatare e rritjes ekonomike gjatë periudhave të një dekadë apo më shumë. Ata lënë shpjegimin e luhatjeve më afatshkurtra rreth trendit afatgjatë të profesionistëve në teorinë e ciklit të biznesit për shkak se hetimi ka treguar se ndikimet mbizotëruese në ritmet e rritjes afatshkurtër duket të ndryshojnë në mënyra të rëndësishme nga përcaktuesit e mesatares së ekonomisë gjatë performancës e rritjes. Në të kaluarën janë marrë shumë mendimtarë për rritjen ekonomike dhe për këtë qëllim kanë ndërthurur shumë teori dhe modele të rritjes ekonomike. Çështja e rritjes ekonomike në fushën e ekonomisë është trajtuar në forma të ndryshme, varësisht nga shtrimi i problemit. Për të pasqyruar sa më mirë këtë ne vazhdim janë prezantuar disa nga teoritë e rritjes ekonomike të cilët janë marrë nga ekonomistët ndër vite në fushën e financës publike.

Ndër studiuesit e parë që janë marrë me këtë problematike ka qenë Solow (1956), i cili duke përdorur modelin e rritjes neoklasike ka analizuar se si ndikojnë politikat e tatimeve në rritjen ekonomike. Nga rezultatet e nxjerra nga Solow (1956), kjo rritje e qëndrueshme nuk është nga efektet e politikës fiskale, me fjalë tjera, politikat fiskale me gjithë shtrembërimet nuk kanë ndikim në normën e rritjes ekonomike në terma afatgjatë, edhe në qoftë se ajo nuk e ul nivelin e ekonomisë joformale, vënë në afat gjatë. Ndryshe nga kjo teori e rritjes endogjene nga Romer (1999), krijoi modelin e rritjes në të cilën shpenzimet qeveritare dhe politika tatimore kanë efekt permanent në terma afatgjatë.

Në nivelin teorik, modeli i rritjes neoklasike **të hijeve** të ndryshëm është përdorur në studimin e efekteve të shpenzimeve qeveritare dhe të taksave mbi rritjen. Një tipar i përbashkët i të gjitha modeleve neoklasike është se politikat fiskale ose ndryshe, mund të ndikojnë vetëm në nivelin e të ardhurave, por jo në normën e qëndrueshme të rritjes ekonomike të shtetit, të cilat mund të preken vetëm nga shkalla e ndryshimit teknologjik

dhe rritjes së popullsisë (ose fuqisë punëtore) . Megjithatë, politikat mund të ndikojnë në shpejtësinë e tranzicionit nga një shtet i qëndrueshëm në tjetrin dhe rrjedhimisht, rritjes ekonomike gjatë tranzicionit. (Odedokun, 2001).

(Castles, F.G. and S. Dowrick, 1990), (Atkinson, 1995), (Agell, J., T. Lindh and H. Ohlsson,, 1997) argumentojnë se përdorimi i ndryshëm i shpenzimeve totale të qeverisë ndikon në rritje ndryshe dhe një argument i ngjashëm zbatohet për mënyrën e rritjes së të ardhurave nga taksat. Gjatë dekadave të fundit, disa vende kanë rritur taksat mjaft dramatike, ndërsa në vendet e tjera normat e taksave kanë mbetur pothuajse të njëjta (Anastassiou and Dritsaki, 2005).

Një nga tiparet karakteristike të (Devarajan, S., S. Vinaya and Z. Heng-fu, 1996) është se norma e rritjes së ekonomisë shprehet në terma të shkallës tatimore dhe të shpenzimeve. Këto të fundit janë edhe ekzogjene pasi që vendimet e qeverisë janë marrë siç jepet. (Carboni, 2013)

Kohët e fundit, megjithatë, teoria e rritjes endogjene u zhvillua nga Romer (1986), (Lucas, 1988) dhe të tjerë. Brenda këtij kuadri, politikat mund të ndikojnë në normën e rritjes së qëndrueshme të shtetit dhe jo vetëm të normës së rritjes gjatë tranzicionit nga një shtet i qëndrueshëm në tjetrin. Pas këtij zhvillimi, një numër studimesh - p.sh. (Barro, 1999) dhe (Cashin, 1995) janë përpjekur të modelojnë efektet e shpenzimet qeveritare dhe taksat për rritjen e qëndrueshme të shtetit.

3.6. Rezultatet e kërkimeve empirike

Në Kosovë që nga viti 2002 e deri me tani ka pasur vazhdimisht rritje të të ardhurave publike, por shqetësimi më i madh që është ngritur nga ekonomistët vendor dhe ndërkombëtar ka qenë se kjo rritje e të ardhurave a ka pasur ndikim në rritjen ekonomike të vendit? Për ta verifikuar ndikimin e të ardhurave publike në rritjen ekonomike janë marrë shumë studiues në vend dhe botë në përgjithësi. Studimet që janë kryer së fundmi rreth ndikimit të të ardhurave publike në rritjen ekonomike të një vendi kanë treguar që ka pikëpamje të ndryshme. Pra hulumtuesit janë të ndarë sa i përket gjetjeve në ndikimin e të ardhurave publike në rritjen ekonomike. Kjo bëhet e qartë në studimin e kryer nga hulumtues në financat publike dhe në ekonomi, ku është parë se disa burime të të ardhurave mund të kenë një efekt pozitiv në rritjen ekonomike, ndërsa disa kanë divergjenca në pikëpamjet e tyre mbi burimin e efektit të të ardhurave publike në rritjen ekonomike. Gjithashtu, disa studime janë fokusuar në ndikimet e të ardhurave publike të grumbulluara nga burimet natyrore, disa nga burimet tatimore dhe jo tatimore, etj.

Gjatë shqyrtimit të literaturës ne kemi hasur në gjetje (përfundime) të ndryshme sa i përket ndikimit apo marrëdhënieve të të ardhurave publike në rritjen ekonomike. Ka pasur hulumtues që me hulumtimet e tyre kanë konstatuar se të ardhurat publike kanë ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike, por ka pasur edhe të atillë që kanë gjetur që ky ndikim ka qenë negativ. Gjithashtu, gjatë hulumtimit të kësaj literature ka edhe të atillë që nuk kanë qenë të qartë përfundimin e analizave të tyre. Ne në vazhdim do të prezantojmë disa nga gjetjet e hulumtuesve të vendeve të ndryshme që kanë argumentuar ndikimin e të ardhurave publike (pozitive dhe negative) në rritjen ekonomike .

Kusi, (1998) vlerëson produktivitetin e të ardhurave në sistemin e përgjithshëm të tatimeve të Ganës dhe të tatimeve individuale në bazë të vlerësimeve të buoyancies tatimore dhe

elasticitetit. Ai gjithashtu shikon lidhjet në mes reformës tatimore 1983-1993 dhe performancën e të ardhurave, si dhe mënyra e mobilizimit tek të ardhura shtesë. Analiza tregon se reforma e tatimeve ka pasur ndikim të rëndësishëm në produktivitetin e dy tatimeve individuale dhe të sistemit të përgjithshëm të tatimeve. Të gjitha tatimet individuale, me përjashtim të detyrimeve tatimore të eksportit të kakaos dhe të akcizës, tregoi buoyancies dhe elasticiteti i më shumë se uniteti gjatë periudhës së reformave, duke çuar sistemin e përgjithshëm të tatimeve për të pasur një buoyancy dhe elasticitetin e më shumë se çdo uniteti. Përmirësimi i mprehtë në produktivitetin e të ardhurave gjatë periudhës së reformave ishte kryesisht për shkak të zhvlerësimeve të njëpasnjëshme të kursit të këmbimit. Ajo u mbështet edhe nga fluksi i madh i kredive të huaja, heqja e kontrollit të çmimit dhe të importit të licencimit të sistemit, thjeshtëzimin e normave të tarifave të importit, si dhe rregullim të plotë të administratës tatimore. Rezultatet empirike kanë ndikim të rëndësishëm për sistemin fiskal të Ganës. Ai tregon se një sistem tatimor që i përgjigjet rritjes ekonomike, është po ashtu i dëshirueshëm pasi që mundëson që të ardhurat nga tatimet të rriten automatikisht pa pasur nevojë ndërhyrjen politike për rritjen e normave tatimore. Në këtë drejtim, theksi duhet të vendoset në ato tatime që kanë elasticitetin të lartë të të ardhurave. Në rastin e Ganës, të gjitha tatimet individuale të hetuara për periudhën 1983-1993 kishin elasticitet relativisht të lartë, me përjashtim të tatimit mbi të ardhurat personale që kishte elasticitet vetëm pak mbi unitetin. Implikimi politik këtu është se autoritetet duhet të largohen gradualisht nga tatimi i bazuar mbi të ardhurat, që i diskriminon kursimet dhe investimet, në favor të tatimeve të bazuara mbi konsumin.

Gbayesola dhe Ugo (1999) ka studiuar reagimin mesatar dhe stabilitetin ndër kohor të të ardhurave të qeverisë në Nigeri nga viti 1970 - 1995 duke përdorur analizën e regresionit

dhe testin statistikor (parametër) si chow test (t-testit) për ndryshimin strukturor, për të përcaktuar stabilitetin ndër kohor. Ata gjetën se të ardhurat totale të mbledhura nga qeveria federale ka qenë më të përgjegjshme për të ndryshuar në të ardhura në vitet e hershme. Ata gjithashtu gjetën madhësinë e reagimit të parametrave vlerësues në ndryshimin tek të ardhurat tatimore duke ndryshuar normat tatimore dhe ndryshimet e konsiderueshme në reformën e tatimeve, gjersa ekonomia lëvizë nga viti 1980. Stabiliteti ndër kohor i të ardhurave publike gjithsej në rastin e Kosovës, sipas analizës sonë, e kemi vërtetuar dhe se reagimi i parametrave vlerësues në ndryshimin e të ardhurave tatimore përmes ndryshimit të normave tatimore është bërë me disa reforma, siç është bërë në vitin 2009 dhe 2015.

Anastassiou dhe Dritsaki, (2005) në hulumtimin e tyre janë përpjekur të analizojnë marrëdhëniet në mes të të ardhurave të përgjithshme tatimore, tatimit në të ardhura dhe tatimit mbi fitimet kapitale, kursimet e brendshme bruto dhe normës së rritjes ekonomike. Me qëllim për ta gjetur këtë marrëdhënie, janë përdorur analizat shkakësore e të dhënave vjetore që nga viti 1965 deri në 2002 dhe aplikimin e modelit VAR me shumë ndryshore dhe testimin për shkakësinë Granger midis variabëlve. Gjetjet kanë treguar se ekziston një marrëdhënie shkakësore në mes të ardhurave tatimore dhe rritjes ekonomike në Greqi. Modeli i përdorur nga Anastassiou dhe Dritsaki në vitin 2005, është marrë në shqyrtim edhe nga ne duke e zhvilluar atë me të dhënat e Kosovës me periudha më afatshkurtra (tremujore). Rezultatet e nxjerra nga ne kanë vërtetuar se ekziston një marrëdhënie shkakësore në mes të të ardhurave publike dhe rritjes ekonomike.

Lee dhe Gordon (2005), strategjia e tyre kryesore empirike ka qenë për të parë efektet tatimore në rritjen e normës së PBB-së për frymë, duke përdorur një grup ndër sektorial të të dhënave. Ata kanë gjetur se norma e tatimit në korporata është dukshëm e lidhur

negativisht me rritjen ekonomike në një grup të të dhënave ndër seksioni të 70 vendeve gjatë 1970-1997, të kontrolluara nga shumë përcaktues/model i rritjes ekonomike. Ata gjithashtu kanë gjetur variabël të tjera tatimore, duke përfshirë normat mesatare tatimore në të ardhurat e punës dhe normat e përgjithshme marginale tatimore të Koesterit dhe Kermendit, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të konsiderueshme me rritjen e normës ekonomike. Vlerësimet tregojnë se prerja e tatimeve të korporatave nga 10 për qind mund të rrisë normën vjetore të rritjes me rreth 1.1%. Në efektet fikse të vlerësimeve duke përdorur një grup të të dhënave panel të ndërtuar për të njëjtën periudhë kohore, efektet e vlerësuara janë më të mëdha, me të njëjtën ndryshim të tatimeve që nënkupton një rritje të normës vjetore të rritjes prej rreth 1.8%. Një çështje e hapur mbetet arsyetimi i efektit negativ të normës së tatimit të korporatës në rritje. Ai evidenton dëshmi se normat e ulëta të tatimeve të korporatave të çojnë në të ardhurat personale tatimore të ultë, një rezultat në përputhje me një normë më të ulët të tatimit të korporatës duke inkurajuar më shumë veprimtari sipërmarrëse. Megjithatë, informacioni agregat i raportuar këtu është i pamjaftueshëm për të nxjerrë një konkluzion përfundimtar në lidhje me burimin e saktë të lidhjeve në mes të normave të tatimeve dhe rritjes. Këto rezultate sigurisht sugjerojnë se efektet e rritjes së reformave tatimore, si dhe për më shumë standarde të efikasitetit dhe efektet e kapitalit në një kontekst statik, meriton vëmendje serioze. Këto efekte të rritjes bindshëm pasqyrojnë një korrigjim nga eksternalitete pozitive që dalin nga veprimtaritë inovative, eksternaliteteve lënë pas dore në analizë standarde të tatimeve. (Reed R. W., 2007), duke përdorur të dhënat pesëvjeçare nga 1970-1999 në dyzet e tetë shtetet kontinentale në SHBA, ai gjeti se të dy (i) ndryshimet e njëkohshme dhe (ii) nivelet e mbetura të tatimeve janë negativisht dhe në mënyrë të konsiderueshme në lidhje me rritjen ekonomike. Efektet e vlerësuara ndryshojnë në varësi të specifikimeve të

ndryshueshme; procedura e vlerësimit; periudha kohore, rajoni, dhe shteti, si dhe mënyra në të cilën të dhënat janë të organizuara në intervale pesëvjeçare. Megjithatë, gjetja e efekteve tatimore negative dhe statistikisht të rëndësishme në përgjithësi janë të fuqishme në të gjitha këto dimensione, me një përjashtim: vlerësimet shtetërore specifike të efekteve tatimore ndryshojnë shumë. Ky rezultat i fundit mund të shpjegohet me analizë ekonometrike të ngushtë të të dhënave. Në këtë nivel të analizës janë vetëm gjashtë vëzhgime për koeficientet e tatimeve shtetërore specifike. Këto rezultate janë befasuese duke pasur parasysh se studimet e mëparshme kanë pasur vështirësi në identifikimin e një marrëdhënie të fuqishme ndërmjet tatimeve e shtetit, si dhe të ardhurat. Analiza e tij sugjeron se kjo mund të jetë për shkak se studimet e mëparshme rreth rritjes së të ardhurave të shtetit kanë qenë të prirë për të përdorur të dhënat vjetore, kanë pasur dallime në specifikimet e tyre të variabëlve, dhe nuk e kanë lejuar për efekte tatimore të vonuara. Ai ka përdorur të dhënat vjetore dhe kufizimet e analizës për efektet tatimore bashkëkohore, ai i ka vlerësuar efektet pozitive tatimore, por madhësia dhe kuptimi i koeficientit të tatimeve ndryshojnë shumë në varësi të specifikimeve të ndryshueshme. Kur ai ka përfshirë vlerat e variabëlit të tatimeve të mbetura, del një lidhje negative midis tatimeve dhe rritjes. Kjo mungesë e fuqisë nuk është e dukshme në të dhënat e intervalit pesëvjeçar. Kjo mund të jetë për shkak se variabëliti bashkëveprojnë me kalimin e kohës në mënyra komplekse që janë të vështira për të modeluar. Ajo mund të jetë se të dhënat, për arsye përkufizuese dhe matjes, nuk janë të përshtatshme për t'u lidhur me njëri-tjetrin në nivel vjetor. Shumë punë mbetet për t'u bërë përpara se vlerësimet e besueshme dhe të efekteve tatimore mund të merret. Megjithatë, ky studim konstaton se ekziston një marrëdhënie e rëndësishme empirike midis tatimeve dhe rritjen ekonomike në SHBA. Duke u nxitur nga konstatimi i Reed-it se variabëliti bashkëveprojnë me kalimin e kohës

në mënyrë komplekse dhe thirrjes së tij për hulumtuesit e ardhshëm që intervalet e analizës të zvogëlohen nga intervali 5 vjeçar, unë në analizën time kam përdorur të dhënat tremujorë dhe gjetjet kanë qenë impulsive. Studimi im vërteton konstatimet e Reed-it se ekzistojnë marrëdhënie të rëndësishme empirike midis të ardhurave tatimore dhe të rritjes ekonomike edhe në Kosovë.

Barrett dhe Greene (2008) studiovan sistemin tatimor shtetëror: Qëndrimi stabil në Ohajo dhe gjetjet se tendosja e paqëndrueshme e të ardhurave dhe tatimet e paparashikuara sjellin mjerim për të gjithë, nga buxheti i shtetit deri te bizneset. Kjo e bën të vështirë ruajtjen e programit dhe të investimeve për të ardhmen dhe ky është një shqetësim për tatimpaguesit si dhe për komunitetin e biznesit. Jo stabiliteti i bazuar në të ardhura dukshëm çon në buxhetim të vështirë në kohë të caktuar. Barrett dhe Greene (2008) rekomanduan që një tatim i bazuar në shumëllojshmëri në përgjithësi është më i qëndrueshëm se ajo e bazuar në jo shumëllojshmëri.

(Mashkor, Yahya, dhe Ali. (2010) kanë hulumtuar lidhjen shkakësore midis tatimit të përgjithshëm, të kursimit dhe rritjes reale të ekonomisë në bazë të sistemit të ARDL (Auto Regressive Distributed Lag) në Pakistan. Rezultatet e kësaj studimi tregojnë se kursimi shkakton rritje të PBB reale një drejtimesh, sepse ai nuk ka gjetur ndonjë provë statistikore në lidhje me shkaqet e kursimit nga ana e PBB-ës. Taksa e drejtpërdrejtë në PBB - raporti shkakton granger rritjen reale të PBB-së në mënyrë të konsiderueshme, që nënkupton se një nivel më të lartë të tatimit të drejtpërdrejtë do të nxisë një rritje reale.

Autorët Olatunji dhe Sunday (2012) kanë shqyrtuar ndikimin e qëndrimit fiskal në rritjen ekonomike në Nigeri nga viti 1970 deri në vitin 2010 duke përdorur mjete ekonometrike, siç janë statistikat përshkruese, testin e stacionaritetit, testin e bashkë integritetit, testin e varshmërisë së modelit të gabimit vektor (VECM), dekompozimet e variancës (VDCs),

dhe Funkzioni i Përgjigjes Impuls (IRFs). Rezultatet e bashkë integrimit sugjeruan se nivelet luhatëse të rritjes ekonomike gjatë periudhës lidhen me trendët në të ardhurat nga shitjet dhe eksportet e naftës dhe shpenzimet produktive qeveritare. Shpenzimet joproduktive të qeverisë nuk janë të bashkë integruara me trendin e rritjes ekonomike gjatë periudhës afatgjatë. Marrëdhënia shkakësore midis variabëlve tregon se financimi i deficitit qeveritar (GDF) dhe shpenzimet kapitale të qeverisë (CGE) janë neutrale në afat të shkurtër. Dekompozimet e Variancës (VDCs) dhe Funkzioni i Përgjigjes së Impulsit (IRFs) u kryen për të zbuluar shkakësinë e Granger në aktivitetin fiskal në një kontekst dinamik. Rezultatet nga analiza tregojnë se në shpenzimet afatshkurtra të qeverisë joproduktive dhe tatimet federale dalin ekonomikisht ekzogjen. Shpenzimet produktive të qeverisë (PGE), shpenzimet kapitale të qeverisë (CGE), tatimet federale (TAX) dhe shitjet dhe eksportet e naftës (OIL) çojnë në rritjen e prodhimit (GDP). Buxheti i qeverisë federale të Nigerisë dobësohet nga viti 2007 deri në vitin 2010 që tregon se më shumë se 60% e shpenzimeve totale të qeverisë është shpenzuar në sektorët joproduktivë, më pak se 15% për sektorët prodhues, shpenzimet kapitale marrin më pak se 25%, transferimin ligjor më pak se 5% dhe Shërbimi i Borxhit më pak se 10%. Rezultatet e reagimit të impulsit fiskal treguan se qëndrimi fiskal është relativisht më i prekshëm ndaj deficitit të qeverisë dhe të ardhurave nga shitjet dhe eksportet e naftës, një reduktim i ndjeshëm i financimit të deficitit qeveritar dhe shpenzimeve joproduktive do të çonte në rritjen dhe zhvillimin ekonomik.

Chigbu, Akujuobi dhe Ebimobowei (2012), qëllimi i këtij studimi ka qenë të hetojë kualitetet midis rritjes ekonomike dhe një sërë variabla tatimore në Nigeri. Për të kapur këtë, të dhënat makroekonomike në seri kohore janë zgjedhur nga 1970-2009. Analiza ekonometrike tregojnë se një marrëdhënie afatgjate ekziston midis rritjes ekonomike dhe

tatimit në Nigeri. Testi Johansen Co-integrimit pohoi se në afat të gjatë ekziston një marrëdhënie ndërmjet variabëlve shpjeguese dhe të shpjeguara. Rezultati shkakësia Granger po ashtu konfirmon marrëdhënien në mes të tatimeve dhe rritjes ekonomike. Edhe gjetjet tona duke përdorë testin e ko integrimit Johansen se në periudhën afatgjatë konfirmojnë marrëdhëniet ndërmjet variabëlve shpjeguese dhe të shpjeguara edhe në rastin e Kosovës duke përdorë të dhënat tremujore nga viti 2004 deri 2016.

Një studim i kryer nga dy hulumtues në Turqi: Helhel dhe Demir (2012) ka hetuar marrëdhëniet midis të ardhurave tatimore dhe rritjes ekonomike në ekonominë turke për periudhën 1975-2011. Testi i ko integrimit Johansen Juselius dhe testimi i shkakësisë së Granger janë përdorur për të gjetur marrëdhënie afatgjata dhe afatshkurtra. Funksioni i impulsit-përgjigjes dhe analiza e dekompozimit të variancës janë zbatuar nëpërmjet modelit VAR. Gjetjet kanë treguar se ka ndërveprim midis llojeve të të ardhurave nga tatimet dhe rritjes ekonomike në afat të gjatë dhe nuk është një ndërveprim i tillë në afatin e shkurtër. Efekti i goditjes që i është dhënë tatimit të tërthortë në normën e rritjes ekonomike ka rënë; përgjigjja e normës së rritjes ndaj goditjeve të dhëna për të ardhurat e drejtpërdrejta tatimore ka qenë tendenca të rritet deri në fund të periudhës. Në metodën e dekompozimit të variancës; të ardhurat e taksave të drejtpërdrejta janë më efektive sesa ato indirekte. Por, niveli i rritjes që shprehet me PBB (produkti i brendshëm bruto) ose faktorë të tjerë që ndikojnë në rritjen dhe jo të ardhurat tatimore, është shfaqur e prekur.

Punimi i autorit (Jegade, 2014) u përqendrua në analizën ekonometrike të efektivitetit të të ardhurave publike në rritjen ekonomike në vendet në zhvillim: një ekzaminim të Nigerisë në periudhën 1980-2008. Studimi vendosi një hipotezë e cila përfshin të ardhurat publike nuk ndikojnë në rritjen ekonomike në Nigeri. Studimi përdori të dhëna sekondare marrë nga banka qendrore e Nigerisë dhe Ministria Federale e Financave.

Studimi specifikoi një model të zbatueshëm në të cilin Produkti Brendshëm Bruto Real është variabël i varur, ndërsa të ardhurat totale të naftës, të ardhurat jo nga nafta dhe të ardhurat e pavarura federale janë variabla të pavarur. Metoda e zakonshme më pak katrore (OLS), T-test dhe F-test janë përdorur si teknika analitike. Studimi zbuloi se të ardhurat publike ishin efektive në nxitjen e rritjes ekonomike në Nigeri, sepse koeficienti i përcaktimit ($R^2 = 0.63$ ose 63%) ishte i rëndësishëm. Gjetjet tregojnë se të ardhurat e naftës dominojnë të ardhurat publike në Nigeri dhe kanë domethënie të fortë në RGDP me ç 'rast kjo tregohet nga vlera të T statistikë të saj. Pasojat e rritjes së të ardhurave të naftës do të rrisin Produktin e brendshme bruto. Me fjalë të tjera, rezultati i këtij studimi tregon se regresioni i shumëfishtë që kolektivisht vlerëson ndikimet e variabëlve të pavarura në produktin e brendshëm bruto të vërtetë tregon se ato kanë ndikim të rëndësishëm në ecurinë ekonomike të ekonomisë Nigeriane sa i përket periudhës 1980-2008. E njëjta situatë paraqitet edhe në rastin e Kosovës ku të ardhurat tatimore ushtrojnë një ndikim të qartë negativ në rritjen ekonomike ndërsa të ardhurat jo tatimore dhe të ardhurat nga grandet një ndikim pozitiv.

Sipas autorëve Yi dhe Suyono (2013) në përgjithësi, maksimizimi i të ardhurave tatimore është i papajtueshëm me maksimizimin e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Shumë ekonomistë do të pajtoheshin me propozimin që "tatimet e larta janë të këqija për rritjen ekonomike" dhe të përdorin shumëzuesin e tatimeve për të analizuar shpesh këtë korrelacion negativ. Por të ardhurat nga tatimet dhe PBB-ja e Provincës Hebei kanë arritur dy zhvillime që nga viti 1995 (reforma e ndarjes së tatimeve) dhe elasticiteti i taksave ka qenë më shumë se një në vitin e fundit. Si ta shpjegoni këtë kontradiktë nga pika e teorisë së efektit shumëzues të taksave? Është e rëndësishme për shkak të disa studimeve të mëparshme mbi këtë temë, veçanërisht në Kinë, në të cilën duhet të përballet me një

ngadalësim të rritjes ekonomike. Kjo do të kontribuojë në zhvillimin e njohurive në fushën e tatimeve publike. Ky studim analizon marrëdhëniet midis tyre në 1978-2011 me teorinë e thjeshtë dhe të ndryshuar të efektit të shumëzimit të taksave dhe modelin e shpërndarjes polinomiale (PDL). Rezultatet tregojnë se ndikimi negativ i rritjes së të ardhurave tatimore në rritjen ekonomike mund të mos jetë aq serioz sa mund të mendoni dhe shkurtime të taksave do të krijojnë efekte më pozitive në provincën Hebei. Për më tepër, efekti negativ është i vonuar dhe gjithnjë e më shumë i dukshëm, njëjtë është edhe me rastin e Kosovës ku të ardhurat tatimore kanë efekt negativ në rritjen ekonomike (PBB).

Janes, Ihendinihu dhe Nwaiwu (2015), metoda e zakonshme e regresionit të ndryshueshëm ishte shfrytëzuar, duke përdorur modelin linear të identifikimit për të analizuar marrëdhënien ndërmjet të ardhurave totale dhe rritjes ekonomike në Nigeri. Modeli i Korrigjimit të Gabimit është përdorur për të përcaktuar ekzistencën afatgjate dhe afatshkurtër të marrëdhënies midis variabëlve ekonomike. Të gjeturat tregojnë se rreth 63.6% e variacionit të përgjithshëm në PBB, real ishte si rezultat i variacionit të të ardhurave totale, e cila konfirmon ekzistencën e marrëdhënies së ekuilibruar afatgjate në mes të ardhurave totale dhe rritjes ekonomike në Nigeri. Në mënyrë të veçantë, modeli i korrigjimit të gabimit tregon ekzistencën e marrëdhënies së ekuilibruar afatshkurtër, në mes të ardhurave totale dhe rritjes ekonomike në Nigeri. Prandaj, studimi kontribuon në formën ekzistuese të njohurive, duke përcaktuar dinamikën afatshkurtra dhe afatgjate të komponentëve të të ardhurave tatimore dhe rritjes ekonomike në Nigeri.

Takumah (2014) nga studimi i tij konstaton se edhe në periudhën afatgjatë dhe afatshkurtër janë gjetur efekte statistikisht të rëndësishme pozitive të të ardhurave tatimore për rritjen ekonomike në Gana. Kështu, studimi gjeti se modeli i rritjes endogjene të kohës

e argumentoi se tatimi qeveritar ka pasur ndikim në rritjen ekonomike në dy periudhat afatshkurtër dhe afatgjatë. Studimi gjeti gjithashtu një efekt pozitiv dhe të rëndësishëm të IHD-ve në PBB reale si në afat të gjatë dhe afat të shkurtër. Kjo rithekson rolin e rëndësishëm që IHD luan në procesin e rritjes së Ganës. shpenzimet qeveritare, formimi i kapitalit fiks bruto (K) dhe fuqia punëtore ka ushtruar një efekt pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Rezultatet e VECM treguan se termi korrigjim gabimi për rritjen ekonomike ka kryer shenjën e pritur negative. Studimi gjithashtu tregoi se ekziston një rastësi jo e drejtpërdrejtë në mes të ardhurave tatimore dhe rritja ekonomike dhe rrjedha e shkakësisë është me anë të të ardhurave tatimore për rritjen ekonomike në Gana. Kjo do të thotë se të ardhurat tatimore të çojnë në rritjen ekonomike, por e kundërta nuk qëndron. Gjetjet në këtë punim janë ndryshe nga gjetjet në rastin e Kosovës ku të ardhurat tatimore ndikojnë negativisht në rritjen ekonomike në periudhën afatgjatë ndërsa në periudhën afatshkurtër nuk kanë ndonjë ndikim të rëndësishëm.

Sipas autorit Muriithi (2013), ekonomitë me sektorë të mëdhenj publik rriten ngadalë për shkak të të çarave të mëdha tatimore, por mungesa e iniciativave të qeverisë për rritjen ekonomike mund të pengojë rritjen në vendet me qeveri shumë të vogla. Megjithatë të gjitha taksat kanë efekte des-incentive, taksat që ulin stimujt për të investuar në kapitalin njerëzor apo fizik dhe inovacionin, janë veçanërisht të dëmshme. Qëllimi i këtij studimi ishte përcaktimi i marrëdhënieve midis të ardhurave të qeverisë dhe rritjes ekonomike në Kenia. Studimi miratoi një dizajn kërkimor përshkrues. Ky studim ishte një studim rasti i një vendi pasi që vetëm Kenia ishte e përfshirë. Studimi përdori të dhëna sekondare, duke përfshirë detyrimet e importit, akcizave, tatimit mbi të ardhurat dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) të ardhurat tatimore. Përveç kësaj, studimi mbledhi të dhëna për të ardhurat jo tatimore. Studimi arrin në përfundimin se ekziston një marrëdhënie e

kundërt midis rritjes ekonomike dhe detyrimit të importit. Meqenëse detyrimi i importit rritet, rritja ekonomike zvogëlohet dhe anasjelltas. Sa i përket akcizës, ky studim arrin në përfundimin se si rritja e ngadalësimit të akcizës redukton ritmin e rritjes ekonomike. Për tatimin mbi të ardhurat, studimi arrin në përfundimin se tatimi mbi fitimin i themeluar çon në rritje të vazhdueshme të të ardhurave të fituara nga qeveria. Studimi më tej konkludon se ekziston një marrëdhënie e drejtpërdrejtë midis tatimit mbi të ardhurat dhe rritjes ekonomike. Studimi arrin në përfundimin se rritja e TVSH-së çon në efekte pozitive në normën e rritjes ekonomike. Sa i përket rritjes ekonomike, studimi arrin në përfundimin se ka pasur një rritje në Rritjen Ekonomike në Kenia gjatë viteve.

Qëllimi i këtij studimi të realizuar nga hulumtuesit Ofoegbu, Akwudhe Oliver (2016) është të shqyrtojë efektin e të ardhurave tatimore në zhvillimin ekonomik të Nigerisë dhe të konstatojë nëse ka ndonjë ndryshim në përdorimin e HDI dhe GDP-së në vendosjen e marrëdhënies. Qasja e adoptuar në këtë studim ishte ajo e përdorimit të të dhënave vjetore seri kohore për periudhën 2005 - 2014 për të vlerësuar një model linear të të ardhurave tatimore dhe indeksit të zhvillimit njerëzor duke përdorur teknikën e regresionit të zakonshëm më pak katror (OLS). Të gjeturat tregojnë një marrëdhënie pozitive dhe të rëndësishme midis të ardhurave tatimore dhe zhvillimit ekonomik. Rezultati gjithashtu zbulon se matja e efekteve të të ardhurave tatimore në zhvillimin ekonomik duke përdorur HDI jep marrëdhënie më të ulëta sesa matja e marrëdhënies me PBB-në duke sugjeruar që përdorimi i produktit të brendshëm bruto (PBB) jep një pasqyrë të pikturuar të marrëdhënies midis të ardhurave tatimore dhe zhvillimit ekonomik në Nigeri. Studiuesi, pra, konkludon se të ardhurat nga tatimet mund të jenë një instrument i zhvillimit ekonomik në Nigeri. Zhvillimi i çdo politike tatimore mbi të ardhurat tatimore për

zhvillimin ekonomik duhet të bazohet më mirë në indeksin e zhvillimit njerëzor dhe jo në GDP.

Alizadeh, Mohammadi dhe Mohammadi (2015), kanë analizuar efektin e luhatjeve në të ardhurat nga tatimet ndaj PBB-së. Metoda e përdorur në këtë studim është modeli i korigjimit të gabimit të vektorit. Për të analizuar dhe vlerësuar hipotezat e hulumtimit, modeli është hartuar duke u bazuar në të ardhurat vjetore të tatimeve dhe PBB-së. Testet rrënjës së njësise për të përcaktuar intervalin optimal dhe për të përcaktuar vektorët dhe koeficientet e bashkë-integritit të modelit VECM në modelin e paraqitur. Rezultatet tregojnë paqëndrueshmërinë e të ardhurave tatimore ndaj ndikimit të PBB-së dhe rritjen e të ardhurave tatimore. Dhe si një grup, mund të thuhet se në çdo periudhë do të kompensohet 68% e të ardhurave tatimore në fuqi në PBB.

Hulumtuesit Yi dhe Suyono (2013), kanë treguar se në përgjithësi maksimizimi i të ardhurave tatimore është i papajtueshëm me maksimizimin e PBB-së. Por ky parim nuk është certifikuar në Kinë. Sipas të dhënave të fundit ekonomike, të dyja të ardhurat tatimore të Kinës dhe GDP rriten me shpejtësi dhe janë në ngritje. Në të njëjtën kohë, norma e rritjes së të ardhurave tatimore është gjithmonë shumë më e madhe se norma e rritjes së PBB-së në vit. Në Kinë, nëse efekti i shumëfishimit të taksave tradicionale ka një mekanizëm të posaçëm transmetimi? A ka ndonjë problem në të ardhurat nga tatimet dhe PBB-në e Kinës? Bazuar në këto probleme, ky dokument teston këtë hipotezë se ndryshimi i të ardhurave tatimore nuk është domosdoshmërisht për të ndikuar në GDP. Ne përdorim të dhënat ekonomike të vitit 2000-2010 të provincës Hebei si një shembull për të analizuar dhe testuar marrëdhëniet e brendshme midis të ardhurave tatimore dhe rritjes ekonomike të Kinës. Ne kemi gjetur se struktura joshkencore e të ardhurave nga

taksat çon në problemin. Kjo sugjeron që reduktimi i taksave dhe reforma e sistemit aktual tatimor duhet të zbatohen.

Autoret Stoilova dhe Patonov (2012) kanë treguar një ndikim të qartë dhe të shprehur me forcë të tatimeve të drejtpërdrejta në rritjen e ekonomisë. Kjo është për shkak të fitimeve të efikasitetit të grumbullimit të të ardhurave nëpërmjet tatimit të pasurisë. Krahasimi në mes të ndikimit të të ardhurave tatimore akumuluar nga të dy llojet e tatimeve konfirmon supozimet për një efikasitet më të ulët të tatimeve indirekte, si një metodë e grumbullimit të të ardhurave buxhetore. Ky fakt është për shkak të masë të konsiderueshme e pabarazisë së tatimeve indirekte dhe efektet mbi prodhimit dhe zvogëlimit të shitjes. Si pasojë, struktura e tatimeve bazuar në tatimet direkte është më efikase në drejtim për të mbështetur rritjen e ekonomisë në vendet e BE-së. Megjithatë, analiza në sistemin e tatimeve është gjithmonë një problem i ditës dhe është e vështirë për të nxjerrë konkluzione përfundimtare nga këto rezultate empirike.

Efektet e taksave në rritjen e nivelit shtetëror kanë qenë subjekt i polemikave të vazhdueshme, me shumë rezultate kontradiktore dhe të brishta në literaturë. Në këtë material Gale, Krupkindhe Rueben (2015), duke përdor analizën ekonometrike me metodën e katrorëve të vegjël (OSL) paraqiti rezultate të reja për ndikimin e të ardhurave tatimore, normave tatimore marginale dhe variabëlve të tjerë mbi rritjen e të ardhurave të përgjithshme personale, formimin e firmës dhe punësimin. Gale ka zhvilluar modelin e ndërtuar nga Reed (2008), i cili tregon se të ardhurat tatimore kanë ndikuar negativisht dhe kanë ndikuar ndjeshëm rritjen e të ardhurave personale reale nga 1970-1999. Pas përsëritjes së rezultateve të tij për një periudhë pak më të ndryshme, ai tregoi se rezultatet nuk janë të forta për zgjatjen e periudhës kohore gjatë vitit 2006 ose 2011, se efekti i të ardhurave tatimore në rritjen e të ardhurave personale ndryshonte në mënyrë dramatike

në periudhën 1977-1991 (kur ishte negativ) dhe periudhës 1992-2006 (kur ishte jo-negative dhe ndoshta pozitiv) dhe se të ardhurat nga tatimet e ndryshme kanë efekte të ndryshme në rritjen e të ardhurave personale. Këto rezultate hedhin poshtë pretendimin e Reed se ekziston një ndikim i fuqishëm dhe i qëndrueshëm i të ardhurave tatimore në rritjen e të ardhurave personale. Gale gjithashtu tregon se përfshirja e masave të normës tatimore marginale nuk ndikojnë në rezultatet e të ardhurave tatimore dhe se normat e tatimore marginale në përgjithësi nuk hyjnë në ekuacionet e rritjes. Për më tepër, kontrollet për shpenzimet qeveritare dhe variabël të tjerë shpjegues nuk ndryshojnë asnjë nga këto rezultate. Në përputhje me këto efekte agregate, ai tregoi se normat e taksave marginale në përgjithësi nuk kanë ndikim në punësim dhe efektet statistikisht të rëndësishme, por ekonomikisht të vogla në shkallën e formimit të firmës. Rezultatet e nxjerra nga ai (Gale) nuk janë në përputhje me pikëpamjen se shkurtime në normat e larta të taksave mbi të ardhurat e shtetit do automatikisht ose domosdoshmërisht prodhojnë i mpaktë të rëndësishme, ose ndonjë ndikim, në rritje. Nëse çdo gjë, studimi i tij prodhon disa dëshmi se të ardhurat nga tatimi në pronë lidhen me rritjen. Eksplorimi i kësaj lidhjeje, sidomos lidhja mes vlerave të tokës, të ardhurave nga tatimi në pronë dhe rritjes, mund të jetë me vlerë të hulumtimit shtesë.

Në një hulumtim të kryer nga disa hulumtues siç janë: Ojong, Anthony dhe Arikpo (2016), kanë shqyrtuar ndikimin e të ardhurave tatimore në ekonominë Nigeriane. Objektivat e studimit ishin; për të shqyrtuar marrëdhëniet midis tatimit të fitimit të naftës dhe ekonomisë së Nigerisë, ndikimin e tatimit mbi të ardhurat e kompanisë në ekonominë nigeriane dhe efektivitetin e të ardhurave jo të naftës në ekonominë Nigeriane. Studimi empirikësh shqyrtoi efektin e tatimit mbi rritjen e ekonomisë Nigeriane. Ai tregoi lidhjen në mes variablës së inkorporuar, siç janë tatimi mbi fitim nga nafta (PPT), të ardhura jo

nga nafta dhe të ardhura nga korporatat (CIT). Të hyrat e jo të naftës kontribuon në rritjen e ekonomisë në Nigeri, Tatimi në të Ardhurat e korporatave pati një ndikim pozitiv në ecurinë e ekonomisë nigeriane. Rezultatet hodhën poshtë se një rritje në të hyrat jo të naftës çon në rritjen e rritjes ekonomike. Gjetjet e këtij studimi janë në përputhje me gjetjen e Okafor (2012) i cili hulumtoi ndikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat në rritjen ekonomike të Nigerisë, duke adoptuar teknikën e analizës së regresionit të zakonshëm me katrorë të vegjël (OLS) për të eksploruar marrëdhëniet ndërmjet PBB-së variabël e varur) dhe një grup të ardhurash tatimore të qeverisë federale mbi të ardhurat gjatë periudhës 1981-2007. Rezultati i regresionit tregoi një marrëdhënie shumë pozitive dhe të rëndësishme midis komponentëve të të ardhurave tatimore dhe rritjes së ekonomisë së Nigerisë. Këto gjetje janë mbështetur gjithashtu edhe nga Akwe (2014), i cili analizoi ndikimin e të ardhurave tatimore jo-naftës në rritjen ekonomike nga viti 1993 deri në 2012 në Nigeri. Studimi përdori metodën e regresit më të vogël të zakonshëm për të analizuar të dhënat e mbledhura për studim. Rezultati nga testi tregon se ekziston një ndikim pozitiv i të ardhurave tatimore jo të naftës për rritjen ekonomike në Nigeri.

Një hulumtim tjetër i kryer nga Mutaşçudhe Dănuleşiu (2011) ka analizuar marrëdhënien midis tatimeve dhe rritjes ekonomike në rastin e Rumanisë në periudhën janar 1999 - mars 2010, duke përdorur një model të pakufizuar Vector Autoregression (VAR) bazuar në normën e nivelit të taksimit dinamik dhe normën e rritjes ekonomike dinamike. Marrëdhënia është pyetje në të dy drejtimet, konkretisht në lidhje me mënyrën në të cilën taksat ndikojnë rritjen ekonomike, por edhe në aspektin e ndikimit që rritja ekonomike ushtron mbi taksat në rastin e Rumanisë për periudhën e përmendur. Siç tregojnë rezultatet nga ky hulumtim, një rritje nga DG (Dinamic Economic Growth)) përcakton një ulje të sheshtë të DT (Dinamic Taxation) në afat të mesëm dhe afatgjatë. Ky efekt

është me intensitet të ulët në 2 vitet e para (afat të shkurtër) dhe rritet ndjeshëm gjatë pjesës tjetër të intervalit. Ndërsa PBB-ja është burim i tatimeve, rritja e normave të rritjes çon në uljen e nivelit të kufizimeve tatimore për shkak të rritjes së bazës tatimore (norma e taksave është konstante). Nga ana tjetër, një goditje pozitive në DT gjeneron një rritje në nivelin e rritjes ekonomike në afat të gjatë. Ky reagim tregon se, në rastin e Rumanisë, ka shumë faktorë të tjerë që mund të nxisin rritjen ekonomike, të cilat kanë efekte shumëfishuese të tendencës. Për më tepër, çdo ndryshim në bazën tatimore autorët rumun kanë treguar se ka një reagim të fortë elastik në lidhje me normën tatimore. Nga ana tjetër, rritja e bazës tatimore përcakton një rënie të shkallës tatimore. Ne kemi vërejtur se rënia e normës tatimore nuk përfshin domosdoshmërisht një ulje të kufizimeve tatimore në fuqinë blerëse.

Hulumtimi i kryer nga hulumtuesit Stoilova dhe Patonov (2017) ka për qëllim të studiojë trendët në bazë të shpërndarjes së barrës së përgjithshme tatimore në shtetet anëtare të BE (27) gjatë periudhës 1995-2010. Theks i veçantë vihet mbi ndikimin e taksave në rritjen ekonomike. Marrëdhënia hetohet me anë të analizës së regresionit. Rezultatet empirike treguan një ndikim të qartë dhe të fuqishëm të taksave direkte mbi rritjen e ekonomisë. Kjo është për shkak të fitimit të efikasitetit të akumulimit të të ardhurave nëpërmjet tatimit të pasurisë. Krahasimi midis ndikimeve të të ardhurave tatimore të akumuluar nga dy llojet e tatimeve konfirmon supozimet për një efikasitet më të ulët të taksave indirekte si një metodë e akumulimit të të ardhurave buxhetore. Ky fakt është për shkak të shtrirjes së konsiderueshme të pabarazisë në taksat indirekte dhe efektet e tkurrjes ndaj prodhimit dhe shitjes. Rrjedhimisht, struktura tatimore e bazuar në taksat e drejtpërdrejta është më e efektshme në drejtim të mbështetjes së rritjes së ekonomisë në vendet e BE. Megjithatë,

analiza mbi sistemin e taksave është gjithmonë një problem aktual dhe është vështirë të nxirren përfundime përfundimtare nga këto rezultate empirike.

Autorët Dackehag dhe Hansson (2012) kanë kryer një hulumtim me titull “Tatimin në të ardhura dhe rritja ekonomike, një analizë për 25 vendet e pasura të OECD-së”. Ky hulumtim synon të sigurojë disa njohuri në marrëdhëniet midis tatimit të burimeve të ndryshme të të ardhurave dhe rritjes ekonomike. Këtë e bëjmë duke studiuar korrelacionin midis normave tatimore statutores mbi të ardhurat e korporatave dhe të të ardhurave personale dhe rritjes ekonomike në 25 shtete të pasura të OECD-së gjatë periudhës 1975-2010. Ndryshe nga shumë studime të mëparshme, ata kanë lejuar që tatimet të kenë një efekt jo-linear në rritjen ekonomike. Arsyeja për këtë është se normat më të larta mund të jenë më të shtrembëruara dhe kështu të ndikojnë negativisht në rritje, ndërkohë që normat më të ulëta mund të gjenerojë të ardhura të shpenzuara në mënyrë produktive. Ata gjejnë se mbështetje empirike për një marrëdhënie jo lineare. Si taksimi i ulët i të ardhurave të korporatave dhe të punës personale rritet rritja ndërsa normat e larta ngadalësojnë rritjen. Ndërsa rezultati për tatimin e të ardhurave personale është më pak i qëndrueshëm, rezultatet për normën e tatimit të korporatave janë të fuqishme në të gjithë specifikimet dhe zgjedhjen e variabëlve të përfshirë. Përveç kësaj, ne gjejmë mbështetje për tatimin e dividendëve që kanë një ndikim negativ në rritjen ekonomike edhe pse kjo rezultati është gjithashtu më pak i fuqishëm se ai i normës së tatimit në korporata. Rezultatet e këtij dokumenti sugjerojnë që tatimi i të ardhurave të korporatave ka një ndikim të fuqishëm të dëmshëm në rritjen ekonomike, një rezultat që është në përputhje me hulumtimet më të fundit.

Marrëdhënia midis rritjes ekonomike dhe të ardhurave është hulumtuar edhe nga studiuesi Gacanja (2012). Analiza empirike përdori të dhëna vjetore të vargjeve të ndryshme të

variabëlve të taksave dhe rritjen ekonomike për periudhën 1971 deri në vitin 2010. Në teori, rritja e të ardhurave tatimore pritet të rrisë produktin e brendshëm bruto. Në këtë hulumtim janë shfrytëzuar tri qasje për të përmbushur objektivin e studimit. Metoda e parë përfshinte një model regresioni linear klasik bazuar në metodën e vlerësimit OLS. Metoda e dytë përdorte testin e ko integritetit, ndërsa metoda e tretë përfshinte kryerjen e testit të shkakësisë të granger në të gjitha variabëlët. Rezultatet e studimit zbuluan një marrëdhënie pozitive midis rritjes ekonomike dhe të ardhurave tatimore. Të gjitha variabëlët tatimore; tatimi mbi të ardhurat, detyrimet e importit, akcizat dhe tatimi mbi shitjet / TVSH treguan një efekt pozitiv në BPV me tatimin mbi të ardhurat që paraqet efektin më të lartë pasuar nga tatimi në shitje / TVSH, pastaj akcizat dhe më në fund detyrimet e importit që tregojnë efektin më të vogël. Ko integrimi zbuloi se ka më së shumti një ekuacion ko integruese, ndërkohë që prova Granger Causality tregoi një marrëdhënie të dyanshme midis rritjes ekonomike dhe akcizave; një marrëdhënie uni-direktive midis tatimit mbi të ardhurat dhe rritjes ekonomike, dhe rritjes ekonomike dhe taksës së shitjes / TVSH; megjithatë, nuk ekzistonte asnjë shkak ndërmjet rritjes ekonomike dhe detyrimeve të importit. Këto rezultate sugjerojnë se qeveria duhet të heqë dorë nga përqendrimi në rritjen e të ardhurave tatimore duke rritur nivelet e taksave, por në vend të kësaj përdor një strukturë tatimore që rrit bazën tatimore duke përmirësuar kështu normën e rritjes. Përveç kësaj, qeveria duhet të shfrytëzojë marrëdhënien pozitive midis tatimit dhe rritjes ekonomike për të realizuar shpenzime efikase të investimeve qeveritare që rritin rritjen duke rritur nivelet e të ardhurave.

Ahmad, Sial dhe Ahmad (2016) në punimin e tyre hulumtuan marrëdhënien në mes të ardhurave tatimore gjithsej dhe rritjen ekonomike në Pakistan. Ata për vlerësim përdorën të dhënat vjetore nga viti 1974 deri në vitin 2010. Qëllimi kryesor i hulumtimit është

gjetja e marrëdhënieve afatgjata dhe afatshkurtra në mes të të ardhurave të përgjithshme tatimore dhe rritjes ekonomike. Auto Regressive Distributed Lag (ARDL) kufizon qasjen e testimit për bashkë integrimin, është aplikuar për të vlerësuar marrëdhënien afatgjatë dhe afatshkurtër, midis variabëlilit. Të ardhurat totale tatimore kanë efekt negativ dhe të rëndësishëm në rritjen ekonomike në afat të gjatë. Për shkak të rritjes prej një për qind në total taksat, rritja ekonomike do të ulte me -1.25 për qind. ECM koeficienti i taksave totale tregon 51 për qind shpejtësinë e rregullimit në atë vit. Sipas rezultateve të hulumtimit, është e domosdoshme të zvogëlohen taksat indirekte dhe për të rritur taksat e drejtpërdrejta, nëse duam të shtojmë rritje ekonomike. Aktualisht kontributi i taksave të drejtpërdrejta, tërësisht të ardhurat tatimore, është vetëm 33 për qind dhe pjesa e taksave të tërthorta është 63 për qind, ndërkohë që duhet të përmbysset, nëse rritja ekonomike ka për të rritur.

Hulumtuesi Nantob (2014) ka hulumtuar efektet e rritjes së taksave mbi rritjen ekonomike të tetë vendeve të WAEMU. Ndër kritikën që i drejtohen sektorit publik, shumë janë ato që i referohen kryesisht efekteve negative të cilat kanë rëndësi të madhe dhe rritjen e taksave. Shkalla e rritjes mund të ndikohet nga zgjedhja e politikës ekonomike në raport me tatimin që ka ndikim në vendimet e agjentëve ekonomikë dhe është rezultat i shpenzimeve publike produktive. Arsyeja është se niveli i lartë i tatimit mund të jetë i shtrembëruar dhe si kjo ndikon negativisht në rritjen ekonomike, ndërkohë që pesha ligjore e tatimit mund të krijojë disa kthime që do të mbyllen në prodhim. Për të kapur këtë fenomen në vendet e WAEMU-së, ai ka kundërshtuar studimet e mëhershme që përbënin një efekt jo linear të tatimit mbi rritjen ekonomike. Duke mobilizuar një specifikim dinamik të të dhënave panel gjatë periudhës 1989-2012, rezultatet ekonometrike sugjerojnë mungesën e një marrëdhënie jo lineare midis tatimit dhe rritjes

ekonomike të WAEMU. Në mënyrë të veçantë, normat e dobëta dhe të larta, respektivisht afatshkurtër dhe afatgjatë, nuk krijojnë shtrembërime dhe kështu ndikojnë pozitivisht në rritjen ekonomike të UEMOA dhe gjenerojë të ardhura. Ky efekt në rritjen ekonomike pastaj rritet me kalimin e kohës, ndërsa rritja e të ardhurave fiskale.

Gjetjet e studiuesit nigerian Garba (2014) kontribuojnë në një kuptim më të mirë të të ardhurave tatimore dhe rritjes ekonomike në Nigeri. BPV dhe katër variabla të tjerë që përfaqësojnë tatimin mbi fitimin e naftës, tatimin mbi të ardhurat e kompanisë, taksat doganore dhe akcizat, dhe tatimi mbi vlerën e shtuar janë zhvilluar për të provuar faktorët që përshkruajnë më mirë rritjen ekonomike në Nigeri. Rezultati tregon se tatimi mbi fitimin e naftës, tatimi mbi të ardhurat e kompanisë, taksat doganore dhe akciza dhe tatimi mbi vlerën e shtuar janë variabla të rëndësishëm në shpjegimin e rritjes ekonomike në Nigeri. Nga të katër variabëlët e pavarur, janë vetëm doganat dhe akcizat që tregojnë një marrëdhënie negative me rritjen ekonomike, gjë që nënkupton që ata të dy po lëvizin në drejtim të kundërt. Tre ndryshoret e pavarur tregojnë një marrëdhënie pozitive me rritjen ekonomike. Një nga qëllimet kryesore të të ardhurave tatimore është rritja e të ardhurave që qeveria mund të përdorë për të ofruar pajisje dhe infrastrukturë adekuate për qytetarët e saj, si dhe për të rritur rritjen, por rasti duket të jetë i ndryshëm në Nigeri, pasi që dëshmitë fizike nuk tregojnë se fondet e krijuara nga të ardhurat tatimore janë përdorur për këtë qëllim. Analiza ka hedhur dritë mbi ndikimin e të ardhurave tatimore në ekonominë e Nigerisë. Është e qartë se të ardhurat totale të taksave nigeriane të gjeneruara kanë një ndikim të rëndësishëm në ekonominë në përgjithësi. Në bazë të gjeturave nga hulumtues të ndryshëm me metodën ekonometrike të analizës, ne kemi mbështetur hulumtimin tonë dhe në kapitullin vijues (kapitulli 4), ku kemi prezantuar të gjeturat tona duke përdorur të dhënat serike mbi të ardhurat publike të ndara sipas burimit në të ardhura

nga tatimet, të ardhurat nga jo tatimet dhe të ardhurat nga grandet. Këto të dhëna janë marrë nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare dhe janë prezantuar mbi bazën e raportimeve tremujore.

KAPITULLI IV: ANALIZA EMPIRIKE E TË ARDHURAVE PUBLIKE ME RITJEN EKONOMIKE

4.1. Analiza përshkruese e të ardhurave publike në Kosovë

Për ta kompletuar sa më mirë studimin mbi efektin e të hyrave publike në rritjen ekonomike të Kosovës, ne në fillim kemi aplikuar analizën statistikore të mbledhjes së të ardhurave publike. Në këtë pjesë do të ketë një përshkrim të mjaftueshëm të llojeve të ardhurave publike në Kosovë nga viti 2004- 2016, duke përfshirë informacione që kanë të bëjnë me momentet e ndryshimeve që kanë ndodhur në politikën fiskale dhe tatimore, zhvillimin e tyre që nga pas lufta e vitit 1999, uljen dhe rritjen e tyre në periudha të caktuara kohore. Gjithashtu në këtë pjesë të analizës janë paraqitur edhe krahasimet e trendëve të të ardhurave publike të Kosovës me vendet e rajonit duke përdorë dy tregues: treguesi social që shprehet përmes krahasimit të të ardhurave të mbledhura me frymë popullsie dhe treguesi ekonomik që shpreh raportin e të ardhurave publike me PBB-në. Analiza është bërë mbi bazën e raportimeve vjetore dhe tremujore të mbledhjes së të ardhurave publike në Kosovë nga viti 2004 deri në vitin 2016 nga Ministria e Financave të Kosovës.

4.1.1. Një vështrim i përgjithshëm rreth sistemit dhe politikës fiskale në Kosovë

Para se ta shqyrtojmë strukturën e të ardhurave në Kosovë është e rëndësishme të kemi një pamje rreth zhvillimeve të sistemit fiskal dhe tatimor që nga përfundimi i luftës në vitin 1999 në Kosovë. Sipas autorëve (Badivuku- Pantina, M dhe Maloku, E., 2012), Kosova në sajë të instrumenteve të politikës fiskale ka krijuar të ardhura publike, përkatësisht mjete buxhetore nga burimet vetanake. Kosova ka zhvilluar një sistem fiskal të bazuar në përvojat dhe politikat më të mira të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të

ketë politika fiskale dhe legjislacion sa më të përshtatshëm me atë të BE-së. Sistemi aktual tatimor në Kosovë është dizajnuar të jetë i thjeshtë, si për biznese ashtu edhe për administrimin e tyre. Politika dhe sistemi fiskal në Kosovë e ka zanafillën e vet të mirëfilltë menjëherë pas përfundimit të luftës në vitin 1999. Menjëherë pas çlirimit të Kosovës u instalua misioni i Kombeve të Bashkuara i ashtuquajtur si UNMIK. Ky mision kishte përgjegjësi për qeverisjen e vendit. Kosova nga lufta doli e shkatërruar ekonomikisht, pa ndonjë një sistem fiskal, dhe ai që duhej të ndërmernte masa për themelimin e tij ishte UNMIK-u, kështu që më 25 qershor të vitit 1999, kryeadministratori i parë i Kosovës ka aprovuar Rregulloren nr. 1999/1. Kjo rregullore është akti më i lartë legjislativ në Kosovën e pasluftës me të cilën rregullohen çështjet e pasurive shtetërore, financave, bankave etj. Dokumenti i dytë me rëndësi për sistemin fiskal në Kosovë është nxjerrja nga PSSP-ja, rregullorja nr. 1999/16 mbi themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal (AQF). Ndër rregulloret e para të nxjerra nga Përfaqësuesi Special i OKB-së për Kosovën është edhe ajo mbi themelimin e doganave dhe shërbimeve tjera gjegjëse në Kosovë. Me aprovimin e Rregullores mbi akcizën dhe Rregulloren mbi taksen e shitjes fillon të funksionojë shërbimi doganor dhe pagesa e taksës dhe të akcizës në importimin e mallrave si një ndër segmentet më të rëndësishme në ndërtimin e sistemit fiskal të Kosovës dhe të institucionalizimit dhe konsolidimit të buxhetit të Kosovës.

Politika fiskale në Kosovë ka vazhduar të reformohet dhe kjo ka mundësuar të sigurohet një bazë e mjaftueshme dhe e shëndoshë e të ardhurave buxhetore. Kjo politikë e formimit të të ardhurave publike është arritur përmes ndryshimit të sistemit tatimor, rritjes së bazës tatimore dhe implementimit të politikave të matura fiskale. Në këtë kontekst, qeveria e Kosovës ndërmarr disa reforma më të thella tatimore, siç është ajo e vitit 2009 dhe e 2015.

Nga janari 2009, shkalla e tatimit në të ardhurat e korporatave në Kosovë është zbritur nga 20% në 10% dhe nga 1 janari 2010, Qeveria e Kosovës me anë të ligjit të ri për Tatimin e të Ardhurave nga Korporatat ka larguar tatimin në dividendë të marrur nga tatimpaguesit rezident dhe jorezident. Kjo reformë ka rezultuar me arritjen e një qëndrueshmërie fiskale duke siguruar të ardhura të mjaftueshme në mbulimin e shpenzimeve publike në buxhetin e Kosovës. Në arritjen e kësaj qëndrueshmërie buxhetore ka ndikuar edhe rritja e fuqizimit të dy institucioneve përgjegjëse të cilat merren me mbledhjen e tyre, siç janë: Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës.

Duke u nisur nga faktet e prezantuara më lartë, funksionimi i sistemit tatimor në Kosovë në përgjithësi bazohet në mbledhjen e të ardhurave publike të cilat përbëhen nga tri burime: të ardhurat tatimore, të ardhurat jotatimore dhe të ardhurat nga donatorët (grandet). Duke iu referuar tabelës 4.1, vërejmë se ecuria (trendet) e rritjes së të ardhurave publike në Kosovë kanë qenë mjaft pozitive nga viti në vit, me përjashtim të vitit 2013 ku kemi pasur një ulje të lehtë të të ardhurave. Një ndër momentet më të rëndësishme në zhvillimin e politikës tatimore dhe fiskale në Kosovë ka qenë edhe ajo e vitit 2015, kur qeveria e Kosovës ka marrur disa vendime të cilat kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve publike (rritja e pagave të punësuarve publik me 25% dhe rritja e investimeve publike siç është ndërtimi i autostradave) të cilat kanë vënë në rrezik stabilitetin financiar të vendit.

Duke u gjendur para një sfide të tillë, qeveria e Kosovës me sugjerimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, në vitin 2015, ndërmorri një reformë tatimore duke bërë ndryshimin e ligjeve të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), tatimit në të ardhurat e korporatave (TAK) dhe tatimit në të ardhurat personale (TAP). Ndryshimet më të mëdha sa i përket ligjeve kanë ndodhur tek ligji për tatimin e vlerës së shtuar (TVSH), ku ulet pragu i

TVSH-së nga 50 mijë euro sa ishte në ligjin paraprak në 30 mijë euro. Pra, çdo biznes, i cili realizon qarkullim mbi 30 mijë euro brenda vitit, detyrohet të regjistrohet për TVSH. Me ligjin e ri, norma e TVSH-së u rrit nga 16% në 18%, por që në disa produkte bazike kjo normë u ul 8% dhe në disa tjera u hoq fare si rezultat i marrjes së vendimit për përshkallëzimit të TVSH-së. Poashtu, qeveria e Kosovës ndryshoi edhe ligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave (TAK) dhe tatimit në të ardhurat personale (TAP) duke rikthyer tatimin mbi Dividendin. Ndërmarrja e kësaj reforme në Kosovë i dha frutat e saja dhe më pas trendi i rritjes vazhdoi me një ritëm mjaft të lartë pozitiv, kështu që në vitin 2015 dhe 2016 kemi një rritje të mirë të të ardhurave tatimore mesatarisht rreth 9% në vit (tabela 4.1 dhe tabela 4.6). Rritje ka pasur në të gjitha llojet e tatimeve si: tatimi në të ardhura ku përbëhet prej tatimit në të ardhura personale dhe tatimit në të ardhura të korporatave (2015= 6.43% dhe 2016= 16.14%, Shtojca, tabela A4); Tatimin Vlerës e Shtuar (2015= 9.34% dhe 2016= 14.22%, Shtojca, tabela A4); Të ardhurat nga Detyrimi Doganor (2015= 4.01% dhe 2016= -1.08%, Shtojca, tabela A4); Të ardhurat nga Akciza (2015= 14.33% dhe 2016= 11.83%, Shtojca, tabela A4). Pra, siç shihet në rritjen e të ardhurave publike ka ndikuar reforma tatimore që ka ndërmarrur qeveria e vendit.

Falë zhvillimit ekonomik, mjetet buxhetore janë rritur për çdo vit buxhetor ashtu siç janë prezantuar në tabelën 4.1, që shpreh efikasitetin e qeverisë në kryerjen e obligimeve të përgjithshme dhe të përbashkëta ndaj qytetarëve dhe avancimin në investime kapitale.

Pika kulminante në rritjen e të ardhurave publike në Kosovë është arritur me nxjerrjen e ligjit për faljen e borxheve publike në vitin 2016, me ç'rast viti 2016 është viti më i suksesshëm në mbledhjen e të ardhurave publike në Kosovë, që nga pas lufta, me ç'rast qeveria e Kosovës ka realizuar të ardhura publike në vlerë prej 1,601.951 milion euro (tabela 4.1).

Tabela 4.1 Të ardhurat publike në Kosovë (2004-2016)

PERIUDHA	TË ARHURAT TATIMORE	TË ARDHURAT JO TATIMORE	TË ARDHURTAT NGA GRANDET	TË ARDHURAT GJITHSEJ
2004	533.200	69.070	14.099	616.369
2005	553.307	74.910	11.231	639.448
2006	628.852	83.160	19.563	731.575
2007	722.434	180.565	11.643	914.641
2008	817.747	124.778	12.845	955.370
2009	827.242	319.575	13.880	1,160.697
2010	907.014	219.481	45.342	1,171.837
2011	1,072.316	206.695	28.208	1,307.220
2012	1,108.523	175.843	48.732	1,333.098
2013	1,120.962	191.607	12.588	1,325.157
2014	1,161.568	171.252	12.092	1,344.912
2015	1,268.735	188.084	13.310	1,470.130
2016	1,423.267	175.343	3.340	1,601.950

Burimi: Ministria e Financave e Kosovës

Nga tabela 4.1, kemi vërejtur se të ardhurat tatimore janë të ardhurat kryesore të qeverisë së Kosovës të cilat përbëjnë rreth 86,51% e të ardhurave publike në vitin 2004 dhe 88.85% në vitin 2016 (Shtojca, tabela A2) dhe të njëjta kanë pasur rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Edhe të ardhurat jotatimore janë të ardhura të rëndësishme të qeverisë, ato përbëjnë rreth në vitin 2004= 11.21% dhe 2016= 10.95% (Shtojca, tabela A2) të të ardhurave të përgjithshme. Këto të ardhura, siç vërehen në tabelen 4.1, kanë pësuar rënie apo ngelin në nivelin e përafërt nga viti në vit. Kjo tregon se qeveria Kosovës është e angazhuar që të ardhurat tatimore të rriten vazhdimisht sepse një veprim i tillë shpie në rritjen ekonomike të vendit.

4.1.2. Struktura e të ardhurave në Kosovë

Struktura e sistemit tatimor të Kosovës është shumë e orientuar drejt tatimeve indirekte (tatimi në vlerën e shtuar, detyrimi doganor, akciza), ashtu si në Bosnjë dhe Hercegovinë,

Kroaci, Mal të Zi dhe Serbi, me më shumë se 80 përqind të të ardhurave nga tatimet që vijnë nga i njëjti burim (IMF, Country Report No. 223, Republic of Kosovo 2013, 2014). Ndërsa po e krahasojmë me PBB-në, të ardhurat nga tatimet indirekte përbëjnë mesatarisht në vjet rreth 17.69% (tabela 4.2).

Tabela 4.2. Të ardhurat tatimore direkte dhe indirekte në Kosovë (2004-2016)

PERIUDHA	Tatimet direkte	TD/ TGJ	Tatimet indirekte	TID/ TGJ	Tatimet Gjithsej	PBB	TD/ PBB	TID/ PBB
2004	69.399	13.02	463.800	86.98	533.199	2,912.000	2.38	15.93
2005	82.690	14.94	470.620	85.06	553.310	3,003.000	2.75	15.67
2006	127.986	20.35	500.866	79.65	628.852	3,120.000	4.10	16.05
2007	144.766	20.04	577.667	79.96	722.434	3,461.000	4.18	16.69
2008	176.468	21.58	641.279	78.42	817.747	3,882.800	4.54	16.52
2009	168.752	20.40	658.491	79.60	827.242	4,069.600	4.15	16.18
2010	140.203	15.46	766.811	84.54	907.014	4,401.300	3.19	17.42
2011	154.822	14.44	917.494	85.56	1,072.316	4,814.500	3.22	19.06
2012	169.236	15.27	939.287	84.73	1,108.523	5,058.800	3.35	18.57
2013	175.574	15.66	945.389	84.34	1,120.962	5,326.600	3.30	17.75
2014	189.903	16.35	971.665	83.65	1,161.568	5,485.000	3.46	17.71
2015	199.447	15.72	1,069.288	84.28	1,268.735	5,771.500	3.46	18.53
2016	232.121	16.31	1,191.146	83.69	1,423.267	5,863.000	3.96	20.32
	2,031.367	16.73	10,113.803	83.27	12,145.171	57,169.100	3.55	17.69

Burimi: Ministria e Financave

Në të kundërt, kontributi i tatimeve direkte (përfshirë tatimin në të ardhura dhe tatimi mbi pronën), është rreth gjysma e mesatares rajonale. Pjesëmarrja e të ardhurave të tatimeve direkte në raport me të ardhurat gjithsej përbën rreth 16.73% të tatimeve (tabela 4.2). Kjo strukturë e të ardhurave publike është e përafërt me natyrën e ekonomisë së Kosovës.

Për ta prezantuar pjesëmarrjen e të ardhurave sipas llojeve në totalin e të ardhurave publike për vitin 2004-2016 është prezantuar figura 4.1. E ardhura kryesore në buxhetin e Kosovës për periudhën 2004-2016 është: tatimi i vlerës së shtuar 5,440.00 milion € ose 37,33% e të ardhurave gjithsej, akciza = 3,246,07 milion € ose 22.28%, detyrimet

doganore = 1,392.36 milion € ose 9.56%, të ardhurat jotatimore = 2,180.37 milion € ose 14.96%, tatimi në fitim 970.58 milion € ose 12.21%, të ardhurat nga grandet 246.69 milion € ose 1.69% dhe të ardhurat tjera = 287.05 milion € ose 1.97% (grafiku 4.1). Nga kjo që u tha më lartë shihet se të ardhura kryesore të qeverisë së Kosovës në këtë periudhë ishte TVSH-ja (37.66%) dhe Akciza (22.28%).

Duke u nisur nga argumenti se të ardhurat tatimore përbëjnë të ardhurën kryesore në periudhën e hulumtuar (88.85%, Shtojca, tabela A2), atëherë mund të themi se të ardhurat nga tatimet kanë luajtur rol dhe mbesin të një rëndësie të veçantë, si nga aspekti i mbledhjes së ardhurave buxhetore, ashtu edhe sa i përket pjesëmarrjes në PBB (24.28%, Shtojca, tabela A7). Pra ky është një indikator mjaft i rëndësishëm në rritjen e ekonomike të vendit.

Figura 4.1 Struktura e të ardhurave publike (2004-2016)





Figura 4.2 Të ardhurat publike në Kosovë sipas burimit të mjeteve (2004-2016)



Burimi: Ministria e Financave të Republikës së Kosovës

Për qëllim të këtij hulumtimi më poshtë është prezantuar tabela 4.3 e të ardhurve (sipas llojeve) të mbledhura nga qeveria e Kosovës nga viti 2004-2016.

Tabela 4.3 Struktura e të ardhurave publike tremujore (2004-2016)

PERIUDHA	TË ARDHURAT TATIMORE					TË ARDHURAT JO TATIMORE		TË ARDHURAT NGA GRANDET	
	TA	TVSH	DD	AA	TTJ	ATJQQ	ATJQL	ATJTJ	TAG
TM1 2004	11.930	34.060	20.050	42.920	-	9.680	4.220	-	-
TM2 2004	13.222	52.483	23.395	45.640	-	11.620	5.850	-	-
TM3 2004	18.563	70.820	10.567	44.250	-	3.250	4.350	-	-
TM4 2004	20.665	56.907	19.548	43.160	5.020	21.350	8.750	-	14.099
2004	64.380	214.270	73.560	175.970	5.020	45.900	23.170	-	14.099
TM1 2005	14.940	39.110	14.030	41.920	-	9.650	4.950	-	2.940
TM2 2005	15.950	58.280	18.430	44.700	-	12.610	6.700	-	2.630
TM3 2005	24.140	74.370	19.000	39.570	-	3.070	6.250	-	3.270
TM4 2005	22.965	59.719	23.367	38.124	4.692	21.000	10.680	-	2.391
2005	77.995	231.479	74.827	164.314	4.692	46.330	28.580	-	11.231
TM1 2006	16.331	27.793	18.915	21.131	48.689	(3.004)	3.855	-	1.020
TM2 2006	21.762	51.864	27.970	27.123	66.825	(6.052)	4.806	-	3.220
TM3 2006	51.844	66.775	38.560	37.751	27.088	(35.226)	4.573	-	7.920
TM4 2006	24.168	107.762	38.837	29.263	(121.598)	108.068	6.140	-	7.403
2006	114.105	254.194	124.282	115.268		63.786	19.374	-	19.563
TM1 2007	18.595	58.377	17.302	42.017	9.771	98.080	4.791	-	2.490
TM2 2007	28.321	69.682	20.204	43.852	11.935	18.180	5.106	-	2.010
TM3 2007	33.532	81.126	20.137	55.228	12.141	17.870	6.013	-	5.340

TM4 2007	46.297	93.170	23.565	50.287	(13.106)	25.498	5.027	-	1.803
2007	126.745	302.355	81.208	191.384	20.742	159.628	20.937	-	11.643
TM1 2008	27.492	58.216	15.980	36.648	2.175	25.680	5.189	-	3.050
TM2 2008	44.025	84.402	24.003	52.394	4.962	20.226	6.871	-	1.840
TM3 2008	36.408	93.985	25.539	54.856	5.982	24.333	9.681	-	-
TM4 2008	53.949	104.456	27.832	59.414	5.029	24.471	8.326	-	7.955
2008	161.874	341.060	93.355	203.311	18.148	94.711	30.067	-	12.845
TM1 2009	33.484	54.058	14.761	26.814	32.148	20.251	6.089	-	2.640
TM2 2009	28.925	92.940	25.119	50.559	4.787	21.582	8.568	-	0.720
TM3 2009	24.743	100.732	25.969	65.645	3.545	24.619	8.213	-	6.600
TM4 2009	39.445	117.014	28.676	53.969	3.909	21.809	8.444	200.000	3.920
2009	126.597	364.743	94.525	196.988	44.389	88.261	31.314	200.000	13.880
TM1 2010	30.038	71.387	18.248	41.431	2.742	27.333	7.148	1.418	4.330
TM2 2010	31.498	111.672	27.279	51.152	4.590	18.268	7.817	81.469	5.820
TM3 2010	28.515	130.920	29.312	74.425	8.369	25.739	8.712	6.844	5.160
TM4 2010	33.992	112.669	29.030	63.640	6.104	22.206	9.052	3.474	30.032
2010	124.044	426.648	103.868	230.648	21.806	93.546	32.729	93.205	45.342
TM1 2011	34.017	94.499	21.644	52.684	3.836	23.022	7.329	6.874	1.930
TM2 2011	32.737	127.569	29.035	68.179	4.793	21.958	9.538	41.450	2.880
TM3 2011	33.781	146.668	34.439	86.737	5.220	20.710	9.395	16.972	2.910
TM4 2011	37.258	141.301	36.094	76.955	4.870	36.337	9.141	3.971	20.488
2011	137.792	510.037	121.211	284.555	18.721	102.026	35.403	69.267	28.208

TM1 2012	32.473	96.947	20.382	49.255	3.296	21.330	9.170	17.158	4.780
TM2 2012	37.639	128.612	31.099	71.909	5.487	19.181	9.597	11.812	3.230
TM3 2012	34.495	152.774	33.270	88.991	5.015	19.462	10.895	11.811	4.960
TM4 2012	46.193	135.717	32.971	93.048	8.952	21.748	11.573	12.106	35.762
2012	150.800	514.050	117.721	303.202	22.750	81.721	41.235	52.887	48.732
TM1 2013	35.773	103.763	21.957	50.257	5.034	23.189	8.458	22.109	3.090
TM2 2013	41.354	133.359	30.239	74.735	6.436	20.145	9.390	18.323	2.560
TM3 2013	38.478	147.190	33.528	95.301	6.124	18.937	8.824	11.117	5.590
TM4 2013	39.084	137.773	34.404	80.756	5.417	23.591	9.381	18.143	1.348
2013	154.689	522.085	120.128	301.050	23.011	85.862	36.053	69.692	12.588
TM1 2014	39.002	105.684	23.714	61.312	6.360	22.861	6.520	7.630	3.080
TM2 2014	43.223	131.048	32.968	73.430	7.049	24.800	9.392	7.704	1.630
TM3 2014	40.313	147.845	34.840	93.047	6.948	22.182	8.008	7.940	4.950
TM4 2014	43.142	141.899	34.801	87.648	7.294	22.534	8.122	23.558	2.432
2014	165.680	526.476	126.323	315.437	27.651	92.378	32.041	46.832	12.092
TM1 2015	43.255	111.435	24.603	63.062	5.981	22.051	6.677	8.428	3.830
TM2 2015	47.324	139.351	34.239	84.340	5.815	21.735	9.142	18.492	0.820
TM3 2015	41.396	160.282	36.416	110.360	5.892	21.035	8.605	9.484	4.720
TM4 2015	44.362	164.597	36.133	102.871	7.022	38.912	8.695	14.829	3.940
2015	176.336	575.664	131.391	360.633	24.711	103.733	33.119	51.233	13.310
TM1 2016	47.983	126.765	28.503	81.715	5.284	21.939	7.909	9.173	1.410
TM2 2016	54.465	160.848	34.049	94.264	7.058	24.338	11.054	8.634	1.930

TM3 2016	53.925	194.695	33.928	123.419	10.134	23.324	10.941	9.904	-
TM4 2016	48.427	175.200	33.489	103.898	5.219	22.775	14.824	10.526	-
2016	204.799	657.508	129.970	403.296	27.694	92.377	44.728	38.237	3.340

4.1.3. Trendët e të ardhurave publike në Kosovë 2004-2016

Është parë me interes studimi i të ardhurat publike në Kosovë gjatë periudhës 2004-2016, në funksion të interpretimit të rezultateve të përpunimit statistikor por edhe për të ofruar një tregues të zakonshëm ekonomik, siç është trendi i zhvillimit ndër vite. Kjo periudhë përkon me periudhën në të cilën ne mundëm të siguronim të dhëna të plota për të tre treguesit e të ardhurve si dhe PBB-n. Më poshtë kemi prezantuar trendin individual dhe krahasuese ndër vite për këta tregues.

Tabela 4.4 Të ardhurat vjetore (2004-2016) për TAT, TAJT, TAG dhe TAGJ (norma e rritjes)

PERIUDHA	TAT	TAJT	TAG	TAGJ
2004	-	-	-	-
2005	3.77	8.46	(20.34)	3.74
2006	13.65	11.01	74.19	14.41
2007	14.88	117.13	(40.48)	25.02
2008	13.19	(30.90)	10.32	4.45
2009	1.16	156.11	8.06	21.49
2010	9.64	(31.32)	226.67	0.96
2011	18.22	(5.83)	(37.79)	11.55
2012	3.38	(14.93)	72.76	1.98
2013	1.12	8.96	(74.17)	(0.60)
2014	3.62	(10.62)	(3.94)	1.49
2015	9.23	9.83	10.07	9.31
2016	12.18	(6.77)	(74.91)	8.97

Burimi: Ministria e Financave


Të ardhurat jotatimore për periudhën 2004-2016 në përgjithësi paraqesin një rritje jo të qëndrueshme (Figura 4.3, grafiku majtas-lartë). Duke krahasuar fillimin e periudhës të studimit (2004) me mbarimin e saj (2006), vihet re se të ardhurat jotatimore janë

pothuajse trefishuar. Por, nga viti në vit ato nuk ruajnë qëndrueshmërinë rritëse. Kjo paqëndrueshmëri kulmon në vitin 2009 kur kemi një realizim të ardhurash jotatimore (TAJT=319.575, Tabela x.1, shtojca) në nivele pothuajse sa dyfishi i mesatares vjetore për këto vite (Mean=167.270, Tabela x.1, shtojca). Në këtë rritje të të ardhurave jotatimore ka ndikuar marrja e dividendës nga Posta dhe Telekomit i Kosovës në vlerë prej 200 milion euro (e ardhur e njëhershme).

Të ardhurat nga grandet (TAG), për nga vet natyra e tyre, janë të ardhurat me shpërndarjen më të paqëndrueshme në kohë. Nga grafiku (Figura 4.3, grafiku djathtas-lartë) vihet re se në periudhën 2004-2009 vërehen të ardhurat nga grandet e huaja në vlera brenda intervalit 10 milion-15 milion euro, por në vitin 2006, kemi një injektim të ardhurash nga grandet e huaja i cili i kapërcen këto vlera. Duke arritur në gati 20 milion euro. Ky fluks më i madh i të ardhurave nga grandet ka qenë për shkak të implementimit të disa projekteve nga disa shtete dhe agjensi të huaja në sferën e arsimit, administratës publike dhe shëndetësisë. Donatorët më të mëdhenjë që kanë ndikuar në rritjen e këtyre të ardhurave janë: Banka Botërore, UNDP-ja, USA, EAR dhe donatorë tjerë. Në periudhën pasardhëse (2010-2012) vërehet një injektim në grandet e huaja në nivele relativisht të larta, të cilat kulmojnë në vitin 2010 (45.342.000 euro, Tabela 4.3) dhe vitin 2012 (48.732.000 euro, Tabela 4.3). Krahasuar me periudhën paraardhëse, viti 2011, gjithashtu shoqërohet me një injektim në grandet e huaja në nivele të konsiderueshme (28.208.000 euro). Në rritjen e të ardhurave nga grandet në vitin 2010 ka ndikuar pranimi i një shumë prej 30 milion euro si mbështetje e buxhetit nga Komisioni Evropian. Edhe në vitin 2011, buxhetin e ka përkrahur edhe Banka Botërore me 19.24 milion euro. I njëjti institucion ka përkrahur buxhetin edhe në vitin 2012 me 37,417 milion euro. Periudha pasardhëse (2013-2015) shoqërohet me rikthim në nivelet brenda intervalit 10

milion-15 milion euro të të ardhurave nga grandet e huaja. Viti 2016 ka realizimin më të ulët të të ardhurave nga grandet e huaja (TAG=3.340.000 euro, Tabela x.1, shtojca).

Figura 4.3 Trendi vjetor i të ardhurave publike në Kosovë (2004-2016)




Të ardhurat tatimore në periudhën 2004-2016 paraqesin një trend gjithmonë në rritje (Figura 4.3, Grafiku majtas-poshtë) por me dy periudha stanjacioni (2009 dhe 2012-2014). Është fakt se të ardhurat nga tatimet gati janë trefishuar gjatë kësaj periudhe që ne kemi marrë në studim, (Minimum = 533.200.000 dhe Maximum = 1.423.267.000, Tabela x.1 shtojca).

Interesant është fakti se të ardhurat gjithsej gëzojnë një trend rritës gjatë kësaj periudhe (2004-2016), me tre momente stanjacioni (Figura 4.3, Grafiku djathtas-poshtë) të cilat u përkasin viteve 2007, 2010 dhe 2012-2014). Duke parë luhatshmërinë e lartë që kanë dy nga faktorët e të ardhurave publike, të ardhurat jotatimore dhe të ardhurat nga grandet e huaja dhe mosreflektimi i kësaj luhatshmërinë në të ardhurat gjithsej, e bën me interes

studimin krahasimor të faktorëve të cilët përcaktojnë të ardhurat publike në Kosovë (Figura 4.4).

Figura 4.4 Krahasimi i trendëve sipas zërave të të ardhurave vjetore (2004-2015)



Vrojtimi i trendeve të tre faktorëve përcaktues të nivelit të të ardhurave publike dhe krahasimi i tyre me trendin e të ardhurave gjithsej, tregon se të ardhurat nga grandet nuk kanë ndikuar dukshëm në trendin e të ardhurave gjithsej, pavarësisht trendit të tyre dukshëm të paqëndrueshëm gjatë periudhës 2004-2016. Kjo vjen si rezultat i peshës relativisht të ulët të vlerave të të ardhurave nga grandet në krahasim me vlerat reale të të ardhurave gjithsej, prandaj është i nevojshëm një studim më i thelluar i ndikimit të mundshëm të këtij faktori në të ardhurat publike të Kosovës. Ndryshe ndodh me luhatshmërinë e të ardhurave jotatimore, të cilat ndikojnë ndjeshëm në trendin e të ardhurave gjithsej. Kështu, në vitin 2007, ndryshimi pozitiv i trendit të tyre është reflektuar në një ndryshim pozitiv (rritës) të trendit të të ardhurave gjithsej, ndërkohë që trendi i dy të ardhurave të tjera (tatimore dhe nga grandet) janë konstant. Në vitin 2009 ky fenomen përsëritet akoma më ndjeshëm. Në pjesën tjetër të periudhës 2004-2016, trendi i të ardhurave gjithsej pothuajse është i njëjtë me trendin e të ardhurave tatimore.

Tabela 4.5 Të ardhurat vjetore në raport me popullsinë për vendet e rajonit (2005-2015)

PERIUDHA	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
KOSOVE	0.37	0.42	0.52	0.54	0.65	0.66	0.73	0.73	0.72	0.73	0.81
SHQIPERI	0.43	0.49	0.57	0.66	0.61	0.66	0.67	0.66	0.63	0.72	0.77
BULLGARI	0.76	0.83	1.15	1.33	1.14	1.14	1.21	1.30	1.35	1.40	1.53
KROACI	2.18	2.41	2.73	2.91	2.65	2.64	2.67	2.75	2.73	2.78	3.38
GREQI	4.32	4.62	5.05	5.28	5.04	4.95	4.88	4.83	4.60	4.65	4.66
HUNGARI	2.59	2.84	3.13	3.18	3.18	3.19	2.81	3.30	3.47	3.54	3.88
MAQEDONI	0.57	0.55	0.66	0.83	0.76	0.72	0.77	0.79	0.83	0.81	0.89
SERBI	0.85	1.05	1.22	1.25	1.17	1.16	1.25	1.25	1.27	1.28	1.37
RUMANI	0.74	1.00	1.22	1.34	1.16	1.24	1.42	1.44	1.53	1.59	1.78
BOS-HERC	0.74	0.74	0.74	0.74	0.74	0.74	0.74	0.74	0.74	0.74	0.74


Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar

Në qëllim të ndërtimit të një ikone më të plotë të trendit të të ardhurave publike të Kosovës, në studimin tonë kemi përfshirë krahasimin e trendit të të ardhurave publike të Kosovës me rajonin. Këtë krahasim e kemi mbështetur në dy tregues: (i) të ardhurat publike në raport me popullsinë si një tregues social dhe (ii) të ardhurat publike në raport me PBB-n si një tregues ekonomik. Për arsye të pamundësisë për të siguruar të dhëna rajonale për këta tregues për periudhën 2004-2016, krahasimi është mbështetur në të dhëna për periudhën 2005-2015, gjë e cila nuk e cenon qëllimin.

Grafiku i paraqitur në Figurën 4.5 tregon se Kosova është ndër vendet me të ardhurat më të ulëta për frymë të popullsisë. Gjatë gjithë periudhës 2005-2015 Kosova së bashku me Bosnjë-Hercegovinën, Shqipërinë dhe Maqedoninë bën pjesë ndër vendet e rajonit të cilat edhe pse kanë njohur një rritje të këtij treguesi, s'kanë mundur të kapërcejnë pragun e njësisë. Në ndryshim nga këto vende, Rumania, Serbia dhe Bullgaria, të cilat kanë qenë në nivele nën njësinë për këtë tregues, kanë kapërcyer pragun e njësisë së të ardhurave për frymë të popullsisë duke ruajtura një trend të luhatshëm por të ndjeshëm rritjeje krahasuar me vendet e grupit të mësipërm. Ndër vendet e rajonit bëjnë dallim Greqia,


Hungaria dhe Kroacia. Kriza e vitit 2009-2010 për Greqinë, ka ndikuar në trendin e treguesit social në studim por pa humbur kryesimin e rajonit. Hungaria dhe Kroacia paraqesin trende të luhatshme por me bilanc pozitiv në periudhën 2005-2015.

Figura 4.5 Krahassimi i të ardhurave në raport me popullsinë për vendet e rajonit (2005-2015)



Përsa i përket treguesit ekonomik “Të Ardhura/PBB”, Kosova nuk bën dallim nga pjesa dërrmuese e vendeve të rajonit (Figura 4.6). Kosova bën pjesë në vendet e rajonit të cilat gjatë periudhës 2005-2015, këtë tregues e kanë në intervalin 20%-30%. Studimi në detaje më të hollësishme të grafikut të figurës 4.6 konkludon se Kosova nuk ruan një trend të qëndrueshëm gjatë kësaj periudhe. Viti me vlerat më të ulëta të këtij treguesi është viti 2005, ndërsa viti me vlerat më të larta është viti 2009. Dallim nga të gjithë vendet e rajonit në lidhje me qëndrueshmërinë e trendit të raportit në përqindje “Të Ardhura/PBB”, bëjnë Hungaria, Serbia dhe Rumania të cilat gëzojnë një trend pothuajse të qëndrueshëm në rritje të këtij treguesi, pavarësisht nivelit të vlerave të këtij treguesi.

Figura 4.6 Krahاسimi i të ardhurave në raport me PBB-n për vendet e rajonit (2005-2015)



Studimi statistikor i të dhënave të cilat përfaqësojnë vlerat e faktorëve të të ardhurave në Kosovë gjatë periudhës 2004-2016 është mbështetur në periudhat tremujore të këtyre viteve, prandaj kemi parë me interes studimin e trendit dhe specifikave tremujore të këtyre faktorëve.

Tabela 4.6 Të ardhurat publike tremujore 2004-2016 (norma e rritjes në raport me përrudhën e njëjtë të vitit paraprak)

PERIUDHA	TAT	TAJT	TAG	TAGJ	PBB
TM1 2004	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
TM2 2004	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
TM3 2004	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
TM4 2004	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
2004	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!
TM1 2005	10.977	(15.509)	#DIV/0!	9.680	3.125
TM2 2005	3.711	10.091	#DIV/0!	6.173	3.125
TM3 2005	3.606	15.274	#DIV/0!	6.853	3.125
TM4 2005	(1.413)	23.957	(83.041)	(5.411)	3.125
2005	3.771	8.455	(20.342)	3.744	3.125


TM1 2006	9.874	(9.781)	(65.306)	6.205	3.896
TM2 2006	39.934	(11.517)	22.433	33.504	3.896
TM3 2006	48.607	(10.611)	142.202	43.734	3.896
TM4 2006	(45.248)	64.354	209.619	(27.404)	3.896
2006	13.653	11.013	74.188	14.407	3.896
TM1 2007	9.938	680.981	144.118	70.977	10.929
TM2 2007	(11.020)	36.289	(37.578)	(7.672)	10.929
TM3 2007	(8.943)	38.292	(32.576)	(6.400)	10.929
TM4 2007	155.273	(14.334)	(75.645)	91.445	10.929
2007	14.881	117.129	(40.485)	25.023	10.929
TM1 2008	(3.801)	(69.992)	22.490	(30.623)	12.187
TM2 2008	20.572	16.366	(8.458)	19.787	12.187
TM3 2008	7.225	42.419	(100.000)	8.383	12.187
TM4 2008	25.207	7.446	341.209	25.325	12.187
2008	13.193	(30.896)	10.324	4.453	12.187
TM1 2009	14.771	(14.670)	(13.443)	9.067	4.811
TM2 2009	(3.554)	11.264	(60.870)	(2.314)	4.811
TM3 2009	1.783	(3.476)	#DIV/0!	3.701	4.811
TM4 2009	(3.059)	602.048	(50.723)	63.737	4.811
2009	1.161	156.115	8.058	21.492	4.811
TM1 2010	1.601	36.284	64.015	7.269	8.680
TM2 2010	11.792	256.738	708.333	45.611	10.525
TM3 2010	23.073	25.778	(21.818)	22.276	5.228
TM4 2010	0.997	(84.915)	666.122	(34.994)	8.455
2010	9.643	(31.321)	226.671	0.960	8.151
TM1 2011	26.143	3.695	(55.427)	20.463	10.847
TM2 2011	15.970	(32.178)	(50.515)	(0.420)	7.227
TM3 2011	13.001	13.999	(43.605)	12.212	11.118
TM4 2011	20.797	42.371	(31.779)	18.122	8.670
2011	18.225	(5.825)	(37.788)	11.553	9.388
TM1 2012	(2.094)	28.026	147.668	3.642	(2.992)
TM2 2012	4.740	(44.356)	12.153	(5.788)	4.485
TM3 2012	2.509	(10.423)	70.447	1.357	7.602
TM4 2012	6.882	(8.135)	74.550	8.639	9.403
2012	3.376	(14.926)	72.759	1.980	5.074
TM1 2013	7.132	12.796	(35.356)	7.395	10.284
TM2 2013	4.141	17.904	(20.743)	5.642	7.560
TM3 2013	1.932	(7.804)	12.702	0.945	4.639
TM4 2013	(6.137)	12.524	(96.231)	(12.101)	0.360
2013	1.122	8.965	(74.169)	(0.596)	5.294
TM1 2014	8.898	(31.150)	(0.324)	0.926	9.035
TM2 2014	0.558	(12.457)	(36.328)	(1.574)	(0.616)
TM3 2014	0.740	(1.925)	(11.449)	0.269	2.871
TM4 2014	5.834	6.064	80.415	6.155	2.028
2014	3.622	(10.624)	(3.940)	1.491	2.974
TM1 2015	5.195	0.391	24.351	4.765	1.861
TM2 2015	8.116	17.835	(49.693)	9.061	5.046
TM3 2015	9.707	2.607	(4.646)	8.773	6.378
TM4 2015	12.770	15.165	62.007	13.442	6.926
2015	9.226	9.829	10.073	9.310	5.223

TM1 2016	16.877	5.021	(63.185)	14.295	0.646
TM2 2016	12.735	(10.819)	135.366	9.795	3.610
TM3 2016	17.428	12.897	(100.000)	15.591	(0.000)
TM4 2016	3.169	(22.922)	(100.000)	(1.662)	2.051
2016	12.180	(6.774)	(74.906)	8.967	1.585

Burimi: Ministria e Financave të Kosovës


Të ardhurat tremujore tatimore në Kosovë për periudhën 2004-2016 ruajnë trendin tremujor vjetor tradicional ku vërehet se të ardhurat tatimore janë më të ulëta në dy tremujorët e parë dhe më të larta në dy të fundit. Dallim bën vetëm viti 2006 (Figura 4.7), në të cilin në tremujorin e katërt (tetor 2006-dhjetor 2006) kemi nivelin më të ulët të të ardhurave tremujore për këtë vit, por pa ndikuar në trendin rritës vjetor të të ardhurave tatimore. Në vitin 2006, për arsye të raportimit, Ministria e Financave, shpërndarjen e të ardhurave nëpër raportet tremujore e ka bërë sipas praktikës së atëhershme të zbrazjes së llogarive në fund të vitit dhe kjo ka ndikuar që tremujori i katërt të jetë më i ulët e cila në dukje paraqet një anomali statistikore. Në total, të ardhurat tremujore kanë kontribuar në krijimin e një trendi rritës pak të luhatshëm vjetor për këtë periudhë.

Figura 4.7 Trendi tremujor i të ardhurave tatimore në Kosovë (2004-2016)




Në treguesit e të ardhurave tremujore jotatimore vërehen çrregullime të theksuara të nivelit të vlerave të tyre në tre vite (2007, 2009 dhe 2010, Figura 4.8). Në vitin 2007, në tremujorin e parë, kemi një realizim të të ardhurave jotatimore gati të barabartë me të tre tremujorët e tjerë të këtij viti. Arsyeja që të ardhurat jotatimore në tremujorin e parë të vitit 2007 paraqiten më të larta se në periudhat tjera, është sepse në buxhetin e shtetit janë pranuar të ardhura (të njëhershme) nga licencimi i operatorit të dytë të telefonisë mobile vlerë prej 75 milion euro. Në tremujorin e katërt të vitit 2009 ky fenomen është akoma më i theksuar. Në këtë tremujor janë realizuar më shumë se dyfishi i të ardhurave jotatimore për të tre tremujorët e tjerë të po këtij viti. Në këtë shumë ka ndikuar marrja e dividendës nga Posta e Kosovës në vlerë prej 200 milion euro dhe kjo ka ndikuar që të ardhurat jotatimore në këtë tremujor të jenë më të larta. Ndërsa në vitin 2010, në tremujorin e dytë vërehet një realizim i të ardhurave jotatimore më i lartë se dyfishi i çdo tremujori të këtij viti. Gjithashtu edhe në këtë periudhë është realizuar edhe një dividend nga posta në vlerë prej 80 milion euro si rezultat i fitimeve që ka ndodhur në Postën e Kosovës. Vërehen edhe çrregullime të tjera më pak të dukshme (tremujori i dytë, 2011), të cilat së bashku me ato që janë detajuar më sipër krijojnë një ikonë jo standarde të realizimeve tremujore të të ardhurave jotatimore për periudhën e marrë në studim. Ajo çka është e rëndësishme dhe që vërehet dukshëm në paraqitjen grafike të Figurës 4.8 është se, çrregullimet e realizimeve tremujore të të ardhurave jotatimore ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në trendin vjetor të këtij faktori duke i dhënë atij karakteristikat e një trendi jo rritës. Ky trend i luhatshëm jo rritës kulmon në vitin 2009, pikërisht në atë vit ku fenomeni i ç'rregullsisë tremujore ka edhe koeficientin më të lartë të kësaj ç'rregullsie.

Figura 4.8 Trendi tremujor i të ardhurave jo tatimore në Kosovë (2004-2016)



Një faktor kumulativ i rëndësishëm i të ardhurave publike janë grandet e huaja dhe vendase të cilat injektohen në ekonominë e Kosovës. Për nga vet natyra dhe specifika e tyre, të ardhurat tremujore nga grandet nuk kanë një shpërndarje të rregullt. Ajo çka presim të studiojmë prej nivelit të tyre është shkalla e ndikimit të tyre në trendin e të ardhurave gjithsej. Pra, a ushtrojnë ndikim thelbësor të ardhurat nga grandet mbi të ardhurat gjithsej.


Figura 4.9 Trendi tremujor i të ardhurave nga grandet në Kosovë (2004-2016)



Në grafikun e Figurës 4.9 paraqiten të ardhurat nga grandet e huaja dhe vendase tremujore në periudhën 2004-2016. Pavarësisht se vlera e grandeve është relativisht e ulët në krahasim me të ardhurat tatimore dhe jotatimore, në disa tremujorë, të ardhurat zënë përqindje te konsiderueshme në krahasim me këta dy faktorë. Për shembull, në tremujorin e katërt të vitit 2010 të ardhurat nga grandet janë gati 50% e të ardhurave të tremujorit të dytë të po këtij viti, i cili është tremujor i dallueshëm nga tre të tjerët (Grafikët, Figurat 4.8 dhe 4.9).

Nga grafiku i Figurës 4.9 vërejmë se në lidhje me të ardhurat nga grandet nuk mund të konkludojmë për natyrë të trendit të këtij faktori.

Figura 4.10 Trendi tremujor i të ardhurave gjithsej në Kosovë (2004-2016)



Trendi tremujor vjetor i të ardhurave gjithsej, është një trend me karakteristikë të përgjithshme rritëse brenda secilit vit (Grafiku, Figura 4.10), ku bie në sy që tremujori i

parë është gjithmonë më i ultë për nga vlera e të ardhurave gjithsej, ndërsa tremujorët e tjerë shfaqin tendenca rritjeje të të ardhurave, me përjashtim të tremujorit të katërt të vitit 2006, i cili figuron si tremujori më i dobët i këtij viti por pa cenuar tendencën rritëse të trendit vjetor në këtë vit. Kjo karakteristikë e të ardhurave gjithsej reflekton në mënyrë të drejtpërdrejtë të njëjtin fenomen të të ardhurave tatimore (Grafiku, Figura 4.7) edhe pse të ardhurat jo tatimore për këtë tremujor të këtij viti janë gati sa dyfishi i tremujorëve të tjerë të po të njëjtit vit (Grafiku, Figura 4.8) dhe injektimi nga grandet është i nivelit pothuajse më të mirë të vitit 2006 (Grafiku, Figura 4.9).

Pra, siç është sqaruar edhe më lartë, arsyeja e realizimit më të lartë të mjeteve grandet e donatorëve ka qenë implementimi i disa projekteve të shteteve dhe agjencive të huaja në sferën e arsimit, administratës publike dhe shëndetësisë nga ana Bankës Botërore, UNDP-së, USA-as, EAR-it dhe donatorëve tjerë. Ç'rregullsi e dukshme për nga niveli i vlerës është ajo që shfaqet në tremujorin e katërt të vitit 2009 (Grafiku, Figura 4.10). Duke e krahasuar këtë tremujor me realizimin e të ardhurave tatimore të cilat ruajnë një trend normal dhe të qartë rritës (Grafiku, Figura 4.7) dhe duke marrur në konsideratë faktin që të ardhurat nga grandet nuk shfaqin injektime të rëndësishme në vlerë për këtë tremujor (grafiku, Figura 4.9), jemi të sigurt se kjo anomali e trendit tremujor-vjetor është reflektim i drejtpërdrejtë i fenomenit të vërejtur për këtë tremujor të vitit 2009 në lidhje me të ardhurat jotatimore (Grafiku, Figura 4.8). Fenomeni ka ndikuar drejtpërdrejtë në trendin vjetor të të ardhurave gjithsej duke prishur trendin rritës dhe duke krijuar idenë se në vitin pasardhës (2010) kemi një stanjacion të të ardhurave gjithsej.

Pavarësisht çrregullimeve tremujore të shfaqura në vitin 2006 dhe 2009, në përgjithësi, trendi vjetor i të ardhurave gjithsej është rritës me luhatje stanjacioni në vitin 2010 dhe vitet 2013-2014 (Grafiku, Figura 4.10).

4.2. Analiza ekonometrike

4.2.1. Specifikimi i modelit dhe të dhënat e përdorura

Metodologjia e përgjithshme statistikore e përdorur është ajo e studimit të marrëdhënieve shkakësore (causal relationship) midis variablave që marrin pjesë në studim. Për të analizuar marrëdhëniet shkakësore ndërmjet Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PBB), Të Ardhurave Tatimore (TAT), Të Ardhurave Jo Tatimore (TAJT) dhe Të Ardhurave nga Grandet (TAG) kemi përdorur modelin multivariat Vector Autoregressive (VAR), të cilin e kemi prezantuar në Çështjen 2.4 të Kapitullit 2, dhe nëpërmjet tij kemi ndërtuar modelin VECM, i cili siguron mekanizmin e korigjimit të gabimit në vlerësimin e koeficienteve të modelit VAR. Përpunimi i të dhënave është realizuar me anë të software-it Eviews8. Modeli VAR për rastin e studimit tonë paraqitet me anë të ekuacionit matematik të logaritmeve natyrore të vlerave të vrojtuar për variablat e mësipërm:

$$\ln(PBB)_t = c + \sum_{i=1}^k a_i \ln(TAT)_{t-i} + \sum_{i=1}^k b_i \ln(TAJT)_{t-i} + \sum_{i=1}^k c_i \ln(TAG)_{t-i} + \sum_{i=1}^k d_i \ln(PBB)_{t-i} + \varepsilon_t$$

(Barazimi 4.1)

ku:

$\ln(PBB)$ paraqet logaritmin natyror të vlerave Prodhimit të Përgjithshëm Bruto;

$\ln(TAT)$ paraqet logaritmin natyror të vlerave të të Ardhurat Tatimore;

$\ln(TAJT)$ paraqet logaritmin natyror të vlerave të të Ardhurat Jo Tatimore;

$\ln(TAG)$ paraqet logaritmin natyror të vlerave të të Ardhurat nga Grandet

c paraqet konstanten e modelit;

ε_t paraqet gabimin e modelit.

Të dhënat e përdorura për modelimin VAR janë të dhëna tremujore që shtrihen prej tremujorit të parë të vitit 2004 deri në tremujorin e katërt të vitit 2016, duke siguruar

kështu një seri kohore me 52 intervale kohore tremujore. Të dhënat janë shprehur me anë të logaritmit natyror të vlerave reale të tyre me qëllim përfshirjen e efekteve riprodhuese të serive kohore që krijohen me të dhënat e marra në studim.

Në Barazimin 4.1 vihet re se në modelin VAR marrin pjesë katër variabla: PBB, TAT, TAJT dhe TAG, të shprehura me anë të logaritmeve natyrore të tyre. Në qoftë se këta variabla ndajnë një prirje (trend) të përbashkët stokastik dhe diferencat e para të tyre janë stacionare, atëherë ato mund të jenë të co-integruara. Në Çështjen 2.4.1 të Kapitullit 2, kemi treguar se për analizën serive kohore multivariate të cilat përmbajnë prirje stacionare kemi përdorur testin e rrënjës njësi (unit root test) të Augmented Dicky-Fuller (ADF), i cili përdoret për të siguruar fakte signifikative të co-integritetit të variablave. Co-integrimi është një kusht i domosdoshëm që në modelin VAR të mund të përdorim mekanizmin e korrigjimit të gabimit i cili siguron një model të përmirësuar të modelit VAR, i cili quhet modeli VECM. Por, që të kemi mundësi të testojmë co-integritetin ndërmjet variablave që marrin pjesë në modelin VAR, është kusht i domosdoshëm që variablat të plotësojnë kushtin e stacionaritetit në nivelin e vlerave të drejtpërdrejta ose në nivelin e diferencave të para të tyre. Stacionariteti i variablave, ashtu sikurse kemi treguar në Çështjen 2.4.1 të Kapitullit 2, verifikohet me anë të testit ADF (Testi Augmented Dicky-Fuller) i cili përcakton ekzistencën ose jo të rrënjës njësi në nivel vlerash të drejtpërdrejta apo në diferencë të parë për secilin variabël.

4.2.2. Testi i rrënjës njësi (unit root test)

Sikurse theksuam në çështjen paraardhëse, për të realizuar testin e co-integritetit ndërmjet variablave që marrin pjesë në ndërtimin e modelit VAR, së pari kërkohen prova të ekzistencës ose jo të rrënjës njësi për secilin prej variablave PBB, TAT, TAJT dhe TAG.

Këtë e kemi realizuar me anë të testit regresiv ADF (Augmented Dicky-Fuller) të tipit të shprehur me anë të ekuacionit linear multivariat:

$$\Delta X_t = \delta_0 + \delta_1 t + \delta_2 X_{t-1} + \sum_{i=1}^k \alpha_i \Delta X_{t-1} + u_t$$

(Barazimi 4.2)

Ku:

X_t shpreh logaritmin natyror të variablit në periudhën kohore t ;

ΔX_{t-1} shpreh diferencat e para me k -vonesa (lags);

u_t është variabli i cili shpreh gabimet e autokorrelacionit.

Koeficientet janë vlerësuar nga përpunimi i të dhënave. Hipoteza zero (null) dhe hipoteza alternative për ekzistencën e rrënjës njësi për secilin variabël kanë trajtën:

$$H_0 : \delta_2 = 0 \quad \text{v.s.} \quad H_a : \delta_2 < 0$$

Në modelin ADF të testimit të hipotezës null, pranimi ose refuzimi i saj realizohet me anë të krahasimit të vlerës së ADF (t-Statistic) me vlerën kritike të testit në nivelin e paracaktuar të signifkancës statistike (1%, 5% ose 10%). Në studimin tonë ne kemi përdorur nivelin 5% të signifkancës statistikore. Kur vlera e ADF t-Statistic është më e madhe se vlera kritike e testit në nivelin 5%, hipoteza null nuk mund të refuzohet, pra mbetet që variabli përkatës ka një rrënjë njësi, gjë e cila do të thotë se ky variabël është jo-stacionar. Testin ADF e kemi zhvilluar për secilin prej variablave që marrin pjesë në modelin edhe në nivelin e drejtpërdrejtë të vlerave të tyre por edhe në diferencë të parë.

Tabela 4.7 Testi i rrënjës njësi për Ln(PBB)

Null Hypothesis: LN_PBB_ has a unit root Exogenous: Constant Lag Length: 3 (Automatic - based on SIC, maxlag=10) In level	Null Hypothesis: D(LN_PBB_) has a unit root Exogenous: Constant Lag Length: 3 (Automatic - based on SIC, maxlag=10) In first differences
--	---

	t-Statistic	Prob.*		t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-1.759435	0.3957	Augmented Dickey-Fuller test statistic	-3.723619	0.0067
Test critical values: 1% level	-3.574446		Test critical values: 1% level	-3.577723	
5% level	-2.92378		5% level	-2.925169	
10% level	-2.599925		10% level	-2.600658	
*MacKinnon (1996) one-sided p-values.			*MacKinnon (1996) one-sided p-values.		

Në Tabelën 4.7 vërejmë se në nivelin e signifkancës 5% , për variablin Ln(PBB) në vlera te drejtpërdrejta, ADF (t-Statistic) = -1.759435 > Vlera kritike (5%) = -2.92378, rrjedhimisht, hipoteza null nuk mund të refuzohet. Pra, variabli Ln(PBB) është jo-stacionar në vlera të drejtpërdrejta të tij. Në seksionin e vlerave në diferencë të parë për këtë variabël, vërejmë se ADF (t-Statistic) = -3.723619 < Vlera kritike (5%) = -2.925169, rrjedhimisht, hipoteza null refuzohet. Pra, variabli Ln(PBB) është stacionar në diferencë të parë të vlerave të tij.

Tabela 4.8 Testi i rrënjës njësi për Ln(TAG)

Null Hypothesis: LN_TAG_ has a unit root Exogenous: Constant Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=10) In level			Null Hypothesis: D(LN_TAG_) has a unit root Exogenous: Constant Lag Length: 2 (Automatic - based on SIC, maxlag=10) In First Differences		
	t-Statistic	Prob.*		t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-6.734946	0.0000	Augmented Dickey-Fuller test statistic	-7.597059	0.0000
Test critical values: 1% level	-3.588509		Test critical values: 1% level	-3.615588	
5% level	-2.929734		5% level	-2.941145	
10% level	-2.603064		10% level	-2.609066	
*MacKinnon (1996) one-sided p-values.			*MacKinnon (1996) one-sided p-values.		

Në Tabelën 4.8 vërejmë se në nivelin e signifkancës 5% , për variablin Ln(TAG) në vlera te drejtpërdrejta, ADF (t-Statistic) = -6.734946 < Vlera kritike (5%) = -2.929734, rrjedhimisht, hipoteza null refuzohet. Pra, variabli Ln(TAG) është stacionar në vlera të

drejtpërdrejta të tij. Po kështu, në seksionin e vlerave në diferencë të parë për këtë variabël, vërejmë se $ADF (t\text{-Statistic}) = -7.597059 < \text{Vlera kritike (5\%)} = -2.941145$, rrjedhimisht, hipoteza null refuzohet. Pra, variabli $\ln(\text{TAG})$ është stacionar edhe në diferencë të parë të vlerave të tij.

Tabela 4.9 Testi i rrënjës njësi për $\ln(\text{TAT})$

Null Hypothesis: LN_TAT_ has a unit root Exogenous: Constant Lag Length: 4 (Automatic - based on SIC, maxlag=10) In level			Null Hypothesis: D(LN_TAT_) has a unit root Exogenous: Constant Lag Length: 3 (Automatic - based on SIC, maxlag=10) In first differences		
	t-Statistic	Prob.*		t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-0.620497	0.8560	Augmented Dickey-Fuller test statistic	-7.885521	0.0000
Test critical values:	1% level	-3.577723	Test critical values:	1% level	-3.577723
	5% level	-2.925169		5% level	-2.925169
	10% level	-2.600658		10% level	-2.600658
*MacKinnon (1996) one-sided p-values.			*MacKinnon (1996) one-sided p-values.		

Në Tabelën 4.9 vërejmë se në nivelin e signifikançës 5% , për variablin $\ln(\text{TAT})$ në vlera të drejtpërdrejta, $ADF (t\text{-Statistic}) = -0.620497 > \text{Vlera kritike (5\%)} = -2.925169$, rrjedhimisht, hipoteza null nuk mund të refuzohet. Pra, variabli $\ln(\text{TAT})$ është jo-stacionar në vlera të drejtpërdrejta të tij. Në seksionin e vlerave në diferencë të parë për këtë variabël, vërejmë se $ADF (t\text{-Statistic}) = -7.885521 < \text{Vlera kritike (5\%)} = -2.925169$, rrjedhimisht, hipoteza null refuzohet. Pra, variabli $\ln(\text{TAT})$ është stacionar në diferencë të parë të vlerave të tij.

Tabela 4.10 Testi i rrënjës njësi për $\ln(\text{TAJT})$

Null Hypothesis: LN_TAJT_ has a unit root Exogenous: Constant Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=10)			Null Hypothesis: D(LN_TAJT_) has a unit root Exogenous: Constant Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=10)		
---	--	--	--	--	--

In level			In first differences		
	t-Statistic	Prob.*		t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-4.453949	0.0008	Augmented Dickey-Fuller test statistic	-12.92744	0.0000
Test critical values: 1% level	-3.56543		Test critical values: 1% level	-3.568308	
5% level	-2.919952		5% level	-2.921175	
10% level	-2.597905		10% level	-2.598551	
*MacKinnon (1996) one-sided p-values.			*MacKinnon (1996) one-sided p-values.		

Në Tabelën 4.10 vërejmë se në nivelin e signifkancës 5% , për variablin Ln(TAJT) në vlera të drejtpërdrejta, ADF (t-Statistic) = -4.453949 > Vlera kritike (5%) = -2.919952, rrjedhimisht, hipoteza null refuzohet. Pra, variabli Ln(TAJT) është stacionar në vlera të drejtpërdrejta të tij. Në seksionin e vlerave në diferencë të parë për këtë variabël, vërejmë se ADF (t-Statistic) = -12.92744 < Vlera kritike (5%) = -2.921175, rrjedhimisht, hipoteza null refuzohet. Pra, variabli Ln(TAJT) është stacionar edhe në diferencë të parë të vlerave të tij.

Testimi i stacionaritet të variablave Ln(PBB), Ln(TAG), Ln(TAT) dhe Ln(TAJT) rezultoi në konkluzionin se, në vlera të drejtpërdrejta, jo të gjithë variablat janë stacionar, por në diferencë të parë të vlera të tyre, të katër variablat e mësipërm janë stacionar. Mbështetur në këtë konkluzion, në qoftë se plotësohet kushti i co-integrimit, modeli VAR mund të shoqërohet nga modeli VECM i korrigjimit të gabimit.

4.2.3. Modeli VAR për Ln(PBB), Ln(TAG), Ln(TAT) dhe Ln(TAJT)

Ekzekutimi i të dhënave në trajtë logaritmike natyrore për variablat në software-in Eviews 8 për vlerësimin e koeficienteve të modelit me variabël të varur Ln(PBB) dhe variabla të pavarur Ln(TAT), Ln(TAJT) dhe Ln(TAG) dha rezultatet e paraqitura në Tabelën 4.11 të ndërtuar sipas rezultateve të outputit-it “Vector Autoregression Estimates”.

Tabela 4.11 Vlerësimi i koeficienteve të modelit VAR

Vector Autoregression Estimates (LN_PBB_)			
	Coefficients	Standart Errors	t-statistics
LN_PBB_(-1)	$d_1 = 0.514307$	(0.24550)	[2.09492]
LN_PBB_(-2)	$d_2 = 0.182464$	(0.25387)	[0.71873]
LN_TAG_(-1)	$c_1 = 0.080326$	(0.02658)	[-3.02211]
LN_TAG_(-2)	$c_2 = 0.015111$	(0.03079)	[0.49079]
LN_TAJT_(-1)	$b_1 = 0.033618$	(0.05579)	[-0.60263]
LN_TAJT_(-2)	$b_2 = 0.117560$	(0.04362)	[2.69538]
LN_TAT_(-1)	$a_1 = 0.069263$	(0.15202)	[0.45561]
LN_TAT_(-2)	$a_2 = 0.027992$	(0.17753)	[-0.15767]
C	$c = 1.697653$	(1.13360)	[1.49758]

Ekuacioni ekonometrik logaritmeve natyrore të vlerave të vrojtuarra për variablat e mësipërm, i shprehur në mënyrë të përgjithshme me anë të Barazimit 4.1, për rastin e variablave të mësipërm, ka trajtën:

$$\ln(PBB)_t = c + \sum_{i=1}^2 a_i \ln(TAT)_{t-1} + \sum_{i=1}^2 b_i \ln(TAJT)_{t-1} + \sum_{i=1}^2 c_i \ln(TAG)_{t-1} + \sum_{i=1}^2 d_i \ln(PBB)_{t-1} + \varepsilon_t$$

(Barazimi 4.3)

Ku, koeficientet a_i , b_i , c_i , d_i dhe c janë ata të cilët janë paraqitur në shtyllën e dytë të Tabelës 4.11.

Barazimi 4.3 është një paraqitje ekonometrike e modelit VAR i cili shpreh marrëdhënien lineare ndërmjet variablit të varur dhe variablave të pavarur, por kjo lidhje funksionale është e pakufizuar (unrestricted model) për faktin se përmban një vektor të pakorrigjuar me margjinale gabimet në vlerësimin e koeficienteve të modelit, të cilat shpesh bëjnë që modele të tilla të jenë jashtë kufijve të lejueshëm të përshtatshmërisë statistikore të modelit. *E thënë ndryshe, modele të tilla krijojnë perceptime të gabuara mbi marrëdhëniet midis variablave të marrë në studim.*

Për të eliminuar këtë fenomen të papëlqyer, në studimin tonë, kemi mbështetur përfundimet e nxjerra për llojin dhe shkallën e ndikimit të secilit variabël të pavarur mbi variablin e varur, duke përdorur modelin e përmirësuar VECM.

Në studimet statistikore-ekonometrike, ndërtimi i modeleve VECM mbështetet në tre hapa të rëndësishëm dhe të domosdoshëm: (i) përcaktimi i numrit të time-lags (vonesave në kohë ose ndryshe, intervaleve kohore) të cilat përfaqësojnë diferencën në kohë nga njëri vërtetim në tjetrin në një seri kohore vërtimesh; (ii) testi i co-integrimit; (iii) vlerësimi i koeficienteve të VECM dhe testimi i hipotezave për këta koeficient.

4.2.4. Përcaktimi i numrit optimal të lags për modelin VECM

Për të përcaktuar numrin optimal të lags duke përdorur të dhënat në trajtë logaritmike natyrore të variablave $\ln(\text{PBB})$, $\ln(\text{TAG})$, $\ln(\text{TAT})$ dhe $\ln(\text{TAJT})$, në modelin VAR të ndërtuar për këta variabla, kemi përzgjedhur një numër të konsideruar të mjaftueshëm të lags për të filluar procesin e përcaktimit të numrit optimal të tyre. Në modelin VAR, të përcaktuar me anë të Barazimit 4.3, vihet re se numri i lags, i përzgjedhur automatikisht nga modeli, është 2 ($k=2$, Barazimi 4.2 dhe 4.3), prandaj për përcaktimin e numrit optimal të lags kemi përzgjedhur një numër më të lartë, $k=3$. Procedimi i të dhënave siguroi një Outputi i cili paraqitet në Tabelën 4.12.

Tabela 4.12 Përcaktimi i numrit optimal të lags në modelin VECM

VAR Lag Order Selection Criteria						
Endogenous variables: LN_PBB_ LN_TAG_ LN_TAJT_ LN_TAT_						
Exogenous variables: C						
Lag	LogL	LR	FPE	AIC	SC	HQ
0	-50.24561	NA	0.000177	2.712281	2.881169	2.773345
1	-15.3592	61.05123	6.92e-05	1.767960	2.612399*	2.073282
2	3.047751	28.53077	6.30e-05	1.647612	3.167604	2.197193

3	32.92890	40.33955*	3.36e-05*	0.953555*	3.149098	1.747394*
* indicates lag order selected by the criterion LR: sequential modified LR test statistic (each test at 5% level) FPE: Final prediction error AIC: Akaike information criterion SC: Schwarz information criterion HQ: Hannan-Quinn information criterion						

Në seksionin e fundit të Tabelës 4.12 vihet re për përcaktimin e numrit optimal të lags janë përdorur gjithsej pesë kritere: (LR) sequential modified LR test statistic, (FPE) Final prediction error, (AIC) Akaike information criterion, (SC) Schwarz information criterion dhe (HQ) Hannan-Quinn information criterion. Për testimin e secilit kriter është përdorur niveli 5% i signifkancës statistikore. Modeli përzgjedh në mënyrë automatike numrin optimal të lags sipas secilit kriter duke e indeksuar me “ * ”. Përfundimisht, referuar outputit të paraqitur me anë të Tabelës 4.12, konkludojmë se katër nga kriteret e mësipërme kanë përcaktuar si nivel optimal të numrit të lags, nivelin 3 (LR=40.33955*; FPE=3.36e-05*; AIC=0.953555*; HQ=1.747394*). Kriteri Schëarz information criterion ka përzgjedhur si nivel optimal, nivelin 1 (SC=2.612399*).

Meqenëse katër prej kriterëve kanë përcaktuar si nivel optimal të numrit të lags, nivelin 3, në dy hapat e tjerë të ndërtimit të modelit VECM (testi i co-integrimit dhe vlerësimi i koeficienteve), do të përdorim pikërisht këtë nivel të lags.

4.2.5. Testi Johansen i co-integrimit

Parakushti i testit të co-integrimit është stacionaritetit i variablave që marrin pjesë në ndërtimin e modelit. Në Çështjen 4.2.3, variablat nuk janë të gjithë njëherësh stacionar në nivel vlerash të drejtpërdrejta por në nivel diferencash të para, variablat plotësojnë kushtin e të qenit stacionare. Në këtë mënyrë, testimi i co-integritetit bëhet i mundshëm

me anë të testimit të hipotezave që ofron testi Johansen. Testi Johansen i co-integritimit përdor disa kriterë për përcaktimin e numrit optimal të ekuacioneve (modeleve) të co-integruara. Sikurse kemi theksuar në çështjen 2.4.3, co-integrimi i variablave është tregues i një marrëdhënieje lineare afatgjatë ndërmjet tyre. Më poshtë kemi verifikuar numrin e modeleve të co-integruara duke përdorur dhe krahasuar rezultatin për dy nga kriteret të cilat përdoren në verifikimin e co-integritimit me anë të testit Johansen.

Hipoteza null që verifikohet me anë të testit Johansen, pavarësisht nga kriteri që përdoret, ka trajtën: numri i ekuacioneve të ko-integruara është n ($n = 0, 1, 2, \dots$), versus hipotezën alternative: numri i ekuacioneve të ko-integruara nuk është n ($n = 0, 1, 2, \dots$). Verifikimi i hipotezës null realizohet: (i) me anë të krahasimit të vlerës përkatëse të kriterit të përdorur me vlerën kritike me nivel të paracaktuar signifkancës (në rastin tonë 5%) (ii) me anë të krahasimit të vlerës së probabilitetit përkatës me nivelin e paracaktuar të signifkancës (në rastin tonë 5%).

Për rastin (i): në qoftë se vlera e statistikës së kriterit $>$ Vlera kritike (5%), atëherë hipoteza null refuzohet dhe mbetet e vërtetë hipoteza alternative.

Për rastin (ii): në qoftë se Prob. < 0.05 , atëherë hipoteza null refuzohet dhe mbetet e vërtetë hipoteza alternative.

Në të dyja rastet, niveli i lags i përdorur, është niveli optimal i lags i përcaktuar në çështjen paraardhëse.

Tabela 4.13 Testi Johansen sipas kriterit *Trace*

Unrestricted Cointegration Rank Test (Trace)				
Hypothesized		Trace	0.05	
No. of CE(s)	Eigenvalue	Statistic	Critical Value	Prob.**
None *	0.563747	61.15975	47.85613	0.0018
At most 1	0.334385	29.63746	29.79707	0.0521

At most 2	0.260271	14.16980	15.49471	0.0784
At most 3	0.068927	2.713880	3.841466	0.0995
Trace test indicates 1 cointegrating eqn(s) at the 0.05 level * denotes rejection of the hypothesis at the 0.05 level **MacKinnon-Haug-Michelis (1999) p-values				

Testi Johansen, duke përdorur kriterin Trace, na ka dhënë rezultatet e paraqitura Tabelën 4.13. Në tabelë vihet re se për $n=1$, Trace Statistic (TS) = 29.63746 < Vlera Kritike (VC) = 29.79707 dhe Prob. = 0.0521 > 0.05. Pra, variablat e përdorur në studim ofrojnë të paktën një model të co-integruar sipas testit Johansen duke përdorur kriterin Trace.

Tabela 4.14 Testi Johansen sipas kriterit *Maximum Eigenvalue*

Unrestricted Cointegration Rank Test (Maximum Eigenvalue)				
Hypothesized		Max-Eigen	0.05	
No. of CE(s)	Eigenvalue	Statistic	Critical Value	Prob.**
None *	0.563747	31.52229	27.58434	0.0148
At most 1	0.334385	15.46765	21.13162	0.2575
At most 2	0.260271	11.45592	14.26460	0.1328
At most 3	0.068927	2.713880	3.841466	0.0995
Max-eigenvalue test indicates 1 cointegrating eqn(s) at the 0.05 level * denotes rejection of the hypothesis at the 0.05 level **MacKinnon-Haug-Michelis (1999) p-values				

Testi Johansen, duke përdorur kriterin Max-Eigen, na ka dhënë rezultatet e paraqitura Tabelën 4.14. Në tabelë vihet re se për $n=1$, Max- Eigen Statistic (M-ES) = 15.46765 < Vlera Kritike (VC) = 21.13162 dhe Prob. = 0.2575 > 0.05. Pra, variablat e përdorur në studim ofrojnë të paktën një model të ko-integruar sipas testit Johansen duke përdorur kriterin Maximum Eigen value.

Meqenëse në të dyja rastet e testit Johansen hipoteza null nuk refuzohet për $n=1$, mund të themi se ekziston të paktën një model i co-integruar.

Duke ditur se, në qoftë se variablat janë të co-integruara ose ndryshe variablat kanë një marrëdhënie afatgjatë statistikore dhe ekziston të paktën një ekuacion i co-integruar, mbetet që të vazhdojmë procedurën e ndërtimit të një model VECM.

4.2.6. Modeli VECM me variabël të varur Ln(PBB)

Përpunimi i të dhënave logaritmike natyrore me anë të software-it Eview 8, në funksion të ndërtimit të modelit VECM, ofron si hap të parë një model linear të marrëdhënieve funksionale ndërmjet variablit të varur Ln(PBB) dhe variablave të pavarur Ln(TAT), Ln(TAJT) dhe Ln(TAG) (Tabela 4.15).

Tabela 4.15 Modeli i regresionit linear me variabël të varur Ln(PBB)

Vector Error Correction Estimates					
Standard errors in () & t-statistics in []					
Cointegrating Eq:	CointEq1				
	LN_PBB_(-1)	LN_TAG_(-1)	LN_TAJT_(-1)	LN_TAT_(-1)	C
CointEq1	1.000000	0.070412	0.004629	-0.85848	-2.449706
		(0.01933)	(0.02783)	(0.03470)	
		[3.64215]	[0.16631]	[-24.7427]	

Ky model nuk është gjë tjetër veçse modeli që përdoret rëndomë në studimin e marrëdhënieve shkakësore funksionale ndërmjet variablave që merren në studim dhe që në ekonometri njihet me emrin ekuacioni i regresionit linear.

Ekuacioni i co-integruar i regresionit linear që shpreh lidhjen funksionale midis variablit të varur Ln(PBB) me variabla të pavarur Ln(TAT), Ln(TAJT) dhe Ln(TAG) ka trajtën:

$$\ln(PBB)_t = -2.45 + 0.07 \ln(TAG)_t + 0.01 \ln(TAJT)_t - 0.86 \ln(TAT)_t + \varepsilon_t$$

(Barazimi 4.4)

Në këtë barazim, koeficientet janë paraqitur me përafrimin e rrumbullakimit deri në 10^{-2} .

Sikurse vihet re, barazimi 4.4 nuk shprehet me anë të numrit optimal të lags të përcaktuar në çështjen 4.2.4. Software-i që kemi përdorur bën automatikisht ndërtimin e modelit me numrin optimal të lags dhe po në mënyrë automatike ky soft zgjedh përdorimin e të dhënave stacionare në ndërtimin e modelit VECM, që në rastin tonë janë të dhëna në diferencë të parë (ose e thënë ndryshe, efienca e faktorëve) (Tabela 4.16).

Tabela 4.16 Koeficientët e modelit VECM për variablat në diferencë të parë

Error Correction:	D(LN_PBB_)				
CointEq1	0.388411	D(LN_TAG_(-1))	-0.027122	D(LN_TAJT_(-3))	-0.010556
	(0.17633)		(0.01054)		(0.01600)
	[2.20277]		[-2.57279]		[-0.65972]
D(LN_PBB_(-1))	-1.220051	D(LN_TAG_(-2))	-0.016529	D(LN_TAT_(-1))	0.257309
	(0.16781)		(0.01174)		(0.12416)
	[-7.27023]		[-1.40777]		[2.07237]
D(LN_PBB_(-2))	-1.210086	D(LN_TAG_(-3))	-0.000967	D(LN_TAT_(-2))	0.218154
	(0.16763)		(0.01074)		(0.10658)
	[-7.21890]		[-0.09006]		[2.04686]
D(LN_PBB_(-3))	-1.105933	D(LN_TAJT_(-1))	0.017986	D(LN_TAT_(-3))	0.133844
	(0.09954)		(0.01809)		(0.06508)
	[-11.1108]		[0.99414]		[2.05656]
		D(LN_TAJT_(-2))	0.025263	C	0.056186
			(0.01851)		(0.00676)
Standard errors in () & t-statistics in []			[1.36477]		[8.31308]

Në Tabelën 4.16 shihet se për secilin variabël janë përcaktuar koeficiente për secilën nga tre lags. Gjithashtu, në model kemi përzgjedhur $\ln(PBB)$ si variabël të varur dhe $\ln(TAT)$, $\ln(TAJT)$ dhe $\ln(TAG)$ si variabla të pavarur. Outputi i softit të përdorur ofron edhe trajtën matematike të ekuacionit duke përfshirë në të koeficientet korrigjues të gabimit të modelit (Barazimi 4.5). Në këtë barazim vihet re se është i përfshirë

ekuacioni i co-integruar i shprehur me anë të Barazimit 4.4, ndërsa vlerat përkatëse të variablave sipas numrit të lags janë ato të cilët paraqiten në Tabelën 4.16.

$$\begin{aligned}
 D(LN_PBB_t) = & C(1) * [LN_PBB_{t-1} + 0.0704120736364 * LN_TAG_{t-1} + \\
 & 0.00462919408824 * LN_TAJT_{t-1} - 0.858479824741 * LN_TAT_{t-1} - 2.44970562264] + \\
 & C(2) * D(LN_PBB_{t-1}) + C(3) * D(LN_PBB_{t-2}) + C(4) * D(LN_PBB_{t-3}) + \\
 & C(5) * D(LN_TAG_{t-1}) + C(6) * D(LN_TAG_{t-2}) + C(7) * D(LN_TAG_{t-3}) + \\
 & C(8) * D(LN_TAJT_{t-1}) + C(9) * D(LN_TAJT_{t-2}) + C(10) * D(LN_TAJT_{t-3}) + \\
 & C(11) * D(LN_TAT_{t-1}) + C(12) * D(LN_TAT_{t-2}) + C(13) * D(LN_TAT_{t-3}) + C(14)
 \end{aligned}$$

(Barazimi 4.5)

Në barazimin e mësipërm vërehen 14 koeficiente të papërcaktuar [C(1)-C(14)], ku C(1) është koeficienti i ekuacionit të parë të co-integruar i cili quhet termi i korigjimit të gabimit (error correction term) ose ndryshe shpejtësia e rregullimit drejt ekuilibrit (speed of adjustment to wards equilibrium). C(14) është konstantja e modelit.

Qëllimi i parë dhe kryesor i ndërtimit të modelit VECM është pikërisht përcaktimi i koeficientit C(1) dhe verifikimi me anë të tij i lidhjeve shkakësore afatgjata (long run causality) midis variablave që marrin pjesë në model. Në qoftë se vlera e C₍₁₎ është negative dhe me signifikançë të mjaftueshme statistikore, atëherë ekziston një marrëdhënie afatgjate e shkaktuar nga variablat e pavarur mbi variablin e varur.

Tabela 4.17 Tabela e koeficientëve të korigjimit të gabimit

	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C(1)	0.36543	0.172737	2.115525	0.0441
C(2)	-1.163789	0.160763	-7.239161	0.0000
C(3)	-1.172275	0.17019	-6.888057	0.0000
C(4)	-1.080919	0.10073	-10.73087	0.0000
C(5)	-0.025137	0.010471	-2.400635	0.0238
C(6)	-0.011951	0.011797	-1.013101	0.3203
C(7)	-0.002316	0.010951	-0.211528	0.8341
C(8)	0.008174	0.017626	0.463773	0.6467
C(9)	0.026643	0.01907	1.397159	0.1742
C(10)	-0.010085	0.016463	-0.612606	0.5455

C(11)	0.23777	0.120719	1.969624	0.0596
C(12)	0.177443	0.102627	1.729004	0.0957
C(13)	0.126578	0.06647	1.904298	0.0680
C(14)	0.057073	0.006777	8.421142	0.0000

Në Tabelën 4.17 vërejmë se $C_{(1)}=0.36543>0$ dhe $pC_{(1)}=0.0441<0.05$. Pra, termi i korigjimit të gabimit siguron signifikançën e mjaftueshme statistikore por vlera e tij është pozitive, prandaj konkludojmë se nuk ekziston një marrëdhënie afatgjatë shkakësore midis variablit të varur $\ln(\text{PBB})$ dhe variablave të pavarur $\ln(\text{TAT})$, $\ln(\text{TAJT})$ dhe $\ln(\text{TAG})$.

Qëllimi i dytë kryesor i modelit VECM është verifikimi i marrëdhënieve shkakësore afatshkurtra ndërmjet variablave të marra në studim. Për realizimin e verifikimit të këtyre marrëdhënieve, për çdo variabël të pavarur testohet hipoteza null e tipit: nuk ekziston një marrëdhënie afatshkurtër shkakësore midis variablit të varur dhe variablit të pavarur. Ketë e kemi realizuar duke përdorur testin Wald për çdo variabël të pavarur sipas mënyrës konkrete që kjo metodë përdor për testimin e hipotezës null.

Për variablin e pavarur $\ln(\text{TAG})$ hipoteza null është ekuivalente me vërtetësinë e barazimit: $C_{(5)}=C_{(6)}=C_{(7)}=0$. Kur probabiliteti i vlerësimit për F-statistic dhe Chi-square janë në vlerë më të lartë se niveli 5% i signifikançës, atëherë hipoteza null nuk mund të refuzohet, pra mbetet që koeficientet $C_{(5)}$, $C_{(6)}$ dhe $C_{(7)}$ të jenë njëherësh zero dhe si rrjedhim nuk ekziston një marrëdhënie afatshkurtër të shkaktuar nga variabli i pavarur $\ln(\text{TAG})$ mbi variablin e varur $\ln(\text{PBB})$.

Tabela 4.18 Testi Wald për variablin e pavarur $\ln(\text{TAG})$

Wald Test:	Null Hypothesis Summary:		
Equation: Untitled	Normalized Restriction (= 0)	Value	Std. Err.

Test	Statistic	Value	df	Probability	C(5)	-0.025137	0.010471
F-statistic	2.068514	(3, 26)	0.1289	C(6)	-0.011951	0.011797	
Chi-square	6.205542	3	0.1020	C(7)	-0.002316	0.010951	
Null Hypothesis: C(5)=C(6)=C(7)=0				Restrictions are linear in coefficients.			

Në Tabelën 4.18 vërehet se $p(F\text{-stat.})=0.1289>0.05$ dhe $p(\text{Chi-sq.})=0.1020>0.05$. Ky rezultat i probabilitet eve tregon se hipoteza null nuk mund të refuzohet dhe $\text{Ln}(\text{TAG})$ nuk ushtron ndikim shkakësor afatshkurtër mbi variablin $\text{Ln}(\text{PBB})$.

Në të njëjtën mënyrë, testi Wald, verifikon hipotezën null: $C_{(8)}=C_{(9)}=C_{(10)}=0$ për variablin e pavarur $\text{Ln}(\text{TAJT})$.

Tabela 4.19 Testi Wald për variablin e pavarur $\text{Ln}(\text{TAJT})$

Wald Test:				Null Hypothesis Summary:		
Equation: Untitled				Normalized Restriction (= 0)		
Test					Value	Std. Err.
Statistic	Value	df	Probability	C(8)	0.008174	0.017626
F-statistic	1.044279	(3, 26)	0.3896	C(9)	0.026643	0.019070
Chi-square	3.132836	3	0.3716	C(10)	-0.010085	0.016463
Null Hypothesis: C(8)=C(9)=C(10)=0				Restrictions are linear in coefficients.		

Në Tabelën 4.19 vërehet se $p(F\text{-stat.})=0.3896>0.05$ dhe $p(\text{Chi-sq.})=0.3716>0.05$. Ky rezultat i probabilitet eve tregon se hipoteza null nuk mund të refuzohet dhe $\text{Ln}(\text{TAJT})$ nuk ushtron ndikim shkakësor afatshkurtër mbi variablin $\text{Ln}(\text{PBB})$.

Hipoteza null, për variablin e tretë të pavarur $\text{Ln}(\text{TAT})$, ka trajtën: $C_{(11)}=C_{(12)}=C_{(13)}=0$.

Në Tabelën 4.20 vërehet se $p(F\text{-stat.})=0.2269>0.05$ dhe $p(\text{Chi-sq.})=0.2009>0.05$. Ky rezultat i probabilitet eve tregon se hipoteza null nuk mund të refuzohet dhe $\text{Ln}(\text{TAT})$ nuk ushtron ndikim shkakësor afatshkurtër mbi variablin $\text{Ln}(\text{PBB})$.

Tabela 4.20 Testi Wald për variablin e pavarur Ln(TAT)

Wald Test:				Null Hypothesis Summary:		
Equation: Untitled Test				Normalized Restriction (= 0)	Value	Std. Err.
Statistic	Value	df	Probability	C(11)	0.237770	0.120719
F-statistic	1.543634	(3, 26)	0.2269	C(12)	0.177443	0.102627
Chi-square	4.630903	3	0.2009	C(13)	0.126578	0.066470
Null Hypothesis: C(11)=C(12)=C(13)=0				Restrictions are linear in coefficients.		

Duke e përmbledhur në trajtën e një përfundimi rezultatet e testit Wald për secilin nga variablat e pavarur që marrin pjesë në modelin VECM, kemi konkluduar se nuk ekziston asnjë marrëdhënie shkakësore afatshkurtër e variablave të pavarur Ln(TAT), Ln(TAJT) dhe Ln(TAG) mbi variablin e varur Ln(PBB).

Duke përmbledhur në një rezultat të vetëm modelin e regresionit linear të shprehur me anë të Barazimit 4.4 dhe verifikimin e hipotezave null për koeficientet $C_{(2)}-C_{(13)}$ me anë të testit Wald, ekuacioni ekonometrik i cili shpreh marrëdhënien statistikore ndërmjet variablit të varur dhe variablave të pavarura, ka trajtën:

$$D(LN_PBB_t) = 0.3654 * [LN_PBB_(-1) + 0.0704 * LN_TAG_(-1) + 0.0046 * LN_TAJT_(-1) - 0.8585 * LN_TAT_(-1) - 2.4497] + 0.0570 + \varepsilon_t$$

(Barazimi 4.6)


Kryerja e veprimeve matematike në Barazimin 4.6 realizon një trajtë përfundimtare ekonometrike të shprehjes së marrëdhënieve statistikore ndërmjet variablit të varur dhe variablave të pavarur që marrin pjesë në studim, e cila përfshin ndikimin matematik të koeficienteve të korigjimit të gabimit në model:

$$D[Ln(PBB)] = 0.3654 * [Ln(PBB)(-1)] + 0.0257 * [Ln(TAG)(-1)] + 0.0017 * [Ln(TAJT)(-1)] - 0.3137 * [Ln(TAT)(-1)] + 2.3937 + \varepsilon_t$$

(Barazimi 4.7)

Në modelin e paraqitur me anë të Barazimit 4.7 është lehtësisht e identifikueshme shkalla dhe drejtimi i ndikimit të secilit variabël të pavarur mbi variablin e varur kur $\ln(\text{PBB})$ është e shprehur në diferenca të para. Grafikisht ky ndikim paraqitet në Figurën 4.11.

Figura 4.11 Krahاسimi i koeficientëve në modelin e VECM



Sikurse vihet re nga grafiku i Figurës 4.11, të ardhurat tatimore ushtrojnë një ndikim të dukshëm negativ mbi PBB-ën. Të ardhurat nga grandet dhe të ardhurat jo tatimore ushtrojnë ndikim pozitiv mbi PBB-ën, por të ardhurat jo tatimore ushtrojnë një ndikim pothuajse të papërfillshëm, krahasuar me të ardhurat nga grandet. Gjithashtu gjetje tjetër mjaft e rëndësishme nga modeli i paraqitur në barazimin 4.7 dhe në bazë të paraqitjes grafike të tij në figurën 4,11 është edhe ndikimi pozitiv i PBB-ës nga vitet paraprake në rritjen e tij me çka vërehet qartë se ky ndikim është signifikant. Pra vetë PBB-ja e viteve paraprake ka ndikim në rritjen ekonomike të vendit (PBB). Siç vërehet nga të dhënat e nxjerra (tabela 4.6 dhe figura 4.10) trendi i të ardhurave publike ka qenë vazhdimisht në rritje, trend që është përcjellur edhe në të ardhurat tatimore (tabela 4.6 dhe figura 4.7). Duke u nisur nga kjo e gjetur vërejmë se ky trend pozitiv i të ardhurave tatimore nuk ka dhënë rezultate në rritjen ekonomike. Në bazë të rezultatit ekonometrik me modelin VECM vërehet se çdo rritje në tatim çon në ulje të PBB-së (rritjes ekonomike). Po ashtu duke analizuar rezultatet e nxjerra nga kalkulimet që janë bërë në këtë hulumtim (shtojca

tabela A3) për pjesëmarrjen e të ardhurave tatimore në raport me PBB, po ashtu vërehet se trendi i pjesëmarrjes është vazhdimisht në rritje (2004 = 18.83%, 2016=24.28%, shtojca tabela A3). Kemi disa oscilime si në vitin 2009, 2010 (shtojca tabela A3) por pa shkaktuar ndonjë çrregullim të madh në trendin e këtij raporti. Në bazë të të gjetura nga ky hulumtim mund të konkludojmë se çdo rrije në trendin e të ardhurave (si rezultat i rritjes së normave tatimore) çon në uljen e normës së rritjes ekonomike në periudhë afatgjatë. Duke u nisur nga kjo e gjetur mund të thuhet se qeveritë e vendeve të ndryshme, ashtu edhe ajo e Kosovës duhet kushtuar një vëmendje të shtuar në formulimin e politikave tatimore si dhe duhet vepruar në drejtimin e rritjes së efijencës në mbledhjen e të ardhurave duke zvogëluar ekonominë joformale të vendit me qëllim që ky trend të rritet si rezultat i efijencës e jo i rritjes së tatimeve.

Ndryshe nga ajo që u tha për rezultatet e dala për të ardhurat tatimore, të ardhurat jo tatimore dhe të ardhurat nga grandet në periudhë afatgjatë kanë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike. Siç vërejmë (tabela 4.6) trendi i të ardhurave jo tatimore ka qenë vazhdimisht pozitiv (përpos që në vitin 2013 kemi pas një ulje të lehtë me – 0.60%). Ky trend më së mirë shihet në tabelën 4.6. Gjithashtu trendi i pjesëmarrjes së të ardhurave jo tatimore në raport me PBB-ën (rritjen ekonomike) ka qenë relativisht i qëndrueshëm me përjashtim të dy periudhave të ndara (2008 = 3.21% dhe 2009= 7.85%, shtojca tabela A3) ku kemi kapërcim në trend si rezultat i mbledhjes së njehershme të të ardhurave jo tatimore nga deidentata e PTK-së dhe licencimi i operatoreve të telefonisë mobile. Përkundër që këto të ardhura kanë ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike të vendit, ndikim i cili ka qenë gati i pa përfillshim për shkak të nivelit të ulët të pjesëmarrjes në krahasim me të ardhurat gjithsej dhe trendit jo të qëndrueshëm të mbledhjes së të ardhurave jo tatimore. Por e kundërta e asaj që u tha për të ardhurat jo tatimore, është me

të ardhurave nga grandet ku ndikimi i tyre në rritjen ekonomike të vendit është relativisht më i lartë. Të të ardhurat nga grandet për nga vet natyra dhe specifika e tyre nuk kanë ndo një shpërndarje të rregullt në periudha tremujore. Gjithashtu edhe pjesëmarrja në raport me PBB-ën është shumë e ulët, por si përfundim nga rezultati ekonometrik del këto të ardhura kanë një ndikim në rritjen ekonomike të një vendi.


Modeli VECM i ndërtuar më sipër, është një rezultat statistikor i përfutur nga të dhënat e siguruara për variablat e marrë në studim, dhe si i tillë është e domosdoshme kontrolli i disa elementëve që matin cilësinë dhe përshtatshmërinë statistikore të modelit. Në çështjen 4.2.8 jemi marrë pikërisht me diagnostikimin e këtyre elementëve.

4.2.7. Funkzioni i Përgjigjes së Impulsit në modelin VAR/VECM

Në studimet ekonometrike të këtij lloji, një rëndësi e veçante i jepet studimit të reagimit të variablit të varur nga impulset e rastësishme që mund të pësojnë variablat endogjen të modelit VAR/VECM të ndërtuar me këta variabla. Modeli që kemi ndërtuar dhe që shprehet me anë të Barazimit 4.7, ka si variabël të varur PBB-n dhe si variabla të pavarur TAG, TAJT dhe TAT, të shprehura në logaritme natyrore në diferencave të para të tyre. Në këtë model, si në të gjitha modelet ekonometrike, vlerësimi i parametrave (koeficienteve) të modelit shoqërohet me vlerësimin e gabimeve standarde (Standart Error) për çdo variabël. Këto gabime standarde përfshihen në termin e gabimit (ϵ_t) i cili shoqëron çdo ekuacion ekonometrik. Qëllimi i funksionit të përgjigjes së impulsit është pikërisht studimi i reagimeve (ndryshimeve) që mund të pësoj në të ardhmen (në periudhat e mëvonshme) variabli i varur nga ndryshimet e rastësishme (impulseve ose goditjeve) të vlerave të variablave të varur. Për të ndërtuar funksionin e përgjigjes së impulsit ne kemi përdorur modelin Cholesky dhe kemi interpretuar Outputi-et që ofron

ky model për dy raste: (i) modelin me 12 periudha, domethënë, 12 tremujore, të cilat i korrespondojnë një periudhe trevjeçare. Duke synuar të vlerësojmë reagimin e PBB_t në tre vitet e ardhshme nga impulset që mund të pësojnë variablat endogjen PBB_{t-1} , TAG, TAJT dhe TAT gjatë kësaj periudhe; (ii) modelin me 4 periudha, domethënë, 4 tremujore, të cilat i korrespondojnë një periudhe njëvjeçare me qëllim vlerësimin e reagimit të PBB_t në vitin pasardhës, nga impulset që mund të pësojnë variablat endogjen PBB_{t-1} , TAG, TAJT dhe TAT gjatë këtij viti.

Figura 4.12 Funkzioni i përgjigjes së Impulsit për 12 periudha (3-mujorë)



Në Figurën 4.12, në të cilën paraqiten sjelljet grafike të funksionit të përgjigjes së impulsit për variablin e varur PBB_t nga ndryshimet (impulset) pozitive ose negative të deviacioneve standarde (S.D.) respektive të variablave të tjerë. Në grafikun e parë (majtas- lartë, Figura 4.12) paraqitet grafikisht funksioni i përgjigjes së impulsit për variablin PBB_t dhe PBB_{t-1} . Nga grafiku vërehet se impulset pozitive (rritja e vlerës së S.D.) për variablin PBB , gjatë gjithë periudhës pasardhëse, shkaktojnë reagime të paqëndrueshme por asnjëherë këto reagime nuk bëhen negative (vija blu e grafikut mbetet në mënyrë rigorozë në gjysmë planin pozitiv të grafikut). Deri në periudhën e tretë


tremujore, për PBB-n vërehet një reagim pozitiv gjithmonë në rënie, fenomen ky që përsëritet pothuajse periodikisht në periudhat 5-7 dhe 9-11. Ndërsa në periudhat e tjera vërehet reagim pozitiv me tendencë rritjeje. Nuk vërehen periudha stanjacioni të ndikimit pozitiv të impulseve të PBB-s mbi vet PBB-n.

Impulset pozitive të S.D. të variablit të pavarur TAG (grafiku djathtas-lartë, Figura 4.12) shoqërohen me reagime negative të PBB-s në pjesën më të madhe të periudhës së ardhshme trevjeçare. Përfundimisht bëjnë periudha e katërt dhe e tetë në të cilat shfaqen reagime pozitive të PBB ndaj impulseve pozitive të variablit TAG.

Në grafikun që paraqet funksionin e përgjigjes së impulsit për variablat PBB dhe TAJT (grafiku majtas-poshtë, Figura 4.12) vërejmë se impulset pozitive të variablit TAJT ushtrojnë reagim negativ të PBB-s vetëm në dy tremujorët dhe me tendencë për tu bërë negative, në tremujorin e katërt. Në gjithë periudhën tjetër reagimi i PBB-s është i luhatshëm por pozitiv ndaj impulseve pozitive të S.D. të variablit TAJT. Impulset pozitive të të ardhurave tatimore (TAT) shoqërohen me reagime pothuajse pozitive gjatë gjithë periudhës së ardhshme trevjeçare, duke fituar një reagim pothuajse konstant në gjysmën e dytë të kësaj periudhe (tremujori i 6-të deri në tremujorin e 12-të). Interesant shfaqen dy tremujorët e tretë dhe të katërt në të cilët vihet re se impulset pozitive të TAT-ës nuk shoqërohen me asnjë lloj reagimi të PBB-ës (grafiku djathtas-poshtë, Figura 4.12).

Funksioni i përgjigjes së impulsit për katër tremujorët e ardhshëm, periudhë kjo që është e barabartë me një vit kalendarik, paraqitet në figurën 4.13.

Figura 4.13 Funkcioni i përgjigjes së Impulsit për 4 periudha (3-mujorë)



Periudha me katër tremujore është pjesë e periudhës me 12 tremujorë e cila është trajtuar më sipër, por studimi më vete i saj na lejon të konkludojmë në mënyrë më të detajuar atë çfarë presim të ndodh gjatë vitit pasardhës me variablin PBB në qoftë se vlerat e variablave endogjenë pësojnë impulse pozitive të S.D. të tyre.

Impulset pozitive të PBB-s gjatë dy tremujorëve të parë (grafiku majtas-lartë, Figura 4.13) sjellin një reagim pozitiv në rënie konstante të PBB-s. Ky reagim vazhdon të jetë në rënie pozitive edhe gjatë tremujorit të tretë, por kjo rënie është më e zbutur. Reagimi i PBB-s ndaj impulseve pozitive të vetë PBB-s shoqërohet me reagim pozitiv në rritje gjatë tremujorit të katërt. Reagimi i PBB-s ndaj impulseve pozitive të variablit TAG (grafiku djathtas-lartë, Figura 4.13) është negativ dhe në rënie të vazhdueshme gjatë dy tremujorëve të parë të vitit pasardhës, mbetet negativ pothuajse konstant gjatë tremujorit të tretë. Në gjysmën e parë të tremujorit të katërt, reagimi i PBB-s është negativ por në rritje drejt vlerave pozitive, gjë të cilën e realizon gjatë gjysmës së dytë të periudhës së katërt. Në gjysmën e dytë të tremujorit të katërt reagimi i PBB-s është pozitiv dhe në rritje

konstante. Reagimi i PBB-s ndaj impulseve pozitive të TAJT-s është negativ në dy tremujorët e parë dhe pozitiv në dy tremujorët e dytë (grafiku majtas-poshtë, Figura 4.13). Impulset pozitive të variablit TAT ushtrojnë një ndikim pozitiv mbi variablin PBB në 3 tremujorët e parë të vitit pasardhës, ndërsa në tremujorin e fundit të tij, PBB nuk reagon ndaj impulseve të S.D. të variablit TAT. Deri në mesin e tremujorit të dytë vihet re një pozitivitet rritës i reagimit të PBB-ës, dhe mbas këtij momenti, deri në fundin e tremujorit të tretë, presim të kemi një reagim pozitiv por në rënie konstante deri sa ky reagim bëhet zero në fillim të tremujorit të katërt të vitit pasardhës (grafiku djathtas-poshtë, Figura 4.13).

4.2.8 Kontrolli i cilësisë së modelit (Diagnostic checking)

Për të kontrolluar cilësinë e modelit VECM të ndërtuar me anë të variablave PBB, TAT, TAJT dhe TAG jemi mbështetur në verifikimin e tre faktorëve kryesor të cilët vlerësojnë cilësinë një modeli statistikor-ekonometrik: (i) përshtatshmëria statistikore e modelit (R^2); (ii) korrelacionet serial (Q-test dhe LM-test); (iii) Heteroskedasticiteti i të dhënave.

